



# UBT NEWS

Gazetë e studentëve të UBT-së | Maj 2018

POLITICS | ECONOMY | BUSINESS | TECHNOLOGY | EDUCATION | SCIENCE | CULTURE



**Kosova ka shumë potencial për inovacion, duhet të ndryshojnë politikat qeveritare**

Faqe 3



**Ekspertët diskutojnë në UBT për rolin dhe ndikimin e vlerave në tregun botëror**

Faqe 4



**Siguria kibernetike dhe privatësia, kërcënim dhe sfidë në Kosovë**

Faqe 8

**Profesoresha e UBT-së, dr Caroline Jäger-Klein zgjedhet presidente e ICOMOS Austria**

Faqe 9

**Rrëfime sukcesi**

Faqe 12-16

**Intervista me dekanët e fakulteteve në UBT**

Faqe 20-27



## Studentët e UBT-së triumfojnë në garën "Albanian ICT Awards"

(Faqe 4)



## UBT – adresa e inovacionit në Kosovë

(Faqe 2)



Editorial

**Prof.dr. Edmond Hajrizi**

# UBT – adresa e inovacionit në Kosovë

Universitete të dhjetëshes së parë të listës së universiteteve më të mira në botë janë ose do të jenë së shpejti në listën e institucioneve ndërkombëtare, me të cilat UBT ka marrëveshje bashkëpunimi. Për shkëmbim përvojash, shkëmbim stafi akademik e mundësi për studentët tanë që të jenë pjesë e këtyre universiteteve. Krahas qindra universiteteve e institucioneve me repute botërore, pjesë e familjes së të cilave është UBT dhe përfitimet nga ky bashkëpunim, si të studentëve ashtu edhe të stafit akademik, janë të prekshme.

Shumësia e partnerëve ndërkombëtarë për UBT-në nuk është lajm i atij niveli siç do ta trumbetonin të gjithë të tjerët, po ta kishin këtë mundësi. Kjo për faktin se UBT, që në fillimet e tij, 17 vjet më parë, e ka nisur aktivitetin duke pasur për krah institucione të rëndësishme ndërkombëtare. Dhe jo vetëm kaq. Dhe jo vetëm për formë. Programet më të mirë botërore, në të gjitha fushat e studimit që i ofroi e i ofron UBT, janë hartuar në bashkëpunim me ekspertë ndërkombëtarë, duke iu përshtatur rrethanave e nevojave të vendit.

Jo vetëm kaq. Këto programe, risi në Kosovë, u vunë në praktikë nga profesorë amerikanë e evropianë, nga profesorë nga të gjitha anët e globit, të cilët ligjëruan në UBT. Sollën përvojat më bashkëkohore të shkencës e të hulumtimit, i ndanë ato me studentët kosovarë, të cilët i akceptuan ato më së miri.

Marrëveshjet, programet dhe profesorët ndërkombëtarë, është e qartë, ishin një risi, një inovacion për Kosovën. Por, jo një mburrje për UBT-në. Sepse, ne e bëmë të qartë që në fillim – UBT do të jetë një institucion ndryshe, që nuk do të ketë synim të zakonshmen.

Ia dolëm dhe do të vazhdojmë të jemi, si gjithnjë – ndryshe dhe një hap para të tjerëve.

Ndryshimet e mëdha në të gjitha fushat, që ka sjellë zhvillimi i teknologjisë, kanë qenë sfida për të gjithë. Për ne, gjithashtu. Por, duke pasur synimin e qartë që nga fillimi, duke pasur përvojën dhe ekspertizën ndërkombëtare, një staf kulminant ndërkombëtar dhe stafin shumë të përgatitur vendor, UBT sërish ia doli të jetë në hap me zhvillimet teknologjike, një hap më përpara të gjithëve në vend dhe në rajon.

Drejtimet e reja të studimeve, shumica prej tyre të

parat në gjithë rajonin, dhe shumë të veçanta, bënë që UBT të dallohet nga të tjerët. Dhe më shumë. Të merret model e të kopjohet nga institucionet e tjera, si ato akademike, ashtu edhe organizatat e individit e ndryshëm.

Parqet shkencore, ato inovative, inkubatorët e biznesit, laboratorët modernë, biblioteka universitare, dhjetëra institucione profesionale që funksionojnë në kuadër të UBT-së, e bëjnë këtë institucion prijatar të inovacionit në vend. Pa asnjë dilemë.

Institucionet ndërkombëtare, duke nisur nga organe të Bashkimit Evropian, e kanë pikë reference UBT-në. Të identifikuar si një adresë dhe institucion që ka kapacitete për të zhvilluar proces akademik dhe hulumtues e shkencor në një nivel me të gjitha institucionet prestigjioze ndërkombëtare.

Në këtë plan, si dëshmia më e mirë janë garat ndërkombëtare, në të cilat vendet e para për studentët e UBT-së nuk janë kurrfarë risie. Sepse studentët tanë nuk njohin garë, në të cilën kanë marrë pjesë e nuk kanë qenë në krye të rangimit. Mjaftojnë të kujtojmë që kur UBT ishte në krye të garave botërore e evropiane me robotët që luajnë futboll, shumëkush nuk kishte dijeni si bëhet kjo lojë.

Ndaj është shumë e qartë – në shumë fusha, me thek të veçantë në të inovacionit në Kosovë e në rajon – me plotë të drejtë mund të themi shprehjen “UBT dhe të tjerët”.

Me këtë nivel zhvillimi dhe përkushtimi, UBT po përgatitet edhe për vitin e ri akademik 2018/2019. Qysh tash, UBT është adresa ku po kërkojnë vendin e tyre të gjithë të rinjtë e të rejtat që duan një institucion për studime “ndryshe nga të tjerët”. Që duan të ndjekin ëndrën e tyre në institucionin që u krijon mundësi të pakufishme. Që e kanë të qartë se në fund të studimeve ata do të jenë ekspertë të kërkuar në tregun e punës. Që e dinë se do të studiojnë në institucionin me shkallën më të lartë të punësimit të studentëve dhe të të diplomuarve në vend e në rajon. Që e kanë të qartë se do t'i kenë të hapura rrugët për studime shtesë në mbi 250 institucione partnere të UBT-së.

Që e dinë se do të jenë më të mirët. Sepse, këtë ua mundëson UBT.

**17 YEARS  
LEADERSHIP AND INNOVATION**

Education | Research | Training | Consulting

**2001 / 2018**

## IMPRESUM

UBT News – gazetë e studentëve

**Botues:** Edmond Hajrizi

**Numrin e përgatitën:** Jehona Kapllani, Anisa Rada, Edona Jerliu, Fatbardhë Kiqina dhe studentët e Media dhe Komunikimit

**Adresa:** www.ubt-uni.net / Tel: 038 541 400, 044 541 400

**Përgatitje grafike:** Trimor Racaj



Në UBT u mbajt konferenca ndërkombëtare “Free Market Road Show”

## Ekspertët diskutojnë në UBT për rolin dhe ndikimin e vlerave në tregun botëror

Në bashkëbisedim me studentët e UBT-së, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, bëri të ditur se liberalizmi i vizave do të ndodhë në fund të këtij viti, pasi, siç pohoi ai, Kosova i ka përmbushur kriteret e këtij procesi

Në UBT u mbajt konferenca ndërkombëtare “Free Market Road Show”, si bashkëorganizim i UBT-së, Institutit Liberal për Hulumtim Politikash, Qendrës Austriake për Ekonomi dhe Aleancës së Konservatorëve dhe Reformistëve në Evropë. Temë kyçe e këtij viti ishte: “Vlerat, cilat vlera!”.

Në këtë konferencë është diskutuar për vlerat liberale evropiane prej rritjes së popullsisë dhe janë trajtuar sfidat e këtyre vlerave në nivel ndërkombëtar dhe në dimension lokal.

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, tha se vlerat nuk kanë ndonjë formulë të veçantë, por studentët dhe stafin e UBT-së i quajti vlerë.

“Për UBT ka qenë çdoherë i qartë propozimi i vlerave kur kemi filluar. Me 15 mijë studentë dhe 600 të punësuar, krijojmë një vlerë dhe kjo vlerë gjenerohet dhe integrohet në sistemin tonë në Kosovë dhe ndërkombëtarisht, duke dizajnuar sisteme të ndryshme që krijojnë qëndrueshmëri, rritje ekonomike, stabilitet, siguri, digjitalizim, inovacion, ndërmarrësi dhe shumë aspekte tjera shumë të rëndësishme”, tregoi rektori Hajrizi.

Në bashkëbisedim me studentët e UBT-së, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, bëri të ditur se liberalizmi i vizave do të ndodhë në fund të këtij viti, pasi, siç pohoi ai, Kosova i ka përmbushur kriteret e këtij procesi. “Kosova ka nevojë për reforma ekonomike, në të njëjtën kohë, ne jemi duke i bërë ato. Kemi shumë iniciativa dhe kemi shumë ndërmarrës, të cilët janë të interesuar të vijnë të investojnë në Kosovë”, tha Veseli.

Eksperti dhe analisti, Nima Sanandaji theksoi se është me rëndësi jetike të diskutohen tema të tilla, pasi shumë nga krizat me të cilat po përballlet Evropa lidhen me vlerat.

“Ideja e këtij edicioni nuk është vetëm për të diskutuar



**“Për UBT ka qenë çdoherë i qartë propozimi i vlerave kur kemi filluar. Me 15 mijë studentë dhe 600 të punësuar, krijojmë një vlerë dhe kjo vlerë gjenerohet dhe integrohet në sistemin tonë në Kosovë dhe ndërkombëtarisht, duke dizajnuar sisteme të ndryshme që krijojnë qëndrueshmëri, rritje ekonomike, stabilitet, siguri, digjitalizim, inovacion, ndërmarrësi dhe shumë aspekte tjera të rëndësishme”, tregoi rektori Hajrizi**

gjëra të zakonshme që lidhen me ekonominë dhe filozofinë e tregut të lirë sepse mendojmë se shumë nga krizat me të cilat përballlet dhe do të përballlet Evropa në të ardhmen e afërt lidhen me vlerat”, tha ai.

Përfaqësuesi i Qendrës Ekonomike Austriake, Federico Fernandez, vlerësoi se gara në tregun e lirë është shumë e shëndetshme në një shoqëri liberale, pasi gara në treg i ndihmon secilit të përmirësohet.

“Kur tentojmë ta shmangim konkurrencën, shkatërrojmë ekuilibrin se sa merret dhe sa dhurohet në një treg. Gara siguron që ne të bëhemi versioni më i mirë i vetes tonë, andaj shoqëria që tenton të shmang garën e tregut, është

shoqëri që tenton të krijojë njerëz me mendësi mesatare”, konstatoi ai.

Në këtë konferencë, lidhur me temën kanë diskutuar dhe kanë ndarë përvojat e tyre profesorët e UBT-së, Ramadan Ilazi e Artan Mustafa, drejtori i Institutit Liberal për Kërkime të Politikave, Adri Nurellari si dhe analisti Adrian Prenkaj.

Aktiviteti “Free Market Road Show” është seri e përvitshme e konferencave ndërkombëtare, që këtë vit do të mbahet në 40 qytete të shteteve të ndryshme të Evropës, ku do të synohet të ofrohet zgjidhje liberale për problemet aktuale.

Në garën e përvitshme

## Studentët e UBT-së triumfojnë në garën “Albanian ICT Awards”



Studentët dhe alumni i UBT-së, bënë që gara “Albanian ICT Awards”, t’i kthente sytë nga Kosova dhe të vlerësonte inovacionet që kanë ardhur prej tyre, për të cilat edhe u vlerësuan maksimalisht nga juria e këtij edicioni.

Produktet dhe projektet e studentëve të UBT-së dominuan jo vetëm me nominime, por edhe me fitimin e çmimeve në disa kategori.

Çmimin “ICT Diploma e vitit” e mori njëri ndër studentët

më të dalluar të UBT-së, Hakan Shehu, i mentoruar nga profesori Bertan Karahoda.

Në po të njëjtën kategori ishte e nominuar edhe studentja e SHKI-së, Blerona Cakolli, me diplomën e përfunduar nën mentorimin e profesorit Zhilbert Tafa.

UBT është institucion që fokus të veçantë i kushton zhvillimit profesional të grave, e këtë e dëshmoi edhe këtë herë, me ç’rast në kategorinë “Femra në ICT” triumfoi ish-studentja e UBT-së, Hana Qerimi, e cila e ka

krijuar dhe po e drejton Shkollën Digjitale, me qëllim të edukimit dhe orientimit të fëmijëve dhe të rinjve drejt teknologjisë.

Dominim absolut i studentëve të UBT-së u pa edhe në kategorinë “Siguria Kibernetike”, ku të tre finalistët janë produkte të UBT-së.

Të nominuar ishin hakerët e bardhë nga UBT, Blent Kurtalani dhe Veton Bejtullahu, Edi Bushati, ndërkaq çmimi shkoi në duart e studentëve Kastriot Fetahaj dhe Fitim Latifaj.

Edhe në kategorinë “Shërbimi Publik i vitit”, të dy grupet finaliste në përbërje kishin ish-studentë të UBT-së.

Si kontribuues i madh dhe anëtar i jurisë së këtij edicioni, rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, gjatë ndarjes së çmimit për kategorinë “Mobiliteti i vitit”, i përgëzoi të gjithë pjesëmarrësit për prurjet inovative të këtij viti. Në veçanti, ai shprehu mirënjohje për studentët e UBT-së, të cilët, sipas tij, po japin kontribut të madh për zhvillimin e teknologjisë në trojet shqiptare.

“Kjo garë e madhe edhe kësaj here tregoi se cilësinë e punës dhe lidhshirësinë që ka UBT në fushën e inovacionit, ndërmarrësisë dhe ICT-së”, tha Hajrizi, duke premtuar se vendet shqipfolëse dhe bota do të kenë çfarë të presin nga studentët e institucionit të cilin ai e drejton.

Edicioni i sivjetmë i Albanian ICT Award mbledhi dhe pranoi mbi 100 aplikacione dhe përzgjedhja e më të mirave u bë nga 11 anëtarët e jurisë.

Kategoritë në të cilat u ndanë çmime ishin: ICT Inovacioni i vitit, ICT Diploma e vitit, ICT Ylli në Ngitje, Femra në ICT, ICT Shërbimi Publik i vitit dhe Siguria Kibernetike.

## Konferenca tematike në UBT

## Identifikohen zonat e rrëshqitjeve të dheut në Kosovë - rrezikojnë jetën e qytetarëve

Në prani të përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës, studentëve dhe profesorëve, në UBT, është mbajtur konferenca me temë: “Rrëshqitjet e dheut në Kosovë, efektet anësore dhe masat për sanimin e tyre”, e organizuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës në UBT.

Në këtë konferencë, ekspertë të fushave përkatëse, shumë nga ta edhe profesorë të UBT-së, për herë të parë diskutuan bashkërisht dhe dhanë konkluzione për masat që duhet të ndërmerren për sanimin e dëmtimeve nga rrëshqitjet e dheut.

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, ka thënë se debati në fjalë është organizuar si rezultat i shtimit të rrëshqitjeve të dheut në territorin e Kosovës, me theks të veçantë në segmentet rrugore.

Tutje, rektori Hajrizi tregoi se debati ka për qëllim ndërlidhjen e palëve të interesit, veçanërisht akademinë me industrinë, sipas të cilit, bashkërisht duhet të bëhen hulumtime e më pas të ndërmerren masa nga autoritetet përkatëse për këtë problematikë.

Ndërkaq, profesori në Fakultetin e Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës, në UBT, Hazir Çadraku ka prezantuar të gjeturat e hulumtimit të tij me temë: “Rrëshqitjet në Kosovë, domosdoshmëria e monitorimit të tyre”.

Profesor Çadraku tha se në territorin e Kosovës, janë identifikuar 40 zona të rrëshqitjeve, ku Prishtina është e prekur si komunë, ndërsa Prizreni si rajon.

“Zonat e rrëshqitjeve përfshijnë sipërfaqe prej 48 km<sup>2</sup> ose 0.44 % të territorit të Kosovës. Lartësia mesatare e shfaqjes së rrëshqitjeve është 657 m mbi nivelin e detit. Rrëshqitjet kanë rrezikuar jetën e qytetarëve, shtëpive të



banimit, infrastrukturën rrugore etj.)”, tregoi Çadraku. Ndërkohë, profesori në UBT, Hysen Ahmeti, me theks të veçantë ka folur rreth rrëshqitjeve të dheut në autostradën “Ibrahim Rugova”, i cili tha se ky është problem që paraqet rrezik, sidomos për qarkullimin e automjeteve. Udhëheqësi i Divizionit të Banimit në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ramë Hamzaj vlerësoi se rrëshqitjet e dheut janë probleme që hyjnë në grupin e gjeorrezive.

Ai tha se Kosova ka potencial që ti trajtoj këto probleme dhe se, sipas tij, mund të evitohen rreziqet e rrëshqitjeve të dheut në vendbanime.

Në këtë konferencë u bë e ditur se Kosovës i mungon

harta për vlerësimin e rrezikut, hartë e cila është domosdoshme për sektorin e ndërtimit, pra të planifikimit, ndërtimit dhe zhvillimit afatgjatë të qendrave urbane ekzistuese dhe të reja, përfshirë edhe zhvillimin rural. Pjesë e kësaj konference ishin përfaqësues dhe ekspertë nga Akademia e Shkencës dhe Arteve në Kosovë, Universiteti i Prishtinës, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Ministrisë së Bujqësisë, Ministrisë së Infrastrukturës, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Komiteti i Biznesit – Kompanitë ndërtimore dhe zyra e Komisionit Evropian në Kosovë.

## Në Ditën Ndërkombëtare të Vajzave në ICT

## Dhjetëra vajza e gra të Kosovës ndajnë rrëfimet e tyre të suksesit



Në një tryezë diskutimi në të cilën morën pjesë disa nga vajzat dhe gratë më të suksesshme të UBT-së dhe të Kosovës, u shënuar Dita Ndërkombëtare e Vajzave në ICT.

Tryeza shërbeu si një platformë ku dhjetëra vajza e gra treguan për sfidat, paragjykimet dhe problemet me të cilat janë përballur përgjatë ndërtimit profesional të tyre, por të cilat u shndërruan në rrëfime suksesi dhe në tregime motivuese për të gjitha gjeneratat e reja të vajzave, të cilat një ditë ëndërojnë të futen në sektorin e ICT-së.

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, e përgëzoi secilën prej tyre për arritjet në karrierë dhe vendosmërinë e vazhdueshme përgjatë tërë këtij rrugëtimi.

“Vajzat dhe gratë kosovare kanë potencial të madh dhe është jetike që asnjëherë mos t’i dorëzoheni sfidave dhe pasivitetit, pasi vetëm ju mund të bëheni forca e ndry-

shimit për të gjitha gjeneratat pas jush”, ishte porosia që Hajrizi e pati për vajzat e gratë pjesëmarrëse, teksa potencoi se ndjehet shumë krenar që në ndërtimin profesional të secilës prej tyre, UBT ka ndikuar dhe ndihmuar në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Një rrëfim i tillë suksesi nuk ka se si të mos jetë ai i ish-studentes së UBT-së, Merita Gjyshinca – Peja, e cila është drejtore e ekzekutive e Bankës Ekonomike, si gruaja e vetme në Kosovë, që momentalisht është duke e mbajtur një pozitë të tillë.

Megjithatë, ajo tregoi se arritja deri në këtë pikë nuk ka qenë aspak e lehtë dhe është shoqëruar me sakrificat të shumta.

“Në Kosovë operojnë 10 banka, dhe prej tyre, Banka Ekonomike është e vetmja që udhëhiqet nga një grua. Kjo nuk është shifër nga e cila duhet të kënaqemi, pasi

aktualisht më pak se 1% e grave mbajnë pozita udhëheqëse në vendin tonë, e kjo shifër duhet të rritet urgjentisht”, tha ajo.

Për të ndarë historinë e vet, e pranishme ishte përfaqësuesja e Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit, Sajmie Thaçi, e cila me pjesëmarrësit ndau përvojën e marrë në një trajnim të mbajtur në Japoni, të titulluar: “Ndërtimi i kapaciteteve për planifikimin e projekteve në TIK”.

“Qëllimi i këtij trajnimi ishte që të bëhet promovimi dhe zhvillimi i TIK-ut, si një pjesë përbërëse e zhvillimit ekonomik, social, agrokulturor, arsimor, kulturore shëndetësor”, sqaroi ajo, duke shtuar se ishte privilegj për të që të ishte ndër përfaqësueset e vetme gra në një organizim me peshë kaq të madhe.

Rrëfimet e tyre të suksesit i ndanë edhe shumë të reja, të cilat sot janë staf, studente dhe ish-studente të UBT-së, të cilat shpërfaqën shumë arsye që e vështirësojnë prezencën e grave në sektorin e ICT-së, por që të gjitha këto barrierat i ka tejkaluar secila prej tyre.

Krenare Pireva, Ines Bula, Diellza Berisha, Albnora Hoti, Harisa Hoxha, Blerona Cakolli dhe Liza Berisha, ishin personazhet e UBT-së, të cilat me rrëfimet e tyre motivuese, shërbyen si model për nisjen e kësaj rruge për dhjetëra vajza të tjera të pranishme në këtë ngjarje të rëndësishme.

E këtë ngjarje e bëri edhe më madhore prania e mysafires nga Shqipëria, nga AKCESK, Kloreanta Janushi dhe ligjëruesja në Universitetin e Gjilanit “Kadri Zeka”, dr Lindita Nebiu, të cilat ndanë përvojat dhe arritjet e tyre, si dhe i motivuan të gjitha vajzat e reja që për asnjë kusht të mos heqin dorë nga karrierat e tyre.

Aktiviteti është regjistruar në ITU, në mesin e shteteve të Unionit Evropian të zhvilluara në industrinë e ICT-së.

## UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Bankën “Raiffeisen”

UBT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Bankën “Raiffeisen”, falë të cilës, tash e tutje, si institucionet partnere, ashtu edhe studentët e UBT-së, do të përfitojnë nga marrëveshja në fjalë, me qëllim të zhvillimit të dyanshëm të kapaciteteve profesionale.

Në bazë të marrëveshjes së nënshkruar, palët kanë paraparë organizimin e aktiviteteve të ndryshme, përfshirë hulumtimet, trajnimet, seminarët dhe konferencat e për-


bashkëta.

Përveç këtyre organizimeve të përbashkëta, përfaqësuesit e Bankës “Raiffeisen”, kanë bërë të ditur se studentëve të UBT-së do iu mundësohet puna praktike, si dhe mundësia e punësimit në sektorin e sistemit bankar.

Banka “Raiffeisen” operon në Kosovë si bankë universale dhe ofron shërbime profesionale financiare për të gjithë klientët kosovarë dhe ata ndërkombëtarë.



## UBT përfaqësoi Kosovën në konferencën e IPMA-së



Në mesin e qindra pjesëmarrësve nga më shumë se 60 shtete të botës, profesorët në UBT, Lulzim Beqiri dhe Naim Preniqi, në kuadër të trupës certifikuese (IPC) që operon në UBT, kanë përfaqësuar Kosovën në konferencën e organizuar nga Programi Ndërkombëtar për Menaxhim të Projekteve (IPMA), që u mbajt në Berlin.

Në konferencën e IPMA-së, përfaqësuesit kosovarë janë ftuar për të qenë pjesë në validimin e trupave certifikues në shtetet anëtare nga të gjitha kontinentet, njëherësh

edhe të kandidatëve që punojnë me projekte, apo që kanë dëshirë të punojnë në menaxhimin e projekteve në të gjitha fushat e industrive të ndryshme.

Në kuadër të kësaj organizate krijohen ekipe dhe hulumtues të suksesshëm dhe lansohen publikime të ndryshme lidhur me menaxhimin e projekteve.

UBT është anëtare me të drejta të plotë në IPMA, i anëtarësuar me votat e shumicës së vendeve anëtare.

## Zëvendësministri Bujar Cakolli vizitoi UBT-në

Zëvendësministri në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Bujar Cakolli, ka vizituar UBT-në, ku u takua me stafin e institucionit, të udhëhequr nga rektori, prof. dr Edmond Hajrizi.


Rektori Hajrizi e njoftoi zv. ministrin Cakolli me punën akademike, të arriturat e studentëve dhe me inovacionet teknologjike të cilat po ndërtohen në UBT dhe që po e afrojnë Kosovën me vendet e tjera të zhvilluara të botës. “UBT ka vizion që Kosovën ta rreshtojë në mesin e vendeve me teknologji të përparuar, andaj në laboratorët

tanë të sofistikuar po shpiken e ndërtohen mjete dhe pajisje të cilat nuk kanë ekzistuar më parë në Kosovë”, theksoi Hajrizi, duke shtuar se në këtë po kontribuojnë edhe studentët që janë të pasionuar pas shkencës dhe teknologjisë.

Ndërkohë, i impresionuar me rritjen dhe të arriturat që ka bërë UBT ndër vite, Cakolli u shpreh se do të jetë mbështetës i fuqishëm i të rinjve që kanë ide, projekte dhe plane konkrete inovative, të cilat do i ndihmojnë Kosovës dhe qytetarëve.



## Psikologia e UBT-së, Vjollca Pllana-Shahini këshillon studentët për mënjanim të ankthit



Psikologia e UBT-së, njëherësh edhe koordinatore në Qendrën Këshilluese që funksionon në UBT, Vjollca Pllana-Shahini, ka mbajtur ligjëratë tematike me titull: “Si ta menaxhojmë ankthin”, e cila për shkak të aktualitetit të temës, ngjalli interesim të madh në mesin e të pranishmëve.

Ligjëratat u mbajt për studentët e UBT-së, dega në Ferizaj.

Psikologia Pllana-shahini ka dhënë këshilla që ndikojnë në një gjendje më të mirë psikologjike.

Ajo ka thënë se ankthi është një nga shqetësimet më të përhapura në vitet të fundit, teksa ka prezantuar edhe disa metoda efektive për të mënjeluar ankthin. “Personat që ndjejnë ankth dhe që kanë shqetësime gjatë gjithë kohës, menaxhimi ose kontrolli sjelljeve do të ishte një nga

mënyrat për t’u siguruar që gjithçka do të shkojë mirë”, vlerësoi ajo, ndër shumë këshilla të tjera që i drejtoi për të rinjtë e pranishëm, Pllana - Shahini.

Po ashtu, psikologia i ka inkurajuar studentët që të përfitojnë nga shërbimet që ofron Qendra Këshilluese në UBT, ngaqë siç potencoi ajo, institucioni synon që në qendër të mbajë mirëqenien e studentëve në aspektin psikologjik dhe emocional.

## UBT shënon Ditën Botërore të Shëndetit Oral

Me qëllim të vetëdijesimit lidhur me rëndësinë dhe rolin e shëndetit oral, studentët e Fakultetit të Stomatologjisë në bashkëpunim me Grupin për Edukim dhe Promovim Shëndetësor në UBT, me anë të disa aktiviteteve simbolike, kanë shënuar Ditën Botërore të Shëndetit Oral, në sheshin “Zahir Pajaziti” në Prishtinë.

Kjo ditë u shënuar me moton “Buzëqeshi jetës” ku janë shpërndarë fletëpalosje me përmbajtje sensibilizimi dhe informimi për qytetarët lidhur me rëndësinë e vizitave të rregullta te dentisti.

Në këtë aktivitet përfituan shumë qytetarë të rastit përfshirë edhe fëmijë, të cilëve edhe u janë dhuruar brusha të dhëmbëve

për higjienë të mirë të dhëmbëve dhe gojës.

Përveç këtyre aktiviteteve, UBT ka organizuar edhe një fushatë mediale për edukim të shëndetit oral, me ç’rast qindra fletëpalosje janë shpërndarë në tërë Kosovën në kuadër të gazetës Koha Ditore.

Dita Botërore e Shëndetit të Oral e vendosur nga Federata Dentare Botërore (FDI), organizohet çdo vit më datë 20 mars. Kjo ditë synon të rrisë ndërgjegjësimin, si dhe të tregojë rëndësinë e madhe që ka shëndeti oral në shëndetin e përgjithshëm dhe mirëqenien.

## UBT shënon Ditën Botërore të Veshkës

Me qëllim të vetëdijesimit lidhur me rëndësinë dhe rolin e veshkave, studentët e Fakultetit të Infermierisë në bashkëpunim me Grupin për Edukim dhe Promovim Shëndetësor në UBT, me anë të disa aktiviteteve, kanë shënuar Ditën Botërore të Veshkës në komunën e Prizrenit.

Ata kanë shpërndarë fletëpalosje me përmbajtje sensibilizimi për zbulimin e hershëm të sëmundjeve të veshkës,

njëherësh kanë ofruar edhe shërbime falas për qytetarët, përfshirë matjen e sheqerit dhe matjen e tensionit në gjak.

Në këtë aktivitet ku përfituan qindra qytetarë të rastit mori pjesë edhe kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskakaj. Ai ka falënderuar studentët e UBT-së, të cilët dhanë udhëzime se si t’i mbrojmë veshkat dhe si të bëhet zbulimi i hershëm i kësaj sëmundje, teksa inkurajoi studentët

për vazhdimin e aktiviteteve të tilla.

Këtë vit dita botërore e veshkës korrespondon me ditën e gruas, me këtë rast, aktivitetet e organizuara nga UBT, në fokus kishin ruajtjen e shëndetit të femrat dhe zbulimin e hershëm të kësaj sëmundje të pashërueshme.

Në Kosovë nuk ka statistika të sakta për numrin e të prekurve nga kjo sëmundje,

megjithatë sipas statistikave botërore, në Kosovë mund të jenë të prekur rreth 200 mijë banorë që vuajnë nga kjo sëmundje. Derisa, nga sëmundja kronike e veshkave në mbarë botën përafërsisht janë të prekurra mbi 190 milion gra, nga të cilat, 600 mijë prej tyre vdesin çdo vit.

## Bashkëpunimi ndërkombëtar

## UBT anëtar me të drejta të plota në Asociacionin e Universiteteve Ballkanike

Këshilli i Asociacionit të Universiteteve Ballkanike (Balkan Universities Association) ka pranuar aplikimin e UBT-së për t'u bërë anëtar me të drejta të plota në këtë asociacion.

Anëtarësimin me të drejta të plota, duke e përfshirë edhe të drejtën për votim, në Asociacionin e Universiteteve Ballkanike, zyrtarisht e ka nënshkruar rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi.

Kjo vjen një vit pas aplikimit të UBT-së anëtarësim, me ç'rast ishte pranuar si anëtar me të drejta të asociuara. Nënshkrimi u bë në takimin e katërt të BUA-s, të mbajtur me të gjithë rektorët e mbi 40 universiteteve anëtare të asociacionit, ku nikoqir për këtë vit ishte Universiteti i Tetovës.

Me këtë rast, rektori Hajrizi tha se anëtarësimi i UBT-së në këtë asociacion do të krijojë mundësi të shumëfishta për bashkëpunim dhe për ofrim të kontributit dhe ekspertizës në fushën e arsimit, shkencës, dhe më gjerë.

“Nënshkrimi i anëtarësim-it në këtë asociacion do të krijojë mundësi të reja për aplikim në projekte të përbashkëta evropiane, si dhe do të ofrojë mundësi të shumta bashkëpunimi, me qëllim të ngritjes së vazhdueshme të nivelit të arsimit në vendin tonë dhe në rajon”, theksoi Hajrizi. Po ashtu, sipas tij, asociacioni pjesë e së cilës tashmë është UBT, parasheh krijimin e një rrjeti shkencor në fushat e gjuhës, kulturës, artit, historisë, ekonomisë, arsimit dhe sportit dhe kujdesit shkencor, ku anëtarët bashkëpunojnë për realizimin e synimeve të



BUA-s.

Takimi i radhës i anëtareve të Asociacionit të Universiteteve Ballkanike, për vitin akademik 2018/2019, do të mbahet në Universitetin “Aristoteli”, në Selanik.

## UBT arrin marrëveshje bashkëpunimi me MIT World Peace University nga India

Zgjerimi i rrjetit të partnerëve akademikë ndërkombëtarë të UBT-së, po vazhdon të zgjerohet me institucione nga e mbarë bota, duke mos njohur kufij e kufizime të tjera. Së fundmi, UBT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me MIT World Peace University, i cili gjendet në qytetin Pune, në Maharashta të Indisë.

Konkretizimin e kësaj marrëveshjeje e kanë bërë rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi dhe presidenti i MIT-WPU, prof. dr Rahul Vishwanath Karad, të cilët janë

pajtuar për një mori çështjesh e organizimesh në nivel akademik, duke pasur si objektiv kryesor bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe hulumtimit akademik.

Në kuadër të marrëveshjes së arritur, është paraparë publikimi i përbashkët i punimeve shkencore, shkëmbimi i përvojave akademike, realizimi i kërkimeve dhe projekteve të përbashkëta profesionale, realizimi i trajnimeve dhe projekteve të shkëmbimit, mobiliteti i stafit dhe studentëve të të dy institucioneve, organizimi i konfer-

encave, seminareve dhe paneleve të diskutimit, zhvillimi i programeve dhe kurseve të përbashkëta, si dhe shkëmbimi i informacioneve e materialeve të fushave të ndryshme të studimit, që janë në interes të të dy palëve. UBT ka mbi 250 partnerë ndërkombëtarë nga pothuajse të gjitha vendet e botës, me të cilët, që nga themelimi e deri më sot, ka realizuar një varg aktiviteteve të përbashkëta, prej të cilave më së shumti kanë përfituar stafi dhe studentët e UBT-së dhe të institucioneve partnere.

## UBT, partner në projektin më të madh të Erasmus+ për energji



Një delegacion i UBT-së, i përbërë nga rektori, prof. dr. Edmond Hajrizi, nga drejtori për Çështje Akademike, Valmir Hoxha, përgjegjësjë për Fakultetin e Inxhinierisë së Energjisë, Ines Bula dhe përfaqësues i zyrës së projekteve të UBT-së, Naim Preniqi kanë marrë pjesë në takimin e përbashkët me partnerë ndërkombëtarë, si pjesë të projektit: “Tregjet e Energjisë Elektrike dhe Arsimit Inxhinierik”, në kuadër të programit Erasmus+.

Takimi u mbajt në Greqi dhe morën pjesë 16 partnerë nga rajoni, Evropa

Juglindore dhe shumë partnerë të vendeve të BE-së, të cilët së bashku adresuan nevojat e ngritjes së kapaciteteve të reja, për t'ju përshtatur nevojave të tregut, teksa u shkëmbyen edhe mundësitë për bashkëpunime të reja në fushën e shkëmbimit të stafit dhe studentëve ndërmjet partnerëve të këtij projekti.

Projekti “Tregjet e Energjisë Elektrike dhe Arsimit Inxhinierik”, do të sjellë risi në fushën e Energjisë, ku UBT tanimë ka programe dhe përvojë në zhvillim të mëtejshme të kësaj fushe, dhe në këtë mënyrë, do të kontribuojë në zhvillim të gjithëmbarshtëm të vendit dhe rajonit, përmes programeve të reja që do të zhvillohen në kuadër të këtij projekti inovativ për rajonin.

## Stafi akademik dhe administrativ i Universitetit “Fan S. Noli” vizitoi UBT-në

Rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, ka pritur në takim një delegacion nga Universiteti “Fan Noli” nga Korça, të përbërë nga profesorë, staf administrativ dhe studentë, me të cilët veç tjerash ka bashkëbiseduar për bashkëpunim ndërinstitucional e shkëmbim përvojash.

Pas takimit me rektorin Hajrizi, ata kanë zhvilluar një takim edhe me stafin akademik të UBT-së, të cilët ndanë përvojat e tyre profesionale në fusha përkatëse, teksa ata u zotuan për thellim të bashkëpunimit me stafin administrativ e akademik të Universitetit “Fan S. Noli”.

Përgjatë disa ditëve sa do të qëndrojnë në Kosovë, ata do të marrin praktika profesionale nga stafi i UBT-së, kryesisht në fushën e mjekësisë, medias dhe komunikimit, shkencave kompjuterike etj., të cilat më pas do t'i aplikojnë në universitetin në fjalë.

Duke folur për nivelin e profesionalizmit të stafit të UBT-së, Brikela Qelemeni, përgjegjëse e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Media në Universitetin “Fan S. Noli”, në Korçë, ka thënë se janë të impresionuar me infrastrukturën që ofron UBT, teksa tregoi se janë të impresionuar me sistemin modern që punon UBT-ja.

“Do mundohemi që të marrim dhe t'i aplikojmë praktikat



e marra nga stafi i UBT-së sepse jemi të mahnitur me atë çfarë pamë në këtë institucion arsimor, konkretisht nga sektori i medias dhe komunikimit. Në punuam dhe ndamë përvojat me Media Group-in e UBT-së, si dhe

jemi të kënaqur me mirëpritjen e dekanit të Fakultetit Media dhe Komunikim, Ferid Selimi. Besojmë dhe shpresojmë shumë që bashkëpunimi të vazhdojë edhe në të ardhmen”, ka treguar ajo.

Konferenca Ndërkombëtare për Siguri Kibernetike dhe Privatësi

# Siguria kibernetike dhe privatësia, kërcënim dhe sfidë në Kosovë

“Aktualisht po përballemi me një rritje të madhe të lidhjeve në internet, e kjo ndikon në ngritjen e produktivitetit, eficiencës dhe rritjen e cilësisë së jetës. Por, çdo lidhje më shumë në internet, është kërcënim për sigurinë, andaj duhet t’i kushtojmë vëmendje ngritjes së kapaciteteve për rritjen e nivelit të sigurisë dhe privatësisë në vendin tonë”, vlerësoi rektori i UBT-së, dr. Edmond Hajrizi



**Për të shfaqur mbështetjen e SHBA-ve edhe në fushën e sigurisë e privatësisë, pjesë e konferencës ishte edhe ambasadori Greg Delawie, i cili u shpreh i bindur se vendi i tij do ta vazhdojë mbështetjen e Kosovës për t’i siguruar institucionet e qytetarët.**

Për të ngritur çështjen e rëndësishme të sigurisë dhe privatësisë, veçanërisht për të kontribuar në dhënie dhe sqarimin e informacioneve mbi monedhat virtuale, ka zhvilluar punimet Konferenca Ndërkombëtare për Siguri Kibernetike dhe Privatësi, e organizuar në partneritet të Ministrisë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Qendrës për Siguri Kibernetike e Privatësi dhe UBT-së.

Në ditën e parë të punimeve, konferenca mbledhi krerët më të lartë shtetërorë të Kosovës, përfaqësues institucionesh arsimore, ekspertë të çështjes së sigurisë dhe privatësisë dhe studentë e njerëz të tjerë të interesuar mbi këtë çështje tashmë të përhapur në nivel global.

Për tri vite rresht, kur edhe ka nisur organizimi i kësaj konference, UBT ka qenë në vazhdimësi partneri dhe mbështetja më e madhe e këtij aktiviteti të rëndësishëm për Kosovën. Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, tha se UBT, si institucioni më i madh në vend e rajon për përgatitjen e profesionistëve të fushës së sigurisë dhe privatësisë, është përkushtuar që të ofrojë maksimumin e mundshëm për sigurimin dhe mbrojtjen e institucioneve shtetërore dhe qendrave akademike nga krimet kibernetike.

“Aktualisht po përballemi me një rritje të madhe të lidhjeve në internet, e kjo ndikon në ngritjen e produktivitetit, eficiencës dhe rritjen e cilësisë së jetës. Por, çdo lidhje më shumë në internet, është kërcënim për sigurinë, andaj duhet t’i kushtojmë vëmendje ngritjes së kapaciteteve për rritjen e nivelit të sigurisë dhe privatësisë në vendin tonë”, vlerësoi Hajrizi.

Ai u zotua se institucioni të cilin ai e udhëheqë, do ta luftojë krimin dhe kriminelët kibernetikë, përmes ofrimit të vazhdueshëm të përkrahjes për Qendrën për Siguri Kibernetike dhe Privatësi, si dhe përmes divizionit, UBT-CERT.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli ka thënë se për të pasur më shumë siguri në krimet kibernetike, duhet të hartohen strategji dhe vegla ligjore, kjo me qëllim që të mos krijohen dëme të pariparueshme.

Kryeparlamentari Veseli tha se këto procese janë sfidë që duhet të tejkalohen dhe se për këtë qëllim sipas tij, është krijuar edhe Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, me qëllim të përkrahjes së këtij sektori.

Veseli iu bëri thirrje hakerëve të rinj që të respektojnë privatësinë dhe që zhvillimet teknologjike t’i shfrytëzojnë për të mirën e vendit.

“Është një sfidë që duhet të tejkalojmë dhe rrugë që duhet të ndjekim me përgjegjësi, por sektori i teknologjisë informative do të mbështet edhe më shumë”, ka thënë ai, duke shtuar se Kosova ka rini të talentuar me ide inovative, e cila do të mbështetet për të shfrytëzuar sektorin e teknologjisë informative, si mundësi e zhvillimit ekonomik të vendit.

Në konferencën e tretë për siguri kibernetike ka marrë pjesë edhe Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, i cili ka thënë edhe Kosova është e rrezikuar nga sulmet kibernetike, teksa tha se këto krime janë prezentë edhe në jetën private. Tutje, Haradinaj tha se vendi është vonuar sa i përket angazhimit në sigurinë kibernetike, por sipas tij, tashmë Kosova po punon për të zënë trendet botërore.

“Mund të them lirisht se na ka zënë të papërgatitur. Këto sulmet vijnë nga vetë shtetet, spiunazhet, nga grupet e kriminit te organizuar, hakerët, konkurrentët e biznesit dhe nga akterë të brendshëm të pakënaqur me organizatën që i takojnë”, ka thënë ai, sipas të cilit, duhet të mbajmë përgjegjësi secili që Kosova mos të pësojë nga këto kërcënime, duke shtuar se edhe fëmijët janë të ekspozuar nga komunikimi i pa mbrojtur.

Për të shfaqur mbështetjen e SHBA-ve edhe në fushën e sigurisë e privatësisë, pjesë e konferencës ishte edhe ambasadori Greg Delawie, i cili u shpreh i bindur se vendi i tij do ta vazhdojë mbështetjen e Kosovës për t’i siguruar institucionet e qytetarët.

Ekzistojnë shumë gjëra me të cilat sot po përballen bota, përfshirë edhe sigurinë e privatësinë, që tashmë është shndërruar në sfidë globale.

“E tërë kjo situatë e krijuar, do të ketë ndikim të madh në jetën tonë dhe do ta gdhendin të ardhmen e fëmijëve tanë, sepse rëndësia dhe efektet e tyre tashmë janë prioritet dhe duhet të vazhdojnë të mbeten edhe më tutje”, tha ai.

Delawie vlerësoi se Kosova ka bërë shumë punë dhe avancim në rritjen e nivelit të sigurisë dhe i këshilloi institucionet që të vazhdojnë të angazhohen, me qëllim të luftimit të dëmeve që vijnë nga krimet kibernetike, përfshirë edhe parandalimin dhe ndalimin e ngacmimeve online, sulmeve ekonomike e politike, përhapjen e terrorizmit etj., elemente këto, të cilat, sipas ambasadorit amerikan, po e rrezikojnë Kosovën dhe botën.

Ministri i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, tregoi se bizneset por edhe institucionet janë të kërcënuara nga sulmet kibernetike, andaj rekomandoi bashkëpunim në mënyrë që ato të parandalohen.

“Ftojme të gjithë të bashkëpunojmë në fushën e legjislationit dhe te kryejmë hapësirë për komunitetin që merret me këto çështje. Përkrahja e SHBA-së është esenciale sepse është luftues i krimi kibernetik”, tha Beqaj, duke treguar se kërcënimet kibernetikë janë bërë kërcënim edhe për zhvillimin e biznesit edhe sigurinë kombëtare dhe në mënyrë institucionale me njerëzit e komunitetit duhet të bashkëpunojë për ta ndryshuar këtë.



Edhe një sukses i stafit të UBT-së

## Profesoresha e UBT-së, dr Caroline Jäger-Klein zgjedhet presidente e ICOMOS Austria

Profesoresha e angazhuar në UBT, prof. dr Caroline Jäger-Klein, është zgjedhur presidente e Këshillin Ndërkombëtar për Monumente dhe Vende e Austrisë (ICOMOS Austria) nga Asambleja e Përgjithshme e të gjithë anëtarëve, duke u bërë kështu edhe presidentja e parë grua që e merr drejtimin e një organizate të tillë.

Misioni i saj është që të intensifikojë komunikimin ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë në çështjet e trashëgimisë kulturore në përgjithësi, për të futur çështjet më të efektshme në fushën e trashëgimisë botërore brenda ligjit dhe instrumenteve të planifikimit hapësinor të Austrisë dhe për të krijuar një sistem të dhënies së praktikave më të mira për shembuj pozitivë.

Si organ këshillues i UNESCO-s, Jäger-Klein potencoi rëndësinë e anëtarësimit në këtë organizatë, pasi vetëm shtetet anëtare të UNESCO-s, mund të formojnë Komitetet Kombëtare përbrenda ICOMOS-it.

“Sa më shpejt që Kosova të hyjë me sukses në UNESCO, vendi do të jetë plotësisht përgjegjës për të monitoruar vendet e trashëgimisë botërore të UNESCO-s në Kosovë, përfshirë Manastirin Mesjeta të Deçanit, Graçanicës dhe Pejës, për Kishën Ljviska në Prizren dhe shumë monumente e vende të tjera që janë pasuri botërore kulturore dhe arkitekturore”, tregoi ajo.

Edhe pse Kosova momentalisht ka 40 ekspertë të regjistruar në ICOMOS, të gatshëm për të marrë funksione dhe për të

krijuar Komitetin Kombëtar të vendit, megjithatë, për shkak të mosanëtarësimit të Kosovës në UNESCO, një komitet i tillë nuk mund të krijohet ende. E këtë funksion aktualisht e mbajnë edhe disa ish-studentë të UBT-së, ekspertë të fushës së trashëgimisë kulturore.

Për shkak të kësaj, që nga anëtarësimi, Jäger-Klein është munduar t'i japë zë edhe çështjes së Kosovës dhe një pjesë e madhe e asaj çfarë ligjëron për studentët e nivelit master në fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, në UBT, bazohet në përfitimin e njohurive mbi funksionin dhe rolin e ICOMOS-it.

Krahas kësaj, në vitin 2013, ajo drejtoi të ashtuquajturin Takim Rajonal të Përfaqësuesve të ICOMOS-it në Evropën Juglindore, në Vjenë, ku kishte ftuar dy akademikë të rinj nga Kosova, ish-studentë të UBT dhe Universitetit Teknik të Vjenës, Kushtrim Riza dhe Mirushe Ejupi, të cilët janë njohës të mirë të kësaj fushe.

Ajo çfarë Jäger-Klein do të bëjë në vazhdim si presidente e ICOMOS Austria, është të organizojë seminare të përbashkëta monitorimi mes disa vendeve, për të edukuar vëzhguesit e mundshëm të Kosovës, nën ekspertizën dhe mbikëqyrjen ndërkombëtare, si dhe do të organizojë takime më të rregullta të Grupit Evropian Juglindor, në kuadër të kornizës së konferencës vjetore të UBT-së, që mbahet në Durrës të Shqipërisë.

Organizata ICOMOS u themelua në vitin 1965 dhe aktu-



Prof. dr. Caroline Jäger-Klein

alisht numëron rreth 10 000 anëtarë nga gati 200 shtete, të cilët shërbejnë si trup këshillues për UNESCO.

Prandaj, kjo organizatë është platforma më efektive e shkëmbimit të njohurive, ideve dhe përvojës në fushën e trashëgimisë kulturore dhe arkitekturore.

Ngjarja “Viti Mbarëkombëtar i Skënderbeut”

## Inxhinieri Robert Kote në UBT tregon historinë e themelimit dhe ndërtimit të Muzeut “Gjergj Kastrioti – Skënderbeu”



Ngjarja “Viti Mbarëkombëtar i Skënderbeut”, i bëri bashkë në bashkëbisedim studentët e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor të UBT-së dhe inxhinierin përgjegjës për ndërtimin e Muzeut të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut”, në Krujë, Robert Kote.

Në mes rrëfimit mbi procedurat e komplikuar të ndërtimit të muzeut, inxhinieri Kote shpalosi edhe kujtime të shumta përgjatë gjithë atyre viteve sa zgjati finalizimi i projektit.

Në ligjëratën e mbajtur për studentët, ai tregoi se ky muze e ka edhe karakterin e një memoriali që trajtohet si kullë shqiptare e Veriut, dhe për të njëjtin, si arkitektë punuan Piro Vaso dhe Pranvera Hoxha.

“Në këtë muze janë të ekspozuara shumë objekte, dokumente, bibliografi origjinale, riprodhime autentike, të cilat grumbullojnë historinë e popullit shqiptar, sidomos prej

shek. XV e tutje”, tha Kote.

Krahas punës së bërë në këtë muze, ai shpërfaqoi edhe shumë detaje mbi njerëzit që punuan, punët që u kryen dhe vështirësitë e sfidat që u dolën përballë, për të krijuar si rezultat një muze i cili sot është ndër më të vizituarit në trojet shqiptare.

Takimi me studentët përfundoi me hapjen e ekspozitës me fotografi, të cilat u vendosën në Kampusin Inovativ të UBT-së, në Lipjan.

Fotografitë e ekspozuara janë të njëjta me ato të cilat janë të ekspozuara edhe në Muzeun “Gjergj Kastrioti – Skënderbeu”, të pikturuara me dorë nga piktorë të njohur të kohës.

Për shkak të rëndësisë së temës dhe pamjes së fotografive, aktiviteti ngjalli vëmendjen e dhjetëra arkitektëve të rinj të UBT-së.

Nga autori Shaban Murati

## U promovua libri “Çështja e pagënë e detit: Një intrigë diplomatike greke apo shqiptare”

Në UBT është mbajtur konferenca në të cilën është diskutuar rreth projektligjit për energjinë efiçente, proces i cili është edhe kriter për integrimin e Kosovës në BE.

Si rezultat i kësaj, rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi ka thënë se energjia është temë e rëndësishme për vendin, andaj sipas tij, duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë dhe se duhet të përcjellën trendet e shteteve në zhvillim për implementim të suksesshëm të ligjeve që hartohen.

“UBT ka edhe Fakultetin për Energji Efiçente, në të cilën trajtohen tematika të ndryshme rreth kësaj fushe. Forumi është një koment ku ne reflektojmë nga përvojën tona, nga studimet tona. Kemi strategji të shumta, kemi zhvillime dhe projekte interesante, por kemi edhe shumë për të bë për efiçencë. Ligji është në zhvillim, këtë ligj do ta trajtojmë si çështje”, ka thënë rektori Hajrizi, duke shtuar se si temë ka lidhje me tematikat e integritimeve evropiane.

Në këtë konferencë i pranishëm ishte edhe këshilltari në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Halit Hoxhaj, ku tha se si projektligji ka qenë në plan të kalojë qysh në tetorin e vitit të kaluar, por se nga raportet është konstatuar se ka mungesë të resurseve humane.

“Të gjitha komunat duhet të kenë zyre komunale për efiçencë dhe se duhet të ketë auditor të certifikuar, e mbi të gjitha sektori provat duhet të ketë konsulent të prezantojnë projekte e të përfitojnë fonde që ofrohen nga sektori”, ka thënë Hoxhaj, duke treguar se Korniza ligjore e menaxhimit të financave është konsultative. Të gjithë donatorët kanë kërkuar një institucion që është jashtë kornizave.

Ligjëruesja në UBT, Pranvera Dobruna ka theksuar se projektligji në fjalë është i kompletuar dhe se veç tjerash, ofron edhe shumë vende të reja të punës.

“Shumë studentë ose kuadro do të përgatiten profesionalisht sepse ky proces do të ofrojë shumë vende të reja të punës. Është një ligj mjaft komplet dhe mjaft mirë i ka adresuar të



gjitha çështjet”, tha ajo.

Ligji për Efiçencë të Energjisë, rregullon dhe përgatit aprovimin e planeve për efiçencë dhe masat e energjisë, njëherësh edhe obligimet e sektorit publik, si dhe themelimin e institucioneve përkatëse për implementimin e masave e efiçencës së energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit, nëpërmjet stimulimit të reduktimit të konsumit të energjisë.

## Bashkëpunimi ndërkombëtar

## Tash e tutje, UBT edhe në Budapest të Hungarisë

Qendra e UBT-së në Budapest të Hungarisë është hapi i radhës i këtij institucioni drejt rritjes së bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe sidomos drejt krijimit të mundësive të reja të studentëve të këtij institucioni për vazhdimin e studimeve në universitetet hungareze dhe të shteteve të rajonit.

Kjo zyrë, që do të funksionojë në objektin e Universitetit Szent István të Budapestit, është rezultat i bashkëpunimit të shkëlqyer të UBT-së me universitetet më prestigjioze të Hungarisë, me të cilat UBT ka marrëveshje bashkëpunimi.

Dhjetëra pjesëtarë të stafit dhe studentë të UBT-së, tashmë, si rezultat i marrëveshjeve të bashkëpunimit, vazhdojnë studimet në universitetet hungareze, përfshirë edhe studimet e doktoratës.

Zyra e UBT-së në Budapest do të drejtohet nga një bord i përbërë nga përfaqësues të shkencës e akademisë, përfaqësues të bizneseve e personalitete të ndryshme publike.

Në një takim të këtij bordi, Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, theksoi rëndësinë e madhe të kësaj zyre, në funksion të përfaqësimit të UBT-së në Hungari, një nga vendet me të cilat UBT ka më së shumti bashkëpunim në fushën akademike.



Gjithashtu, ajo do të shërbejë edhe si qendër e realizimit të projekteve të hulumtimeve të përbashkëta ndërkombëtare, në shumë fusha me interes të dyanshëm. Një numër projektesh të përbashkëta tashmë janë realizuar.

Zyra e UBT-së në Budapest i shtohet zyrave që tashmë funksionojnë në Vjenë e në Tiranë, krahas kampuseve në Prishtinë, Lipjan, Prizren, Ferizaj e Pejë e zyrës në Gjilan.

## Përfaqësuesit e Northern Illinois University nga Çikago, vizituan UBT-në

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ka pritur në takim një delegacion nga Northern Illinois University nga Çikago e SHBA-së, me të cilët ka biseduar për zhvillimet dhe të arriturat e këtyre institucioneve dhe për mundësinë e lidhjes së bashkëpunimit në nivel akademik.

Delegacioni ka qenë i prirë nga dekani i Fakultetit të Biznesit në Northern Illinois University, prof. dr. Balaji Ragopajan dhe nga drejtori i Programit Global i këtij universiteti, Anthony Preston.

Pas takimit me rektorin Hajrizi, ata kanë zhvilluar një

takim edhe me stafin akademik të UBT-së, ku ndanë përvojën e tyre dhe u zotuan për fillim dhe thellim të bashkëpunimit.

## Përfaqësuesit e UBT-së në vizitë zyrtare në Gjermani



Një delegacion i UBT-së, i përbërë nga Dekani i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Lulzim Beqiri, si dhe profesorët Binak Beqaj, Arbër Sadiku dhe Banush Shyqeriu kanë qëndruar për vizitë pune në Universitetin e Shkencave të Aplikuara "Bauhaus" në Gjermani.

Aty janë pritur nga përfaqësuesit e këtij universiteti, ku kanë biseduar për realizimin e projekteve në fusha të ndryshme, e që janë interes të përbashkët. Palët kanë shqyrtuar mundësitë e bashkëpunimit në organizimin e punës të përbashkëta, zhvillimin e ligjëratave tematike, shkëmbim të studentëve dhe stafit akademik etj.

Po ashtu, përfaqësuesit e institucioneve u zotëruan se do të bashkëpunojnë në ngritjen e cilësisë së arsimit, përkatësisht edhe në ngritjen e nivelit intelektual dhe profesional të gjeneratave të reja.

## Përfaqësuesit e UBT-së dhe Universitetit të Zagrebit diskutojnë për zhvillimin e projektit "BESTSDI"

Një delegacion nga Universiteti i Zagrebit, të prirë nga profesorët Zhelko Baqic dhe Vesna Polslonqec-Petriç, kanë qëndruar në UBT, ku janë pritur nga rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi.

Kjo vizitë është si rezultat i implementimit të projektit "BESTSDI", përmes të cilës institucionet po kryejnë hulumtime të përbashkëta akademike, po zhvillojnë projektin për adaptimin e kurrikulave aktuale, si dhe po punojnë në hartimin dhe krijimin e kurrikulave të reja për infrastrukturën e të dhënave hapësinore.

Në këtë takim është diskutuar edhe për rezultatet e arritura nga implementimi i deritanishëm i projektit, teksa me këtë rast prof. Zhelko Baqic ka vlerësuar lartë angazhimin e UBT-së në të gjitha fazat e projektit.

Ndërkohë, rektori i UBT-së, prof.dr. Ed-

mond Hajrizi është shprehur se bashkërisht do të punohet në realizimin e suksesshëm të objektivave të projektit, pasi siç tha ai, vetëm në këtë mënyrë do të ketë zhvillim dhe avancim akademik.

"Do të krijohet një program për studime në të cilin do të përfshihen në tërësi qëllimet dhe objektivat projektit, me theks të veçantë për gjeoinformacionin dhe bazën e të dhënave", tha ai.

Projekti që po zhvillohet në bashkëpunim nga dyja institucionet, ka për qëllim arritjen e perfeksionimit të mëtejshëm për kurrikulat studimore, teksa parasheh koordinim dhe shkëmbim të eksperiencave me gjithë partnerët e projektit.

Ky projekt zhvillohet në kuadër të programit Erasmus+ dhe po financohet përmes fondeve të Bashkimit Evropian.



## Rektori Hajrizi nderohet me Çmimet “Akademik Nderi” dhe “Profesor Nderi”

Në një ceremoni të mbajtur në UBT, Complutense University i Madridit dhe Akademia e Shkencave Sociale nga Palm Beach University, në Florida, kanë vlerësuar nderuar kontributin e rektorit të UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, në fushën e arsimit dhe shkencës.

Për këtë, këto dy institucione e kanë nderuar Hajrizin me titullin “Akademik Nderi”, përkatësisht “Profesor Nderi”, tituj këta që dhurohen për personalitete që japin kontribut shumëvjeçarë për përmirësimin dhe ngritjen e cilësisë së arsimit.

Këto dy çmime i ndau anëtari i Akademisë Ndërkombëtare,

prof. dr Otto Flein- genblatt, i cili i vlerësoi përpjekjet e pareshtura dhe të suksesshme të rektorit dhe akademikëve të tjerë të Kosovës, në përmirësimin dhe ngritjen e imazhit të arsimit kosovar në botë.



## Rektori Hajrizi përfaqëson Kosovën në Asamblenë e Përgjithshme të EUROSIM-it



Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, ka marrë pjesë në takimin e Asamblesë së Përgjithshme të Federatës Evropiane të Asociacioneve Kombëtare për Modelim dhe Simulim (EUROSIM), që është forum evropian në të cilin Kosova përfaqësohet nga UBT, përmes Asociacionit Kosovar për Modelim dhe Simulim. Në këtë takim janë diskutuar në detaje punët e realizuara gjatë vitit të kaluar, me ç'rast Kosova u vlerësua lartë për realizimin e punëve gjatë vitit 2017.

Anëtarët e forumit kanë shqyrtuar edhe mundësitë për realizimin e shumë projekteve për të ardhmen.

Me këtë rast, rektori Hajrizi ka vlerësuar se pjesëmarrja në këtë forum është

mundësi unike për komunikim akademik të Kosovës me vendet tjera anëtare, që aktualisht po sjellin inovacione në arsim.

“Anëtarësimi dhe pjesëmarrja e Kosovës në nivel ndërkombëtar në fushën e arsimit, është një arritur që po realizohet përmes UBT-së dhe përfaqësimi e Kosovës nëpër organizime të tilla flet shumë për ndikimin që institucioni ynë e ka në ndërkombëtarizimin e arsimit të vendit tonë”, theksoi ai

Tutje, grupi punues i EUROSIM mori pjesë edhe në konferencën vjetore ndërkombëtare e shkencore për Modelim dhe Simulim, të organizuar nga “IFAC”, punimet e së cilës janë zhvilluar në Vjenë të Austrisë.

## Rektori Hajrizi realizon vizitë pune në Universitetin e Kembrixhit

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, ka realizuar vizitë pune në Universitetin e Kembrixhit, pjesë e të cilës ishte edhe UNDP, gjatë të cilës u bë diskutimi i modaliteteve për bashkëpunim ndërinstitucional me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të auditorëve të performancës të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës. Për këtë qëllim, Hajrizi ishte pjesë e një punëtorie të përbashkët për harmonizimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve që lidhen me ngritjen e kapaciteteve profesionale të auditorëve të performancës dhe të Auditorit Gjeneral të Kosovës, që do të pasohet me themelimin e një qendre të

përbashkët për vlerësimin e kapaciteteve të auditorëve të performancës në Kosovë. Për të ndihmuar në funksionalizim, UBT ka themeluar edhe qendrën e vet të titulluar Resilience and Sustainable Development Center.

Ky projekt është pikënisja e bashkëpunimit mes këtyre institucioneve, me qëllim të realizimit të projekteve të tjera të kësaj natyre, që kanë rëndësi të madhe për rritjen e nivelit të performancës të institucioneve të kyçe në Kosovë dhe më gjerë.



## Rektori Hajrizi, panelist nga Kosova në konferencën “Creativity Forum Ljubljana”, në Slloveni

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi mori pjesë në konferencën dyditore “Creativity Forum Ljubljana”, të organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Sllovenisë dhe organizata “ Union for the Mediterranean”.

Hajrizi, me ftesën e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Sllovenisë, ishte panelist në panelin më temë: “Ndërmarrësia dhe teknologjia kreative dhe rritja ekonomike”, ku u trajtua ndikimi i industrisë krijuese dhe kulturore në rritjen e ekonomisë globale, rastet e suksesit në vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, krijimi i vendeve të punës, dizajnimi i sistemeve inovative bazuar në ekonominë cirkulare dhe roli i edukimit dhe shkathhtësisë për ekonominë digjitale.

Aty u tha se ngritja e ekonomisë globale ndikon në mënyrë automatike në shtimin

e miliona vendeve të reja të punës në botë, në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe në zhvillimin e mëtutjeshëm të qyteteve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim e sipër.

Kjo konferencë ka për synim të fillojë një rrjet të ri policentrik të industrive kulturore dhe krijuese dhe të shërbejë si model për bashkëpunimin rajonal, për krijimin e vendeve të punës dhe për rritjen ekonomike, si një ndihmesë në krijimin e planit strategjik global të BE-së.

Ngjarja ka për qëllim të krijojë një forcë politike të nivelit të lartë që do të kërkojë të nxisë bashkëpunimin midis Ballkanit Perëndimor dhe Mesdheut Jugor, në aspektin e transferimit të praktikave të mira në Jug dhe në shkëmbimin e pikëpamjeve mbi një gamë të gjerë temash strategjike në Mesdhe.

## Rektori Hajrizi, pjesëmarrës në konferencën “Kosova 10 vjet shtet - Mësimet dhe pritjet”

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, mori pjesë në konferencën shkencore “Kosova 10 vjet shtet - Mësimet dhe pritjet”, të organizuar nga Fakulteti Filozofik i Universitetit të Prishtinës.

Në të morën pjesë edhe një varg personalitetesh të tjera të shquara në fushën e arsimit, edukimit e shkencës nga vendi, rajoni dhe bota.

Ai paraqiti kumtesën e tij të titulluar: “Roli UBT-së në ndërkombëtarizimin e arsimit, shkencës teknologjisë së Kosovës, si dhe drejtoi panelin e prezantuesve, së bashku me akademikun Marenglen Verlin dhe prof. dr Ibrahim Gashi.

Me rastin e prezantimit të tij, Hajrizi tha se përmes UBT-së është mundur që të ofrojë kontribut në zhvillimin dhe përparimin e Kosovës në të gjitha fushat.

“Dhjetëra marrëveshje bashkëpunimi që çuan në ndërkombëtarizimin e çështjes

së Kosovës dhe në pranimin e vendit në shumë organizata të njohura, dërgimi i qindra studentëve për studime jashtë vendit, në një kohë kur qytetarët ende nuk mund të lëvizin lirshëm, punësimi i mijëra studentëve të tjerë brenda e jashtë UBT-së dhe përkrahja e tyre në hapjen e bizneseve të veta, bënë që institucioni ynë të jetë një ndër ndikuesit në ndërkombëtarizimin dhe përparimin e Kosovës, ndonëse me bindje të plotë them se rrugëtimi nuk ka përfunduar ende”, tha Hajrizi.

Konferenca trajtoi në mënyrë shumëdimensionale zhvillimet e një dekade lidhur me shtetndërtimin e Kosovës, e tërë kjo, përmes prezantimit të 27 punimeve shkencore nga pjesëmarrës, akademikë, studiues dhe punëtorë shkencorë nga të gjitha trevat shqiptare, nga fusha të ndryshme të shkencave humane dhe sociale.

Rrëfime sukcesi

## Durim Klaiqi, shqiptari i parë i punësuar në kompaninë SAMSUNG

Studenti i vitit të dytë në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë, në UBT, Durim Klaiqi, është punësuar në kompaninë e njohur botërore, SAMSUNG, ku po e mban pozitën Theme Designer, duke u bërë kështu shqiptari i parë që bëhet pjesë e stafit të kësaj kompanie.



(Durim Klaiqi është vetëm njëri ndër studentët e shumtë të UBT-së që ende pa i përfunduar studimet, kanë arritur të bëhen pjesë e kompanive të mëdha nga të gjitha vendet e botës).

Studenti Durim Klaiqi, arriti të bëhet pjesë e kompanisë së njohur botërore SAMSUNG, pasi kishte përpiluar një portfolio që jep shembuj konceptual për stilin e dizajnit dhe e njëjta u vlerësua pozitivisht nga ekipi i Samsung në dy pika

kryesore, dizajn kualitativ dhe një trajtë unike të dizajnit. Klaiqi është duke punuar në sektorin e kësaj kompanie, të quajtur "Samsung Themes", i cili është një shërbim që ofron personalizimin e pajisjes Android, përmes ndërrimit të User Interface.

Samsung Themes ose Theme Store, është vendi ku shkarkohen pa pagesë ose edhe vendi ku blihen themes, wallpapers ose sete të ikonave, ku tani Klaiqi ka filluar edhe t'i publikojë dizajnimet e para.

Duke folur mbi rrjedhën e punës, që rezultoi me punësim në Samsung, ai tha se është i lumtur që arriti të bëhet pjesë e këtij gjiganti botëror, në të njëjtën kohë kur akoma është student i nivelit bachelor.

Durim Klaiqi është vetëm njëri ndër studentët e shumtë të UBT-së që ende pa i përfunduar studimet, kanë arritur të bëhen pjesë e kompanive të mëdha nga të gjitha vendet e botës, që tashmë i kanë kaluar kufijtë shtetërorë dhe janë shndërruar në brende të njohura ndërkombëtarisht. ■

## Eltis Sulejmani punësohet në UBT – institucion në të cilin studion

Studenti i vitit të tretë në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, Eltis Sulejmani është punësuar në këtë institucion, kjo falë profesionalizmit dhe produktivitetit të treguar përgjatë studimeve.

Këtë mundësi Eltisi e kishte arritur pas mbajtjes së punës praktike në UBT, teksa tashmë është angazhuar për zhvillimin e ueb aplikacioneve orientuar në pjesën Back-End.


Përveç kësaj, ai në bashkëpunim me zyrtarë tjerë të IT-së, ju është dhënë edhe mundësia për ta zhvilluar ueb faqen e re të UBT-së, si dhe projekte e tjera që zhvillohen në UBT.

"Studimet në UBT janë në nivel shumë cilësor, për arsye se UBT ofron shumë mundësi dhe lehtësi për të studiuar dhe nuk mungon mbështetja

e madhe edhe nga stafi", tregoi ai.


Studenti Sulejmani tha se edhe studimet e nivelit master do t'i vazhdojë në të njëjtin drejtim në UBT, deri sa tregoi se synon që të përfitojë bursë, të cilat ofrohen për gjithë studentët e suksesshëm.

UBT ka shkollën më e madhe të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në Kosovë dhe rajon, që zhvillohet me standardet më të larta cilësore, prandaj diploma e UBT-së po njihet edhe ndërkombëtarisht. ■



## Fotografite e studentes Fjolla Çunaku, pjesë e ekspozitave të mëdha në Kosovë

Studentja e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, në UBT, Fjolla Çunaku, ka marrë pjesë në një galeri të organizuar së fundmi, në të cilën lanë qenë të ekspozuara fotografite e saj.



Për të njëjtat, Çunaku ishte nderuar me mirënjohje në garën e organizuar për fotografi, "ËIKI ACADEMY", projekt ky që ka për qëllim që të përmirësojë cilësinë dhe sasinë e përmbajtjeve në internet, si dhe të ndikojë në përfaqësimin sa më të mirë të Kosovës në botë.

Ajo tregoi se puna e saj, qysh atëherë, ishte e koncentruar në shprehjen e bukurive të natyrës kosovare, ndërsa vlerësoi se për avancim të mëtutjeshëm akademik dhe profesional në këtë fushë, UBT ishte zgjedhja më e duhur.

"Zhvillim të dukshëm kam hasur në perceptimin në aspektin fotografik, këtë e vërtetojnë edhe ek-

spozitat në të cilat kam qenë pjesëmarrëse gjatë studimeve në UBT. Ndër to vlen të përmendet ekspozita "6x6", e mbajtur në Prishtinë, në vitin 2016, e cila ishte ekspozitë e fotografive për promovimin e kulturës dhe traditës kosovare. Mora pjesë edhe në ekspozitën "Escape to landscape", që u mbajt këtë vit në Mitrovicë, dhe që për temë kishte përkufizimin e natyrës brenda një kornize", shpjegoi ajo.

Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor është shkolla më e madhe e kësaj fushe në vend dhe rajon, shumica e studentëve të së cilës punësohen ende pa i përfunduar studimet themelore. ■

## Ish-studenti Armend Salihu zhvillon funksione në kuadër të aplikacionit MATLAB

Studentët dhe ish-studentët e UBT-së tentojnë që përmes përfundimit të temave të tyre të diplomës, njëkohësisht të bëjnë edhe zgjidhje efikase për problemet aktuale të botës moderne.

Në saxe të kësaj, ish-studenti i UBT-së, Armend Salihu, ka diplomuar në nivelin master, në Fakultetin Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri, duke e mbrojtur temën e titulluar: "Eficiencia kompjuterike e llogaritjes së determinantave, krahasimi i metodave të njohura me metodat e reja", dhe të gjitha këto, janë bërë në kuadër të aplikacionit MATLAB.

"Në kuadër të aplikacionit MATLAB, si softuer i llogaritjeve teknike dhe numerike, në këtë temë unë kam zhvilluar funksione për llogaritjen e determinantave duke e përdorur metodën e Laplastit, si dhe dy funksione për llogaritje të determinantave duke i përdorur metodat e mia, të cilat i kam prezantuar në konferenca dhe revista shkencore e ndërkomb-

bëtare", tregoi studenti Salihu, duke i krahasuar metodat e tij me ato tashmë ekzistuese.

"Nëse e krahasojmë nga sistemi kompjuterik se cila metodë është më efikase, se cila kërkon më pak resurse kompjuterike dhe që llogaritë më shpejt, është vërejtur se metodat e mia janë shumë më efikase se sa metodat e njohura deri më tani për llogaritjen e determinantave, andaj edhe janë më praktike për përdorim nga të gjithë".

Përveç elaborimit të teorisë së determinantave, në temën e tij, ai i është referuar edhe disa punimeve të cilat nuk janë të zakonshme për tema të nivelit master, për shkak se një referim i tillë bëhet vetëm në tema të doktoraturës. ■



Rrëfime suksesi

## Ish-studenti i UBT-së publikon libër në fushën e arkitekturës



Ish-studenti i UBT-së në Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Albert Mustafa, është autori i librit më të ri në fushën e arkitekturës.

Libri “Dimensioni i përjetimit dhe perceptimit në arkitekturë”, botimi i së cilit është bërë nga Shtëpia Botuese “DITURIA”, në Tiranë, është vlerësuar lartë nga ekspertët e kësaj fushe.

“Kur arkitektura kërkon emocionin dhe perceptimin shpirtëror, lind një libër interesant, i vlefshëm dhe me një këndvështrim origjinal, si libri “Dimensioni i përjetimit dhe perceptimit në arkitekturë”, me autor Albert Mustafa.”, kështu shprehet Shtëpia Botuese e librit, me rastin e publikimit të tij.

Përshkrimi i librit:

Trajtimi i arkitekturës në dimension më tepër shpirtëror e emocional, siç është dimension i përjetimit dhe perceptimit në arkitekturë, është thelbi i këtij libri.

Hapësira arkitektonike dhe mënyra se si e perceptojmë atë, si dhe përjetimi i kësaj hapësire, janë indikatorë të fuqishëm

në jetën e njeriut. Prandaj, këto dy çështje janë trajtuar jo vetëm në rrafshin arkitektonik, por edhe në atë filozofik, psikologjik e emocional.

Çfarë është perceptimi si dukuri, psikologjia e perceptimit dhe emocionit, gjuha shprehëse e arkitekturës, dimension i njerëzor në arkitekturë, mekanizmat për perceptimin e hapësirës, elementet frymëzuese në një hapësirë arkitektonike, si dhe arkitektura si burim kënaqësie, janë disa nga këndvështrimet që trajtohen në këtë libër.

Shembujt e përdorur synojnë të mbështesin dhe pasqyrojnë pjesën filozofike dhe teorike të problemit, në mënyrë që thelbi i çështjes të përcillet te lexuesi, sidomos te studentët e arkitekturës, për arsye se reflektimi nga ana e tyre do të ishte i rëndësishëm, në mënyrë që ky të jetë fillimi i një fundi ku arkitektura bëhet më së paku për njeriun dhe për ndjenjat e tij, duke u kthyer në një fillim ku arkitektura do të shihet si një instrument që tenton të arrij ndjenjat më të thella njerëzore.

## Jehon Kadrija, i punësuar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Ish-studenti i Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, Jehon Kadrija, është punësuar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, konkretisht në Agjencinë e Punësimit dega në Skenderaj.

Studenti Jehon Kadrija, mban pozitën e asistentit administrativ, ku përgatit dhe modifikon dokumente, jep mbështetje administrative, teknike etj.

Kadrija tha se UBT i ka ndihmuar shumë në aftësim profesional, ku sipas tij, përkrahja nga profesorët dhe jo vetëm, bëri që t'i arrijë qëllimet e tij.

“UBT është institucion arsimor që ofron plan programe të akredituara dhe të pranuar edhe

ndërkombëtarisht, faktor ky i cili ka bërë që pikë synim të kem UBT-në për studime. Gjithë studentët duhet të zgjedhin më të mirin që të sigurojnë një të ardhme të sigurt”, vlerësoi ai.

Tutje, ai tha se programi akademik i Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, ofron mundësi të studimeve me një ambient të përshtatshëm universitar, në këtë mënyrë, studentët e këtij institucioni po i arrijnë qëllimet e veta.



## Alban Misini i UBT-së, projektues i shumë ndërtesave të njohura në Gjermani

Ish-studenti i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, Alban Misini është duke punuar si arkitekt në kompaninë projektuese “Architekturbüro Rothenpieler”, në Gjermani, i cili falë profesionalizmit ka arritur të projektoj shumë ndërtesa të njohura.



**UBT ishte institucioni i parë i arsimit të lartë në Kosovë, i cili solli inovacione në shumë fusha jetësore dhe po ashtu solli shumë programe moderne, të cilat studentët i shfrytëzojnë për të studime në fushën e arkitekturës”, tha Misini**

Aktualisht, Alban Misini së bashku me arkitektë gjerman janë duke e projektuar kompleksin hotelier “Golfi”, në të cilin përfshihen mbi dhjetë objekte. Po ashtu, ai është duke projektuar edhe një qendër tregtare që financohet nga kompania e njohur evropiane “Metro”.

“UBT ishte institucioni i parë i arsimit të lartë në Kosovë, i cili solli inovacione në shumë fusha jetësore dhe po ashtu solli shumë programe moderne, të cilat studentët i shfrytëzojnë për të studime në fushën e arkitekturës”, tha Misini, duke treguar se UBT i ofron studentëve të vet shumë mundësi, përfshirë edhe vazhdimin e studimeve në universitete

botërore.

Si rezultat i bashkëpunimit të UBT-së me mbi 250 universitete botërore, ai ishte transferuar për të vazhduar studimet e nivelit master në Universitetin “Siegen”, të Gjermanisë, andaj kjo është edhe një nga shumë arsye që qindra studentë fillojnë studimet në UBT.

Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, është njëri ndër më të mëdhenjtë në Kosovë e më gjerë, nga i cili studentët dalin të përgatitur dhe me njohuri të mjaftueshme për të siguruar vende pune menjëherë pas përfundimit të studimeve bazike.

## Projektet e studentëve të UBT-së, prezantohen në Gjermani

Studentët e UBT-së, të cilët si rezultat i projektit “Erasmus +” janë transferuar për një semestër në Universitetin e Shkencave të Aplikuara “Bauhaus” në Gjermani, Stina Shabani, Lindi Hasangjekaj, Valmir Kastrati dhe Fiton Zogaj, kanë prezantuar punime nga fusha e arkitekturës, urbanizmit dhe dizajnit të integruar, projekte që janë në kuadër të lëndëve semestrale.

Punimet në fjalë janë vlerësuar nga komisioni një përbërje me profesorët ndërkombëtarë nga Gjermania, Italia, Holanda etj., të cilët janë mahnitur me rezultatet e nxjerra nga projektet hulumtuese. Sipas komisionit vlerësues, në projektet e studentëve janë zhvilluar shumë koncepte arkitektonike, projekte të cilat i përgjigjen kërkesave

shoqërore, kontekstit historik dhe atij urban.

Në prezantimin e projekteve kanë marrë pjesë edhe delegacioni i UBT-së, i përbërë nga Dekani i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Lulzim Beqiri, si dhe profesorët Binak Beqaj, Arbër Sadiku dhe Banush Shyqeriu, të cilët ishin në një vizitë punë në këtë universitet gjerman.

Partneriteti i UBT-së me mbi 250 universitete prestigjioze dhe institucione ndërkombëtare po shërben si urë lidhëse nëpër të cilin po kalojnë studentët e UBT-së, të cilët lehtësisht po bëhen pjesë e universiteteve të njohura botërore, krahas studentëve nga institucionet tjera.



## Rrëfime sukcesi

## Studentja e UBT-së, vijon studimet në Universitetin “NOVA de Lisboa”, në Portugali



Partneriteti me universitetin e Portugalisë, “NOVA de Lisboa”, u ka krijuar mundësi studentëve të UBT-së për të studiuar në gjitha programet akademike që i ofron ky universitet.

Në mesin e shumë studentëve që fituan bursë për t'i ndjekur studimet për një semestër të vitit akademik është edhe Shqipe Sejdiu, e cila po vijon studimet në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike.

Studentja Sejdiu ndër tjerash është shprehur se mundësia për të vazhduar studimet në “NOVA de Lisboa” është falë projekteve të përbashkëta dhe bashkëpunimit që UBT ka

me këtë universitet.

“Studentët e kanë mundësinë të qëndrojnë disa muaj në këtë universitet, andaj, ne si studentë jemi duke përfituar nga shërbimet mujore, kurset e gjuhës, si dhe njohjen me njerëzit dhe kulturat e reja”, tha Sejdiu.

Mundësia për bashkëpunim dhe shkëmbim të studentëve midis UBT-së dhe universitetit “NOVA de Lisboa”, është në kuadër të Programit evropian për studime, Erasmus +. UBT e universiteti “NOVA de Lisboa” i Portugalisë tashmë janë në një projekt të përbashkët dhe kanë bashkëpunim të vazhdueshëm në projekte evropiane e ndërkombëtare. ■

## Studentja Edona Jerliu, pjesë e grupit punues për testimin e Platformës për Qeverisje të Mirë

Studentja e Fakultetit Media dhe Komunikim, në nivelin master. Edona Jerliu, ka marrë pjesë në grupin punues për testim të Platformës për Qeverisje të Mirë, në Kosovë, e cila i dedikohet qytetarëve për t'u informuar lidhur me funksionet komunale.

Platforma është ideuar nga Instituti për Demokraci dhe Zhvillim (D4D), me qëllim të përmirësimit të njohurive të zyrtarëve komunalë dhe të qytetarëve për funksionimin korrekt të

procedurave dhe marrëdhënieve në institucionet publike.

Fokus grupi, pjesë e të cilit ishte studentja e UBT-së, ka bërë testimin e specifikave të kësaj platforme, duke u fokusuar në lehtësinë për qasje në informata, si dhe në përdorimin e kësaj platforme me aktorë relevantë të fushës së shoqërisë civile, institucioneve publike lokale dhe qendrore dhe qytetarëve.



## Studentja Jonida Xhema shpërblehet me Çmimin “Hulumtimi më i mirë”, në Venecia të Italisë



Studentja e MBE-së në nivelin master, Jonida Xhema, ka marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të ISERD-it (International Society for Engineering Research and Development), që u mbajt më 22 shkurt në Venecia të Italisë, prej ku edhe u shpërblye me Çmimin “Hulumtimi më i mirë”.

Në këtë konferencë ku morën pjesë qindra studiues dhe hulumtues nga e gjithë bota, ajo prezantoi hulumtimin e saj shkencor të titulluar: “Si Produkti/ Shërbimi i Cilësisë dhe Imazhi i Korporatës ndikojnë në besnikërinë e klientit: Një studim empirik”.

Për këtë sukses të arritur në nivel ndërkombëtar, Xhema tha se i kanë ndihmuar studimet në UBT, meqë, sipas saj, kanë ndikuar që të jetë vazhdimisht në rrjedha me zhvillimet e

fundit akademike në mbarë botën.

Në veçanti, ajo i vlerëson njohuritë e fituara nga lënda “Metoda të Hulumtimit”, të cilat janë bazë për këto arritje të saj.

“Më ka ndihmuar shumë lënda “Metoda të Hulumtimit”, për arsye se kam mësuar se si të bëj analiza statistikore me programe shumë të sofistikuar, përkatësisht me SPSS Statistics, në formë të korrelacionit dhe regresionit”, u shpreh studentja Xhema.

Përpos në konferencat ndërkombëtare që organizohen nga UBT, studentëve të të gjitha drejtimeve u ofrohen mundësi të panumërta për ta shfaqur punën e tyre kërkimore në konferencat që organizohen në shtete të ndryshme të botës. ■

## Studentja Vesa Kelmendi fillon praktikën në BKT

Studentja e vitit të tretë në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë, Vesa Kelmendi, ka filluar praktikën në BKT, në pozitën e zhvillueses së softuerëve.

Kelmendi tregoi se informatat mbi konkursin për aplikim i ka marrë nga Qendra e Karrierës e UBT-së, ndërkaq më pas, ajo i është nënshtruar disa testeve dhe intervistave, nga të cilat

doli e suksesshme dhe arriti ta fitonte këtë pozicion.

Përpara kësaj, ajo ka punuar edhe për një kompani gjermane në Pejë, si ka qenë edhe studente ambasadore e UBT-së. Megjithatë, synimet e studentes Kelmendi janë shumë më të mëdha. Ajo po planifikon që studimet e nivelit master t'i vijojë në njërin nga universitetet e Evropës.



## Studentja Albenita Mahalla e përfaqëson UBT-në në BritTalks 2018



Studentja e Dizajnit të Integruar në UBT, Albenita Mahalla, ka qenë pjesëmarrëse në “BritTalks 2018”, me ç'rast edhe e ka përfaqësuar UBT-në, përkatësisht Fakultetin Dizajn i Integruar, në Ferizaj.

Në këtë organizim ajo u përfshi në pyetje të përgjithshme, drejtuar ambasadorit të Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruarí O'Connell.

Ajo pati rastin të takohet dhe të flasë edhe personalisht me

ambasadorin O'Connell dhe me profesorin Iraj Hashi, me të cilin diskutoi për avancimin e edukimit profesional në Kosovë dhe për mundësitë që ofron UBT për studime jashtë shtetit, si dhe për kontributet tjera të UBT-së, si universitet privat në Kosovë.

Studentët e UBT-së në vazhdimësi po marrin pjesë dhe po e përfaqësojnë institucionin dhe Kosovën nëpër gara, konferenca e organizime të tjera vendore e ndërkombëtare. ■

## UBT – zgjedhja e parë për studentë që transferohen

Albulena Balaj është një nga qindra studentë të cilët shfrytëzuan mundësinë për të vazhduar studimet bachelor dhe master në UBT.

Dikur ajo studioje në një institucion tjetër privat arsimor, mirëpo kishte vendosur që të transferohej në UBT, kjo sepse, sipas saj, diploma e institucionit njihet ndërkombëtarisht dhe studentët qasen lehtësisht në tregun vendor e ndërkombëtar të punës.

Aktualisht, studentja Balaj vijon studimet në Fakultetin Me-

dia dhe Komunikim dhe thotë se e ka zgjedhur këtë profesion për shkak të pasionit për median, kamerën dhe filmin.

Ajo ka theksuar se UBT ia ka ofruar kushtet ideale për të zhvilluar profesionin që ajo ka zgjedhur dhe pas kësaj, vazhdimisht po merr pjesë në aktivitetet që zhvillon ky institucion. “Vendosa të transferohem për shkak se UBT ka kualitet në mësimdhënie e mësimnxënie dhe ofron mundësi të shumta për studentët, përfshirë punën praktike”, tha Balaj, duke shtuar se edhe profesorët janë të përgatitur profesionalisht në lëndët që ligjërojnë.

Vetëm vitin e kaluar në UBT janë transferuar mbi 400 studentë që studionin në institucione publike e private, teksa aplikimi për transferim në afatin e dytë fillon nga data 1 shkurt deri më 28 shkurt, por paraprakisht duhet të ndiqen disa procedura.

Fillimisht studentët duhet të plotësojnë formularin për aplikim, me kusht që të kenë përfunduar së paku një provim nga aty ku vijnë. Aplikimi bëhet në zyrën e administratës së UBT-së, ndërkaq të interesuarit për transferim nuk e kanë të nevojshme të marrin leje nga institucionet ku studiojnë aktualisht. ■

## Studentët e Medias dhe Komunikimit realizojnë punime mbi tema që po diskutohen në nivel global

Studentët e nivelit master në Fakultetin Media dhe Komunikim, në UBT, përgjatë një semestri kanë studiuar, e më pas edhe realizuar punime ku kanë trajtuar tema të shumta dhe aktuale në fushën e mediave.

Punimet e studentëve janë realizuar në kuadër të lëndëve, “Media në epokën digjitale” dhe “Gazetari dhe raportim”, të ligjëruara nga profesorët, prof.dr Edmond Hajrizi, Adnan Merovci dhe Ferid Selimi.

Studentët trajtuan tema të shumta, përfshirë: “Konvergencën e mediave”, “Lajmet e rrejshme dhe mediat e reja online”, “Intervista dhe llojet e pyetjeve”, “Rregullimi dhe vetërregullimi i mediave në Kosovë”, “Ndikimi i mediave digjitale dhe të shkruara tek fëmijët”, “Digjitalizimi në Kosovë”, “Mediat – interneti dhe rrjetet sociale në Kosovë”, “Roli diplomatik i mediave sociale; Rasti SHBA-Koreja Veriore”, “Besueshmëria në mediat online” etj., si tema që tash janë duke i pushtuar debatet në nivel global në rrafshin medial.

Duke folur për punimet e studentëve, ligjëruesi i lëndës, Adnan Merovci, tha se këto punime kanë vlerë të veçantë për faktin se janë punuar profesionalisht.

Ai vlerësoi se UBT është institucioni më i kompletuari në vend dhe rajon për studime në këto fusha.

“Studentët e nivelit master zhvilluan punime me temë të përzgjedhura nga vetë ata, të cilat ishin shumë interesante dhe provokuan kërshërinë e të pranishmëve”, tha Merovci.

Teksa, dekani i Fakultetit Media dhe Komunikim, në UBT, prof.dr Ferid Selimi tregoi se punimet në fjalë janë punuar me përkushtim të madh, me anë të të cilave sipas tij, studentët do të kontribuojnë në fushën e medias në përgjithësi.

“Studentët gjatë prezantimit të punimeve hulumtuese treguan seriozitet. Punimet që i kanë hulumtuar dhe punuar, janë bërë sipas standardeve dhe rregullave të shkrimit akademik, punime të cilat mund të publikohen në ndonjë revistë shkencore”, tregoi ai.

Programi i Medias dhe Komunikimit në UBT, ofron specializimet më të veçanta në vend: Komunikimi Politik dhe Mediat Digjitale, specializime ku janë të vetmet e këtij lloji në vend.



## Studentët e SHKI-së, në punimet e tyre i trajtojnë sfidat globale



Studentët e Fakultetit Shkencë Kompjuterike dhe Inxhinieri, në UBT, kanë bërë prezantimin e punimeve, që i kanë kryer përgjatë punës një semestrale me profesoreshën, Krenare Pireva-Nuci dhe të cilat do të jenë pjesë e Konferencës Dimërore të Studentëve, që do të mbahet gjatë muajit mars të këtij viti.

Në këto punime, studentët kanë trajtuar dhjetëra tema të shumta dhe aktuale, duke përfshirë: “Zhvendosja e aktivitetëve tona në hapësirat kibernetike”, “Impakti i inteligjencës Artificiale në Edukim, Mjekësi e më gjerë”, “Impakti i veturave pa vetë-vojitëse”, “Përdorimi i sistemeve rekomanduese në aplikacione të ndryshme”, “Adaptimi i sistemeve të edukimit duke përdorur teknika

të Inteligjencës Artificiale”, “Shfrytëzimi i Open Education Resources: Mundësi të reja”, “Kërcënimet eventuale gjatë përdorimit të hapësirës kibernetike”, “Teknikat më të avancuara të enkriptimit dhe dekriptimit të kanaleve komunikuese, për të ngritur nivelin e sigurisë së komunikimeve”, “Valutat kriptografike dhe funksionimi i tyre për nga perspektiva teknike”, “Realiteti virtual (Virtual Reality) kundër Realitetit të miksuar (Augmented Reality)” dhe “Impakti i teknologjisë në ambientin tonë - rasti i Tesles”.

Të gjitha këto punime kanë një vlerë akoma më të veçantë për faktin se do të bëhen pjesë e “UBT Knowledge Center”, qendër kjo e inicuar nga bashkëpunimi mes UBT dhe “Pacific University”, në Amerike dhe “University of Linneaus”, në Suedi.

## Studentët e UBT-së krijojnë aplikacionin “DreamCurtains”

Ish-studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë, në UBT, Adonis Arifi dhe Bardhyl Bytyqi, kanë krijuar aplikacion unik të quajtur “Dream Curtains”, i cili tashmë është lançuar në platformën Play Store, dhe i njëjti po u ndihmon përdoruesve, përmes ofrimit të katalogëve për dizajnim të produkteve shtëpiake. DreamCurtains është i pari i këtij lloji në Kosovë dhe më gjerë, teksa sipas ideatorit të këtij aplikacioni, Valbon Jorgangji, projekti ka depërtuar edhe në tregun e Turqisë

dhe po synon edhe tregun botëror.

Sipas tij, si rezultat i punës të palodhshme të ish-studentëve të UBT-së, aplikacioni ka arritur të shkarkohet, pëlqehet e shfrytëzohet nga mijëra përdorues.

Falë suksesit të treguar nga ish-studentët e SHKI-së, ky aplikacion pritet ta zgjerojë ndikimin përmes bashkëpunimit dhe punësimit edhe të studentëve të tjerë nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe të Fakultetit Dizajn i Integruar.



## Studentët e UBT-së krijojnë qendër inovative për edukim e zhvillim

Dy studentët e UBT-së, Edmond Laja dhe Krenar Spahija, në bashkëpunim me disa të rinj të tjerë, Edon Zeqiri, Flamur Krasniqi, Arian Krasniqi dhe Donart Sheqerolli, kanë krijuar Qendrën për Edukim dhe Zhvillim, “cedX”, në qytetin e Pejës, që ka dalë nga punësoria StartUP, e cila është mbajtur në UBT disa muaj më parë, nën organizimin e qendrës Colibri të UBT-së dhe UNICEF.

Studenti Edmond Laja tregoi se ideja për hapjen e një qendre të tillë ka ardhur nga mungesa e hapësirave të punës për novatorët e rinj të qytetit të Pejës.

“Kjo qendër është e vetmja e këtij lloji në qytetin tonë dhe në të ne si rini mund ta shfrytëzojmë për zhvillimin

e projekteve dhe trajnimeve të ndryshme në fushën e teknologjisë”, u shpreh ai.

Sipas tij, ndonëse kanë pritur rezultate pozitive, megjithatë suksesi i kësaj qendre i ka kaluar të gjitha pritshmëritë e tyre.

Interesimi për qendrën tonë është shumë i madh dhe grupet e para veçse kanë kaluar, e të gjitha këto i kanë kaluar të gjitha pritshmëritë tona për nivelin e suksesit të arritur”, vlerësoi Laja.

Shërbimet që ofrohen nga kjo qendër janë trajnimet co-working space, të profilizuara në fushat e programimit, robotikës, elektronikës dhe dizajnit.

## Studentët e UBT-së, më të kërkuarit në tregun e punës

Studenti i UBT-së në Fakultetin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, në nivelin master, Agron Krasniqi, është duke punuar si menaxher i Shitjes në kompaninë Medical Group. Megjithëse, kjo nuk është përvoja e tij e parë, pasi përgjatë viteve sa ka qenë student i UBT-së edhe në nivelin bachelor, ai ka punuar edhe nëpër shumë kompani të njohura vendore.

Krasniqi, deri para pak ditësh ka qenë pjesë e kompanisë Meridian (Buka Bakery), ku ka punuar po ashtu si menaxher i Shitjes, ndërsa para kësaj përvoje, ka punuar në kompaninë Noble, në cilësinë e menaxherit të Marketingut, si dhe ka qenë menaxher për Marrëdhënie me Klientë në kompaninë Meridian Express dhe në atë Ogilvy-Karrotta.

Tërë këto suksese, studenti Krasniqi thotë se i ka arritur me angazhim e përkushtim dhe me ndihmën e UBT-së.

“Për mua, UBT ka qenë urë lidhëse me tregun e punës, ku falë këtij institucioni, unë kam filluar punën, duke u njohur fillimisht si student i UBT-së”, u shpreh ai, teksa shtoi se planifikon që rrugëtimin profesional të mos e ndalojë kurrë.

## Rrëfime sukcesi

## Studentët e UBT-së, pjesë e garës ndërkombëtare të arbitrazhit

Studentët e Fakultetit Juridik, Melodika Abrashi, Leorentë Alija, Labinot Avdiu, Qëndresa Beka, Urtinë Maloku, Gertë Berisha, Pylljon Nura dhe Ylberina Bajraktari, po marrin pjesë në garën ndërkombëtare të arbitrazhit "VIS Pre-Moot", që po mbahet për herë të katërt në Ballkanin Perëndimor, konkretisht në Kosovë. Gara që do të zhvillohet përgjatë dy ditëve është aktivitet përgatitor për Garën Botërore të Arbitrazhit që do të mbahet në

mars të këtij viti në Vjenë të Austrisë, derisa emrat e ekipeve fituese që do të dalin nga gara që po zhvillohet aktualisht, do të shpallen më 24 shkurt.

Studentët e UBT-së po e shohin si mundësi të mirë organizimin e këtij aktiviteti, sepse sipas tyre, po shërben në ngritjen e kapaciteteve të juristëve të rinj, në veçanti në fushën e zgjidhjes së kontesteve për biznes.

Për vite me radhë, në këtë garë botërore

kanë marrë pjesë shumë gjyqtarë nga SHBA-të, BE-ja dhe vendet e rajonit, të cilët i trajnojnë studentët e universiteteve nga Kosova, Gjermania, Shqipëria, Turqia, Bullgaria, Maqedonia dhe Bosnja e Hercegovina.

Vis Pre-Moot është program për Përmbarim dhe Legjislacion Komercial dhe gara e zhvilluar në kuadër të tij shërben si platformë ku pjesëmarrësit zhvillojnë të menduarit logjik dhe ligjor.



## Studentët e UBT-së, pjesë e programit "BPB Junior"

Rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi ka marrë pjesë në prezantimin e programit "BPB Junior", ideuar dhe hartuar nga Banka për Biznes, në Kosovë, e që për qëllim ka përgatitjen e bankierëve të së ardhmes.



Në kuadër të këtij programi, falë cilësisë së institucionit dhe produktivitetit të shfaqur nga studentët e UBT-së, pesë prej tyre janë përzgjedhur që të bëhen pjesë e trajnimeve dhe punës praktike që zhvillohen në këtë bankë.

Me këtë rast, rektori Hajrizi ka thënë se programi "BPB Junior", është program inovativ dhe i pari i këtij lloji në Kosovë, ku sipas tij, ofron njohuri praktike dhe eksperiencë studentëve përmes trajnimeve dhe programeve të praktikës.

Tutje, ai tregoi se UBT ka marrëveshje të bashkëpunimit me biznese të shumta, si rezultat i të cilave studentët përkrahen që

të qasen lehtësisht në tregun e punës, në mënyrë që ata të zhvillojnë karrierën në profesionet e tyre.

Ndërsa, studentët e UBT-së, Edi Bushati dhe Blerita Troshupa, të cilët janë pjesë e këtij trajnimi thanë se programi parashih mundësi të shumta, veç tjerash edhe marrjen e njohurive të reja.

Arton Celina, Kryeshef Ekzekutiv në BPB, ka thënë se banka ka iniciuar këtë program me qëllim të përkrahjes së studentëve nga fusha e ekonomisë, menaxhmentit dhe fushave tjera të studimit, që synojnë të fillojnë karrierën e tyre në një bankë me zhvillim dinamik.

Sipas tij, programi ka për qëllim ngritjen e nivelit të kuadrove përmes punës praktike, duke përgatitur të rinjtë për tregun e punës dhe duke ofruar mundësinë për punësimi.

Programi BPB Juniors, do të zgjasë tre muaj ku përmes stafit të bankës, të cilët janë të specializuar në fusha të ndryshme të sistemit bankar, si dhe me angazhimin e profesorëve nga universitete, do të ofrojë trajnime profesionale në fushën e sistemit bankar, si dhe trajnime në fushën e aftësive analitike.

## Studentët e UBT-së, pjesë e Universitetit "Staffordshire", në Angli

Studentët e nivelit master të Fakultetit Shkencë Kompjuterike dhe Inxhinieri, në UBT, Ruhada Emini dhe Trina Ismajli janë bërë pjesë e Universitetit "Staffordshire" në Angli, të cilat do t'i ndjekin studimet për një semestër të vitit akademik.

Kjo mundësi ju është ofruar falë marrëveshjeve të bashkëpunimit që UBT ka me mbi 250 universitete të ndryshme të Evropës dhe botës.

Studentja Ruhada Emini duke treguar për mundësinë e ofruar, tregoi se është një përvojë e re në studime dhe mundësi për një karrierë të suksesshme. Tutje, ajo është shprehur se UBT është institucion i realizimit të shumë ëndrrave.

"Këtë bursë e kemi arritur si rezultat i notës mesatare më të lartë që kemi pasur dhe njohurive të arritura në UBT. Aktualisht jemi në Angli dhe kemi filluar javët

e para të studimeve ku jemi kyçur mjaft mirë me programin, teksa njohuritë tona në "Staffordshire University" cilësohen të nivelit të lartë"

Qindra studentët të UBT-së aktualisht janë duke vazhduar studimet nëpër universitetet të fakulteteve të ndryshme. Ata studiojnë në institucionet më prestigjioze në Evropë dhe shumë vende të tjera të botës



## Studentët e UBT-së, pjesëmarrës në punëtorinë "Kujdesi Paliativ Holistik"

Studentët e Fakultetit të Infermierisë në UBT, kanë marrë pjesë në punëtorinë e quajtur: "Kujdesi Paliativ Holistik", e para e këtij lloji në rajon dhe është organizuar nga Universiteti "Aleksandër Moisiu" në partneritet me UBT-në.

Studentët patën mundësinë të dëgjojnë ligjëratë nga shumë ekspertë që në fokus kishin mënyrat e trajtimit të per-

sonave që vuajnë nga sëmundje që janë kërcënuese për jetën, përfshirë kancerin, çrregullimet progresuese polmonare, neurologjike, HIV/AIDS etj.

Po ashtu, studentët në këtë punëtori patën rastin të takohen dhe të dëgjojnë përvojat profesionale nga folësit ndërkombëtar, Judith Schafer nga Hungaria, Nicoleta Mitrea nga Rumania, Giovanni Bove dhe

Emiliano Giampà nga Italia etj.

Ata u treguan studentëve se kujdesi paliativ ka një rëndësi të veçantë për pacientin dhe se infermierët luajnë rol të rëndësishëm gjatë përbaljes dhe pranimit të gjendjes së tyre reale, ku ndihmon për të bërë të mundur komunikimin ndërmjet pacientit, familjes, mjekëve dhe personelit tjetër mjekësor.

## Studenti Emin Emini pranohet në Universitetin "Stanford", të Kalifornisë

Studenti i vitit të dytë në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë, në UBT, Emin Emini, është pranuar në Universitetin "Stanford", të Kalifornisë, për të vazhduar specializimin në Dizajnim dhe Analizë të Algoritmeve.

Studenti Emini tha se krahas punës së vet intensive dhe studimeve në UBT, ka arritur të përfitojë shumë profesionalisht, andaj falë kësaj, sipas tij, tash edhe ka arritur të fitojë bursë të plotë studimi për vazhdim të studimeve në këtë universitet.

"Studimi atje është një mundësi shumë e mirë sepse universiteti në të cilin jam

pranuar është një ndër më të vlerësuarit në botë dhe konsiderohet të jetë lider ndërkombëtar në fushën e shkencave kompjuterike", tregoi Emini.

Studenti i UBT-së, Emin Emini, ditë më parë krijoi një aplikacion unik për motin, të quajtur Cloudy, i cili po u ndihmon përdoruesve të shohin të dhëna të sakta për motin në çdo kohë dhe vend. Ky aplikacion nuk është i vetmi që studentin Emini e ka lansuar, pasi që, ai më herët ka qenë pjesë e shumë projekteve dhe ka realizuar edhe aplikacione të tjera nga fusha të ndryshme, përfshirë edukimin, argëtimin, fenë etj.





## Vizita studimore të studentëve

# Studentët e Arkitekturës vizitojnë Komunën e Ferizajt dhe kompani ndërtimore në këtë qytet

Studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, dega në Ferizaj, vizituan Komunën e Ferizajt si dhe kompaninë “SN-N”.



Studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, dega në Ferizaj, kanë organizuar vizitë studimore në kompaninë “SN-N”, në shoqërimin e prof. dr Visar Krelani.

Në këtë kompani, ata panë nga afër detaje të rëndësishme në lidhje me aspektet praktike që kanë të bëjnë me armimin, betonimin, realizimin e detajeve, si dhe organizimin e ndërtimit.

Në po të njëjtën ditë, studentët vizituan edhe Komunën e

Ferizajt, ku u pritën nga drejtori i Urbanizmit i kësaj komune, Lulzim Aliu.

Ai, së bashku me stafin e tij, shpjeguan për studentët aspektet më të reja të Planit Zhvillimor Komunal dhe investimet që do të bëhen në infrastrukturën e qytetit, me ç’rast edhe i stimuluan dhe inkurajuan studentët që të jenë pjesëmarrës në debate dhe të bëjnë propozime profesionale, si dhe të jenë pjesëmarrës në konkurset e ndryshme për zgjidhjet urbanistike në komunë.

## Studentët e Dizajnit të Integruar vizituan fabrikën “BINI”

Studentët e vitit të dytë në Fakultetin e Dizajnit të Integruar, në UBT, kanë realizuar vizitë studimore në fabrikën e prodhimit në fushën e mobilierisë, “BINI”.

Vizita e studentëve të Fakultetit Dizajn i Integruar, është realizuar me qëllim që të shihet nga afër procesi teknologjik i prodhimit në aspektin praktik.

Studentët u pritën nga menaxheri i fabrikës, Besnik Ibrahim, i cili i njoftoi me procedurat e prodhimit dhe mënyrën e dizajnit të mobileve, për të ardhur deri tek një prodhim i pëlqyeshëm për tregun dhe klientët.

Krahas kësaj, studentët patën mundësi të shohin nga afër edhe procesin e përpunimit të drurit, prodhimin e dyerve, dritareve dhe produkteve të tjera në fushën e mobilierisë.

Vizita u zhvillua nën shoqërimin e ligjëruesit në UBT, Fatmir Azemi, në kuadër të lëndës “Teknologjia e prodhimit”.



## Studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Ndërtimore vizituan lokacionet e rrëshqitjes së dheut në autostradën “Ibrahim Rugova”



Studentët e Fakultetit Inxhinieri Ndërtimore dhe Infrastruktura, realizuan vizitë studimore në autostradën “Ibrahim Rugova”, përkatësisht në segmentin Gjuricë - Suharekë, me qëllim të vlerësimit të gjendjes së rrëshqitjeve dhe shkopitjeve të masave të dheut dhe shkëmbinjve, dhe pastaj, ofrimin e ideve dhe propozimeve për përmirësimin dhe minimizimin e këtyre dukurive.

Ndër tjerash, vizita kishte për qëllim që studentet të njihen edhe me veprat inxhinierike që realizohen, duke i marrë në

konsideratë metodat dhe teknikat që rrjedhin nga këto disiplina shkencore dhe gjithashtu, të njihen me formacionet litologjike që e ndërtojnë këtë segment të autostradës.

Aktiviteti u realizua në bazë të planprogramit të punës që zhvillohet në lëndët: “Punime Tokësore”, “Gjeomekanikë” dhe “Gjeoteknikë”.

Studentët gjatë realizimit të kësaj vizite ishin të shoqëruar nga prof. dr Hysen Ahmeti dhe prof. dr Hazir Çadraku

## Studentët e Inxhinierisë Efiçente vizituan IHMK-në

Studentët e vitit të tretë në Fakultetin e Inxhinierisë Efiçente, vizituan Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK), nën mbikëqyrjen e ligjëruesve, Vehbi Sofiu, Besa Veseli dhe Shkumbin Shala.

Studentët u pritën nga drejtoresha e institutit, Letafete Latifi dhe nga stafi përgjegjës i laboratorëve.

Gjatë vizitës, studentët shkëmbyen nga afër përvojat teorike dhe përvojën hulumtuese të rrjedhjes së rrezatimit diellor, panë procesin e matjes së shpejtësisë së erës dhe temperaturat e energjisë gjeotermale.


Përveç kësaj, ata vizituan edhe stacionet automatike që bëjnë mbledhjen e informatave në mënyrë elektronike për të gjithë parametrat monitorues të ambientit.

UBT organizon vizita studimore për të gjitha drejtimet, me qëllim që studentëve t’ju ofrojnë qasje krahasimi dhe studimi të pjesës teorike të studimeve dhe atyre praktike të tregut të punës.



## Studentët e Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës vizituan impiantet në Shkabaj dhe Mramor

Studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës në UBT, kanë vizituar Impiantin e Trajtitit të Ujit të Pijes në Shkabaj dhe atë në Mramor, ku u shoqëruan nga ligjëruesit, Ilir Abdullahu, Sokol Xhafa dhe Hazir Çadraku dhe nga përfaqësuesit e KRU “Prishtina”.



Vizita ka nisur në Impiantin në Shkabaj, me ç’rast nga përgjegjësit janë prezantuar normat dhe teknologjia e ndërtimit për objekte të tilla, si dhe është prezantuar teknologjia e instaluar në fushën e trajtimit të ujit të pijes, si teknologji e avancuar e kohës së sotme.

Tutje, studentët panë nga afër edhe procesin e ajrimit, flokulimit, filtrimit dhe dezinfektimit të ujit, teksa u prezantuan edhe sistemet e pompimit, e mbi të gjitha, operimi dhe monitorimi përmes sistemit SCADA, si sistem monitorimi nga qendra apo nga distanca.

Në vizitat nëpër secilin objekt në kuadër të ITUP-së në Shkabaj, u prezantuan edhe materialet dhe reagensit që apliko-

hen gjatë trajtimit të ujit, qoftë koagulantët që përdoren, po ashtu edhe dezinfektuesit e ujit për pije.

Vizita tutje ka vazhduar në ITUN-në në Mramor, ku studentët kishin mundësi të shihnin parimin e punës së impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura me sistem biologjik, duke përfshirë të gjitha fazat e trajtimit, deri në shkarkim final, si dhe panë edhe sistemet e operimit kontrollit dhe mirëmbajtjes së objekteve të tilla.

Në të njëjtin objekt u panë edhe veprat hidroteknike dhe teknologjike në çdo hap trajtimi të ujit të ndotur, i cili ujë pastaj shkarkohet në Liqenin e Badovcit, prej ku uji merret, trajtohet dhe arrin të bëhet ujë i pijes.

## Studentët e Fakultetit Media dhe Komunikim vizituan Radio Kosovën

Studentët e vitit të dytë në Fakultetin Media dhe Komunikim, kanë realizuar vizitë studimore në mediumin publik, Radio Kosova, të shoqëruar nga asistentja Anisa Rada.

Studentët u pritën nga redaktori i lajmeve në Radio Kosova, Fadil Gashi, i cili fillimisht i njoftoi studentët me ambientet e punës dhe ndarjen e detyrave ditore nëpër të gjitha redaksitë dhe pastaj edhe për mënyrën e zhvillimit të lajmeve deri tek transmetimi i tyre.

Gjatë kësaj vizite, studentët patën rastin të takohen edhe me

disa nga redaktorët e tjerë, të cilëve ju parashtruan pyetje në lidhje me sfidat e të punuarit në radio.

Duke e parë funksionimin në këtë radio, studentët u shprehën se ndjehen edhe më të motivuar për të vazhduar rrugëtimin në profesion, të cilin, shumë prej studentëve të këtij institucioni, e kanë nisur shumë kohë më parë.



## Studentët e Inxhinierisë Ndërtimore vizituan Drejtorinë e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës

Studentët e vitit të tretë në Fakultetin e Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës, në UBT, kanë realizuar vizitë studimore në Komunën e Prishtinës, respektivisht në Drejtorinë e Urbanizmit, si rrjedhojë e nevojës për t'i parë gjërat në aspektin praktik dhe për t'i ndërlidhur me teorinë e fituar gjatë studimeve në UBT.

Vizita është zhvilluar nën shoqërimin e ligjëruesit në UBT, PhD Cand. Driton Kryeziu, në kuadër të lëndës "Rregullativa e Ndërtimit dhe Standardet", teksa atje janë pritur nga zyrtari i lartë në Drejtorinë e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, Zejnulla Rexhepi.

Ai para studentëve paraqiti një tablo mbi mënyrën e organizimit dhe hierarkinë institucionale në këtë drejtori, si dhe prezantoi në mënyrë të detajuar hapat që duhet ndjekur, që nga kontakti i parë i palës nga ana e investi-

torit dhe punonjësve të Drejtorisë së Urbanizmit, e deri tek përfundimi i procesit, p.sh marrja e një lejeje ndërtimore.

Në kuadër të kësaj vizite janë trajtuar edhe tema të tjera që kanë të bëjnë me parashtrimin e kërkesës për marrjen e kushteve ndërtimore, lejes ndërtimore, lejes për rrënim, kushteve për plotësim-ndryshim të projektit ndërtimor, aprovimi dhe afatet ligjore të lejes ndërtimore, si dhe tematika të tjera me rendësi.

Kjo vizitë është realizuar falë marrëdhënieve të mira ndërinstucionale ndërmjet UBT-së, si institucioni i vetëm privat i arsimit të lartë në Kosovë që e ka të akredituar programin Inxhinieri Ndërtimore dhe Infrastrukturë, dhe Komunës së Prishtinës, konkretisht Drejtorisë së Urbanizmit



## Studentët e Inxhinierisë së Energjisë Efiçiente vizituan fabrikën e prodhimit të paneleve solare "Jaha Solar"



Studentët e vitit të dytë në Fakultetin e Inxhinierisë së Energjisë Efiçiente, në UBT, kanë realizuar vizitë studimore në fabrikën e prodhimit të paneleve solare, "Jaha Solar", si rrjedhojë e nevojës për të parë procesin teknologjik të prodhimit në aspektin praktik dhe për t'i ndërlidhur me teorinë e fituar gjatë studimeve në UBT.

Vizita e studentëve është zhvilluar nën shoqërimin e ligjëruesve në UBT, Vehbi Sofiu, Afrim Osmani dhe Sami Gashi, të cilët janë pritur nga drejtori i fabrikës, Luan Hoxha dhe inxhinierja e elektroteknikës, Saranda Bytyqi.

Në kuadër të kësaj vizite studentët kanë parë nga afër edhe prodhimin e paneleve fotovoltaike, teksa në pyetjet e parashtruara në lidhje me kapacitetin prodhues të kompanisë dhe gatishmërinë për të mbuluar kërkesat edhe tregun ndërkombëtar, u tha se stafi që ka kompania është profesional dhe i përgatitur mirë, prandaj edhe është në gjendje të plotë të përmbushë kërkesat e tregut vendor dhe atij ndërkombëtar. Studentët e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës vizituan Aeroportin Ndërkombëtar të Kosovës, "Adem Jashari"

Studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës, të nivelit bachelor e master, kanë realizuar vizitë studimore në Aeroportin Ndërkombëtar të Kosovës, "Adem Jashari".

Ata janë pritur nga stafi udhëheqës dhe teknik, të cilët ju ofruan studentëve informata të frytshme rreth funksionimit, procesit teknologjik, kapaciteteve të prodhimit, si dhe pjesës ndërtimore dhe infrastrukturës së aeroportit.

Studentët, po ashtu, patën mundësinë të shohin nga afër edhe ambientet e punës, me ç'rast konkretisht vizituan departamentin e TIK-ut, platformën, shiritat e bagazhit përdhese, aparatet e skenimit për rreze X, dhomat e montimit, doganën, dhomën teknike elektrike me UPS, sistemin e ujit, dhomën e automatikës, ndërtesën MEP, fabrikën për trajtimin e ujërave të zeza etj.

Në fund të vizitës, inxhinierët e rinj bënë edhe pyetje, teksa thanë se kanë përfituar njohuri të reja, që do t'i shfrytëzojnë edhe për punë praktike në të ardhmen, në profesionin të cilin e kanë zgjedhur.

## Studentët e Juridikut simulojnë seancë për arbitrazhin

Studentët e Fakultetit Juridik, në UBT, kanë mbajtur një seancë simuluese për arbitrazhin, të organizuar në përfundim të lëndës "Arbitrazhi dhe Zgjidhja Alternative e Mosmarrëveshjeve", me profesorin e lëndës, PhD. Cand Artan Murati, në prani edhe të ligjëruesve dhe studentëve të Juridikut.

Gjatë këtij aktiviteti, ata kanë shfaqur njohuritë e tyre duke treguar aftësi të larta të parashtrimit të argumenteve mbi një rast hipotetik, duke u bazuar në kuadrin ligjor të

kësaj lëmie.

Gjatë kësaj seance hipotetike, studentët demonstruan aftësi analitike, të nevojshme edhe në zhvillimin e tyre profesional.

Zhvillimi i këtyre aktiviteteve ndihmon në aftësimin praktik të studentëve, në përputhje me standardet bashkëkohore dhe pritshmëritë e të mësuarit në fushën juridike.



## Studentët e Shkencave të Ushqimit vizitojnë fabrikën "Premium Bakery"



Studentët e vitit të parë në Fakultetin e Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë, në UBT, kanë realizuar vizitë studimore në fabrikën vendore të prodhimit të miellrave dhe produkteve të pjekjes "Premium Bakery", në Lipjan.

Ata janë pritur nga stafi udhëheqës dhe teknik të fabrikës, të cilët u treguan studentëve për grumbullimin dhe ruajtjen e grurit si lëndë e parë për prodhimin e miellit, procesin teknologjik dhe kapacitetet e prodhimit, si dhe kanë parë nga afër prodhimin e llojeve të ndryshme të bukëve, sim-

iteve, biskotave etj.

Studentët të shoqëruar nga profesorët e UBT-së, Gafur Xhabiri dhe Namik Durmishi, kanë vizituar edhe laboratorët modern të fabrikës ku bëhen analizat e cilësisë fizike e kimike të miellrave dhe reologjike të brumërave.

Ndërkohë, përfaqësuesit e fabrikës "Premium Bakery", kanë thënë se nuk do të mungojë bashkëpunimi në të ardhmen me stafin dhe studentët e UBT-së.

## Studentët e Shkencave të Ushqimit vizitojnë fabrikën e birrës "Prishtina"

Studentët e vitit të dytë në Fakultetin e Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT, kanë realizuar vizitë studimore në fabrikën e prodhimit të birrës "Prishtina".

Ata janë pritur nga stafi menaxherial dhe teknik i fabrikës, të cilët u treguan studentëve për ecurinë e parapërgatitjes së linjave prodhuese dhe mbarëvajtjes së procesit të prodhimit në përgjithësi.

Gjatë kësaj vizite studentët janë njoftuar me menaxhimin

e cilësisë, si dhe janë njohur nga afër edhe me standardet e cilësisë dhe sigurisë, higjienës së produktit dhe sistemet e ftohjes.

Ndërkohë, përfaqësuesit e fabrikës së birrës "Prishtina", kanë theksuar se nuk do të mungojë bashkëpunimi në të ardhmen me stafin dhe studentët e UBT-së.



## Studentët e UBT-së certifikohen për kriminalistikë aplikative me forenzikë



Studentët e Fakultetit Juridik, Shkenca Kompjuterike dhe Sistemet e Informacionit në UBT, kanë marrë pjesë në kursin specializues “Kriminalistika Aplikative me Forenzikë”, të mbajtur nga kryeshefi i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, njëherësh ligjërues në UBT, Blerim Olluri.

Në këtë kurs studentët kanë mësuar lidhur me metodat apo procedurat shkencore dhe praktike që aplikohen për ndriçimin e veprave penale.

Për vijim të suksesshëm të këtij kursi, studentëve u janë ndarë edhe certifikata nga kryeshefi i AKF-së, Blerim Olluri.

Kursi është organizuar falë marrëveshjes së bashkëpunimit që UBT ka me Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, i cili ofron shërbime forenzike në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet vendore dhe ndërkombëtare.

## Studentët njihen me punën e Institutit të Onkologjisë

Studentët e Fakultetit të Mekanikës dhe ata të Fakultetit të Stomatologjisë, në UBT, kanë realizuar vizitë studimore në Institutin e Onkologjisë, konkretisht në Departamentin e Radioterapisë, ku u shoqëruan nga profesori në UBT, Gëzim Hodolli.

Studentët janë pritur nga fizikanët e repartit, dr. Labinot Kastrati e Fesal Selimi dhe nga shefja e Repartit të Brakiterapisë, dr. Sonja Blakaj, të cilët i njoftuan studentët për rëndësinë e servisimit të pajisjeve në radioterapi.

Në kuadër të kësaj vizite, studentët patën rastin të shohin edhe pajisje të

avancuara mjekësore, përfshirë përshpejtuesi linear “LINAC”, CT Simulatorin, softuerët për konturim dhe planifikim, etj. Tutje, ata gjithashtu eksperimentuan me tufa fotonesh dhe elektronesh, përmes të cilave matën përqindjen e dozës në thellësi, përmasat e fushës, gjysmëhijën e fushës dhe fushat e parregullta.

Fokusi i studentëve ishte edhe tek sistemi dozimetrik, i cili është automatizuar dhe është shembull tipik i aplikimit të mekatronikës mjekësore.

Vizita tjetër në këtë institut do të bëhet me studentët e Fakultetit të Farmacisë.



## Studentët realizuan vizitë në objektet e SHSKUK-së dhe në Stadiumin e Prishtinës



Studentët e Fakultetit i Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës, në UBT, kanë realizuar vizitë studimore në objektet e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK), të shoqëruar nga profesorët, dr.sc Nexhmi Krasniqi dhe dr.sc Anjeza Alaj.

Gjatë vizitës në këtë institucion, studentët janë njoftuar për aktivitetet në mirëmbajtjen dhe rikonstruktimin e objekteve ekzistuese ndërtimore, me mënyrën e realizimit të punimeve dhe me llojet e materialeve që janë përdorur në varësi të destinimit të objekteve, me ç'rast studentët shfaqën interes të veçantë për objektin e Psikiatrisë, ku si

e veçantë e materialeve është përmendur lloji i materialit të dritareve, për shkak të sigurisë së shfrytëzuesve.

Pas kësaj vizite, studentët e vizituan Stadiumin e Qytetit të Prishtinës, ku u njoftuan me llojet e materialeve për mirëmbajtje dhe rikonstruktim të objektit me theks të veçantë në rikonstruktimin e elementeve të konstrukcionit mbajtës.

Në fund, studentët patën rastin të bënin edhe pyetje, teksa thanë se kanë përfituar njohuri të reja, që do t'i shfrytëzojnë edhe për punë praktike në të ardhmen.

## Studentët e UBT-së vizituan Fabrikën e Ujit, në Vushtrri

Studentët e vitit të dytë në Fakultetin Inxhinieri e Energjisë, kanë realizuar vizitë në Fabrikën e Ujit, në Vushtrri, nën shoqërimin e ligjëruesve, Vehbi Sofiu, Afrim Osmani dhe Sami Gashi.

Studentët u pritën nga menaxhmenti i fabrikës, të cilët i njoftuan ata nga afër me teknologjinë e fundit që është instaluar në industri, me funksionimin e lidhjes së sensorëve me sistem softuerik, pastaj me monitorimin e gjithë

sistemit të punës me sistemin e skadave dhe me komplet funksionimin automatik të sistemit të pompimit me fuqi prej 200kw, teksa panë edhe sistemin e tabelës komanduese automatike me mbrojtje të stabilimenteve energjetike.

Departamenti synon që vizita të tilla të bëhen në vazhdimësi, me qëllim të përgatitjes së inxhinierëve të ardhshëm për treg të punës.



## Zyrtarët e Telekomit të Kosovës ligjërojnë për menaxhimin e shitjes



Zyrtarët në Departamentin e Shitjes në Telekomin e Kosovës, dikur studentë të UBT-së, në Fakultetin Menaxhmet, Biznes dhe Ekonomi, Granit Kadolli dhe Qëndrim Merovci, kanë ligjëruar për studentët e vitit të tretë të të njëjtit fakultet, me ç'rast kanë ndarë përvojat e tyre profesionale.

Ata folën për menaxhimin e shitjes, ku ndër tjerash shtuan se organizata mund të jetë më e suksesshme nëse ky proces menaxhohet në mënyrën e duhur.

Tutje, Kadolli e Merovci e veçuan këtë koncept edhe si

një sfidë me të cilën mund të përballet secili biznes, teksa treguan edhe mbi ekzistimin e disa metodave që mund të implementohen në aktivitetet e përditshme të kompanisë dhe që potencialisht mund të ndikojnë në rritjen e performancës së shitësve.

Gjatë ligjëratës, këta dy ish-studentë të UBT-së nuk harruan edhe të përmendnin përfitimin e marrë nga studimet në UBT, falë të cilave, sipas tyre, janë ngritur profesionalisht.

Flet Dr. Ferid Selimi

# Programi i Medias dhe Komunikimit në UBT, me specializimet më të veçanta në vend

**Shkalla e lartë e punësueshmërisë së studentëve, një numër edhe para diplomimit, është edhe një faktor tjetër që e përforcon konstatimin për punën profesionale që bëhet nga mësimdhënësit dhe studentët e Fakultetit të Gazetarisë dhe Komunikimit në UBT**

Në UBT funksionon shkolla më e madhe e gazetarisë dhe e komunikimit në nivelin bachelor dhe master, akredituar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.

Kurikula moderne, në hap me shkollat më të njohura të gazetarisë në botë, e përshtatur me zhvillimet e shpejta në këtë fushë, ndikuar nga zhvillimet teknologjike, i bëjnë studimet për gazetari dhe komunikim në UBT më të kërkuarat për profesionistët e rinj që nisin karrierën në këtë fushë.

Shkalla e lartë e punësueshmërisë së studentëve, një numër edhe para diplomimit, është edhe një faktor tjetër që e përforcon konstatimin për punën profesionale që bëhet nga mësimdhënësit dhe studentët e Fakultetit të Gazetarisë dhe Komunikimit në UBT.

Në një bisedë për Media Grupin e UBT, dekani i këtij fakulteti, Dr. Ferid Selimi flet për programin dhe veçantitë e njërit prej fakulteteve më të kërkuara në vend.

**Media Grupi: Çka e bën të veçantë Fakultetin për Media dhe Komunikim në UBT?**

**Dr.Selimi:** UBT ka të akredituar programin bachelor dhe atë master në Media dhe Komunikim. Këta programe studentëve u ofrojnë mundësinë të profesionalizohen në disa fusha të medias dhe komunikimit.

Në të vërtetë, studentët që regjistrohen a transferohen në programin bachelor në Fakultetin Media dhe Komunikim në UBT, nuk do të bëhen thjeshtë vetëm gazetarë, e të punojnë vetëm në media, por do të specializohen edhe për marrëdhënie me publikun, për zyrtarë për informim, për zëdhënës, për menaxhimin e medias dhe të informimit, si dhe të punojnë në institucione shtetërore, publike, dhe në kompani private të biznesit, ku ka të bëjë me median a komunikimin.

Përderisa Institucionet e tjera të arsimit të lartë përqendrohen vetëm në gazetari, UBT ka një program më të gjerë studimi në Media dhe Komunikim dhe përqendrohet në të dyja. Që nënkupton, studentët e UBT-së do të përgatiten për të punuar në media dhe në institucione ku jo vetëm aftësia e të shkruarit a e të informuarit por edhe aftësia e komunikimit është e domosdoshme.

Sa i përket programit master, duhet theksuar që UBT ofron dy specializime: Komunikimi politik dhe Korporatat si dhe Mediat Digjitale dhe Komunikim, e që Institucionet e tjera të Arsimit të Lartë nuk i kanë. Këto janë dy specializime të përzgjedhura, shumë të nevojshme dhe të kërkuara në shoqërinë tonë e në rajon, e që, studentët që përzgjedhin UBT-në do të jenë të parët të specializuar në këtë drejtim.

**Media Grupi: Cilat janë specifikat e Fakultetit Media dhe Komunikim?**

**Dr. Selimi:** Programi Bachelor Media dhe Komunikim në UBT, studentëve u ofron njohuri të hollësishme mbi rolin e komunikimit në nivelin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, në mënyrë që ata të zhvillojnë aftësitë e veta kreative dhe analitike për të zgjidhur problemet me të cilat ballafaqohen. Nëpërmjet leksioneve dhe ushtrimeve, studentët aftësohen që të mbledhin, të vlerësojnë dhe të shfrytëzojnë informacionet përmes mediave të ndryshme, dhe mësojnë metodat, llojet dhe tipat e komunikimit. Duke pasur gjithnjë parasysh, që gazetarinë nuk e bën funksionale dhe të besueshme vetëm shpejtësia e përhapjes së informacionit, përkatësisht rruga që bën ai informacion deri te marrësi, por saktësia e të vërtetës dhe vërtetësia e informacionit që arrin te marrësi, studentët e Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT marrin njohuri të duhura për të ndjekur këtë parim.

Ndërsa, sa i përket komunikimit, ata do të jenë të gatshëm për tregun e punës, si më të informuarit dhe më të zhdërvjellëtit në këtë drejtim. Prandaj, këtë program që ofron UBT,



**“Qëllimi i programit Komunikim dhe Media nënkupton pajisjen e studentëve me dije teorike dhe praktike për të kryer me sukses punët në organizatat ku do të punojnë, duke performuar të gjitha format e komunikimit si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhë të tjera evropiane e botërore”, thotë Dr.Ferid Selimi**

nuk e ofron ndonjë Institucion i Arsimit të Lartë në Kosovë e Rajon. Kjo vlen edhe për programin master. Ata që e kanë parë kurikulën e programit master dhe ata që e shohin, pasi ta analizojnë, do të binden që program më të mirë nuk ofron asnjë nga universitetet tjera.

**Media Grupi: Pse studentët, sipas jush, duhet të transferohen në UBT, saktësisht në fakultetin Media dhe Komunikim?**

**Dr. Selimi:** Programi bachelor në Media dhe Komunikim është dizajnuar në atë mënyrë që të ofrojë një kombinim të trefishtë të studimeve: aftësi praktike thelbësore, siç janë intervistat dhe të shkruarit për media të ndryshme; njohuritë për njerëzit, institucionet dhe parimet etike, që studentët duhet t'i zotërojnë si pjesë e kontekstit për gazetarinë.

Ky është një program stimulues dhe u siguron studentëve njohuri teorike dhe praktike për të qenë në gjendje të punojnë në fusha të ndryshme.

Ndërsa kur flasim për gazetarinë, ajo nënkupton paraqitjen saktësisht të ecurive të ngjarjeve nëpërmjet fakteve ekzistuese, reale, e objektive, dhe meqë komunikimi është bazë e një shoqërie të shëndoshë, e propaganda i zgjedh apo i sajton faktet për të arritur qëllimin real, studentët në UBT mësojnë sesi të ballafaqohen këto tre fenomene. Duke pasur parasysh që të tria këto kanë një qëllim: të informojnë publikun. Përkatësisht duke pasur për bazë që gazetaria informon nëpërmjet fakteve të qëndrueshme, pa bërë përzgjedhje a pa sajuar a shpikur, ndërsa,

propaganda informon publikun, por duke përzgjedhur faktet ose duke i sajuar ato, komunikimi është që i ndërlidh të dyja këto në një trekëndësh kënddrejtë. Sepse pa komunikim nuk do të mund të kemi as media e as ndonjë institucion publik a privat. Komunikimi është ai që u jep jetë institucioneve.

Ky është i vetmi institucion i Arsimit të Lartë që u ofron këto mundësi studentëve, në mënyrë që nesër të jenë të gatshëm dhe të barabartë, mbase edhe më të mirët në tregun e punës. Krejt kjo mund të përmbillet me gjykimin se, vetë qëllimi i programit Komunikim dhe Media nënkupton pajisjen e studentëve me dije teorike dhe praktike për të kryer me sukses punët në organizatat ku do të punojnë, duke performuar të gjitha format e komunikimit si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhë të tjera evropiane e botërore.

Pikërisht këto janë arsyt pse studentët do të duhej të përzgjedhnin programin bachelor në Fakultetin Media dhe Komunikim në UBT. Ndërsa sa i përket përzgjedhjes së programit master në UBT, e theksova edhe më lart. Arsyeja pse do të duhej përzgjedhur UBT-në për studime master në Media dhe Komunikim është pikërisht përzgjedhja e dy specializimeve që nuk i kanë të tjerët, e këto janë: Komunikimi politik dhe Korporatat dhe Mediat Digjitale dhe Komunikim Prandaj, studentëve s'ka si t'u ik kjo mundësit e përzgjedhjes së UBT-së, përkatësisht Fakultetin Media dhe Komunikim në programin master. Për t'u specializuar në këto drejtime dhe për t'u bërë më të mirët, sepse kanë përzgjedhur më të mirin universitet.

Dr. Muhamet Ahmeti

# Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Infrastrukturës në UBT, vend i përgatitjes së inxhinierëve të së ardhmes

“Suksesi më i madh i këtij fakulteti janë studentët aktualë dhe të diplomuarit, shumica dërrmuese e të cilëve janë duke punuar në kompani të njohura vendore e ndërkombëtare, kanë krijuar kompanitë e veta, duke punësuar kështu edhe shumë njerëz të tjerë, por edhe janë duke i vazhduar studimet nëpër universitetet më prestigjioze në botë, falë marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe bursave që ndanë UBT për studentët e vet”, theksoi ai



**“Specializimet në Materiale Ndërtimore, Gjeomekanikë, Teknologji Ndërtimore, Strukturë, Infrastrukturë dhe Hidroteknikë, si të vetmet në regjion, e kanë bërë FNI-në lider në këto specializime shumë të kërkuar nga ana e studentëve të viseve të ndryshme shqipfolëse”**

Inxhinieria e Ndërtimit dhe Infrastruktura është një ndër profesionet më kontribuuese në rritjen e shkallës së punësimit në Kosovë.

Sektori i ndërtimit dhe infrastrukturës përfshin rreth 20 për qind të aktivitetit ekonomik vjetor në Kosovë, dhe në vitet e fundit, ka qenë burimi kryesor i rritjes dhe gjenerimit të të ardhurave.

Me misionin për të krijuar profesionistë të kësaj fushe, të cilët do ta ofrojnë dijen e tyre në shërbim të qytetarëve dhe përmirësimit të jetës së tyre, UBT ka themeluar dhe akredituar prej vitit 2013 Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës (FNI), i cili është ndër më të mëdhenjtë dhe me të suksesshmit në Kosovë e rajon, vlerësim ky që bëhet lehtësisht, falë numrit të madh të studentëve që janë kyçur me sukses në tregun e punës, dhe për më tepër, po sjellin vazhdimisht inovacione dhe projekte të përealizuara më parë në Kosovë.

Dekani i këtij fakulteti, prof. dr. Muhamet Ahmeti, tha se edhe përkundër stafit profesional dhe kushteve optimale për studim, promovimi dhe ambasadorët më të mirë të këtij fakulteti janë studentët.

“Suksesi më i madh i këtij fakulteti janë studentët aktualë

dhe të diplomuarit, shumica dërrmuese e të cilëve janë duke punuar në kompani të njohura vendore e ndërkombëtare, kanë krijuar kompanitë e veta, duke punësuar kështu edhe shumë njerëz të tjerë, por edhe janë duke i vazhduar studimet nëpër universitetet më prestigjioze në botë, falë marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe bursave që ndanë UBT për studentët e vet”, theksoi ai

Sipas matjeve që kanë dalë nga fakulteti, rezultojnë se studentët janë mirëpritur nga tregu i punës dhe shkalla e punësimit është shumë e lartë.

“Në vitin e dytë të nivelit master, përqindja e punësimit të studentëve është 100 për qind, ndërsa në vitin e parë të studimeve master, kjo përqindje sillet rreth 97 për qind.

Sa i përket shkallës së punësimit të studentëve që momentalisht po i ndjekin studimet themelore, bazuar në vitin e studimit, shkalla më e ulët është 30 për qind për vitin e parë, ndërsa për studentët e vitit të tretë është 60 për qind”, tregoi Ahmeti.

Ndërkaq, sipas statistikave që kanë dalë nga UBT, krahas numrit të madh të të regjistruarve, tash e pesë vite, si në afatin e tetorit, ashtu edhe në atë të shkurtit, numri i përgjithshëm i të transferuarve për çdo vit e kalon shifrën prej 200

studentësh të transferuar në të dy nivelet.

Sipas dekanit Ahmeti, arsyeja e përzgjedhjes së Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit nga ana e studentëve të fakulteteve tjera vjen nga ndryshimi në kurrikulë dhe syllabuse, ndërlidhja e ligjërimit dhe praktikës, kuadri i specializuar në fushat përkatëse, numri shumë i madh i profesorëve të kyçur në ligjërime, që kanë përfunduar studimet në universitetet më të njohura evropiane, libraria më e madhe në Ballkan, më shumë se tetë librari elektronike me qasje të lirë për studentë, mundësia e kryerjes së praktikës profesionale në shumë kompani publike dhe private në fushën e inxhinierisë, vizitat e ndryshme studimore në Evropë dhe më gjerë, etj.

Në anën tjetër, marrëveshjet e shumta të këtij fakulteti me fakultetet homologe nga shtetet e tjera, e ofrojnë mundësinë e vazhimit të studimeve në një vend dhe institucion tjetër. Këtë mundësi tashmë e kanë shfrytëzuar shumë studentë të cilët i kanë vijuar studimet në nivelet më të larta, master apo doktoraturë, në shumë universitete evropiane, përfshirë Universitetin Politeknik të Milanos, Universitetin Teknik të Vjenës, si dhe shumë universitetet të tjera nga fusha e inxhinierisë ndërtimore.

Duke treguar mbi veçoritë e Fakultetit të Inxhinierisë Ndërtimore, Ahmeti tregoi se pikë e fuqishme e këtij janë specializimet më unike dhe të vetmet në regjion,

“Specializimet në Materiale Ndërtimore, Gjeomekanikë, Teknologji Ndërtimore, Strukturë, Infrastrukturë dhe Hidroteknikë, si të vetmet në regjion, e kanë bërë FNI-në lider në këto specializime shumë të kërkuar nga ana e studentëve të viseve të ndryshme shqipfolëse”, vlerësoi ai.

Ky fakultet cilësohet si djep i dijes dhe shkencës, vlera këto që e bëjnë vendin ideal për të studiuar dhe për t’u pajisur me njohuri shkencore që studentët i bëjnë profesionistë të padiskutuar të kësaj fushe.

## Fakulteti i Inxhinierisë dhe Infrastrukturës anëtarësohet në Asociacionin Evropian të Fakulteteve të Ndërtimit

Fakulteti i Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës i UBT-së, është bërë anëtar i Asociacionit Evropian të Fakulteteve të Ndërtimit (EUCEET).

Kjo është një e arritur e madhe për fakultetin, meqë mundëson që Kosova dhe UBT të jenë në rrjedha dhe pjesë e konferencave të mëdha ndërkombëtare, pjesë e shkollave dhe akademive verore e dimërore.

Përveç kësaj, stafit të fakultetit do i mundësohet që të kenë qasje në të gjitha informatat në lidhje me kurrikulat, konferencat dhe organizimet e tjera që bëhen nga fakultetet partnere.

Në anën tjetër, edhe kongreset dhe konferencat në fushën e ndërtimit, të cilat do të organizohen prej UBT-së, do të publikohen nga ky asociacion, ku edhe do të kenë qasje në këto informata të gjitha fakultetet e inxhinierisë dhe ndërtimit në nivel evropian dhe botëror.

Qëllimet kryesore të këtij asociacioni janë krijimi i kushteve për bashkëpunim të ngushtë midis fakulteteve të inxhinierisë ndërtimore nga universitete të vendeve të ndryshme, dhënia e kontributit në shpërndarjen dhe aplikimin e hulumtimit dhe mësimdhënies së fundit të inxhinierisë ndërtimore, veçanërisht në gjetjen e përmirësimeve në mjedis, pastaj mbështetja e zhvillimit evropian dhe përhapja e teknologjive të reja të ndërtimit, puna drejt përputhshmërisë në mesin e kurrikulave të fakulteteve të inxhinierisë së ndërtimit, si një pikënisje për shkëmbimin e studentëve dhe pranimin reciprok të të diplomuarve në praktikën e inxhinierisë ndërtimore në Evropë.

Ines Bula, menaxhere e Fakultetit Inxhinieri e Energjisë dhe Menaxhment në UBT

# Programi i Inxhinierisë së Energjisë në UBT, me specializimet më të veçanta në vend

Numri i studentëve të punësuar të cilët kanë vijuar studimet në Fakultetin Inxhinieria e Energjisë dhe Menaxhment, është shumë i lartë 80-98 për qind

Fakulteti i Inxhinierisë së Energjisë dhe Menaxhment në UBT, është program studimor që kontribuon në studimin e energjisë energjetike.

Programi ofrohet bazuar në programet dhe përvojat evropiane dhe amerikane, ku studentët, veç tjerash, mësojnë dhe praktikojnë mjetet ose format alternative të prodhimit të energjisë, e sidomos asaj të ripërtërishtme.

Ines Bula, menaxhere e Fakultetit Inxhinieri e Energjisë dhe Menaxhment në UBT, ka treguar se programi ofron specializimet më të veçanta në vend dhe më gjerë, përfshirë Bazën e Burimeve të Energjisë, Ruajtja e Energjisë, Energji Efiçiente.

**Media Grupi: Çka e bën të veçantë nga universitet tjera, fakultetin që ju e drejtoni?**

**Ines Bula:** Fakulteti Inxhinieria e Energjisë dhe Menaxhment në UBT, është i vetmi fakultet në rajon, i cili punon në drejtimin e tejkalimit të sfidave të mëdha me të cilat ballafaqohet sektori i energjisë në Kosovë dhe Rajone.

Zhvillimi planë programit të Inxhinierisë së Energjisë dhe Menaxhment, njëkohësisht përgatit gjenerata të reja të cilat do të kontribuojnë në tejkalimin e sfidave të sektorit të energjisë.

Sfidat kryesore me të cilat përballet sektori i energjisë në Kosovë janë: zhvillimi i infrastrukturës së Energjisë Efiçiente, lehtësimi i investimeve në kohë në furnizimin me energji, zhvillimi i skemave inovative të financimit për investime kapitale dhe aplikimin e çmimeve të energjisë që reflektojnë koston.

Strategjia për energji e Kosovës gjithashtu e njeh potencialin për zhvillimin e energjisë së rinovueshme që është pjesë e planprogramit i cili zhvillohet dhe implementohet në Fakultetin Inxhinieria e Energjisë dhe Menaxhment,

Qëllimi është krijimi i një ambienti miqësor për investime private në sektor, që fokusohet në hidrocentrale, energji të erës, energji gjeotermike, biomasë dhe gazë nga përpunimi i mbetjeve urbane dhe rurale ku që të gjitha këto tema në mënyre të deatjuar në aspekte akademike trajtohen te UBT. Rreth 3% të prodhimit të përgjithshëm të energjisë është përfituar nga burime të rinovueshme të energjisë. Megjithatë, potenciali për zhvillimin e burimeve të ripërtërishtme konsiderohet si i lartë, veçanërisht në prodhimin e energjisë elektrike dhe ngrohjes nga biogazi, biomasa dhe energjia diellore, prodhimin hidroenergjetik nga impiantet e vogla dhe prodhimin e energjisë nga era.

Niveli aktual i efikasitetit të energjisë në Kosovë është i ulët, dhe është krejtësisht realiste të synojë një rritje prej 20% në efiçencën e energjisë deri në vitin 2020.

Termocentrali "Kosova e Re" do të rezultojë me një rritje të efikasitetit energjetik në prodhim prej gati 5%, si rezultat i teknologjive moderne të përdorura në impiant, krahasuar me TC Kosova A dhe TC Kosova B, po ashtu, është edhe një prej vendeve të punës i cili hapet për studentët e Fakultetit Inxhinieri e Energjisë dhe Menaxhment.

Fakulteti Inxhinieria e Energjisë Efiçiente na rrethojnë nga të gjitha anët me aplikacione që arrijnë lart në çdo sektor të shoqërisë që shtrihen nga fabrikat, veturat, ndërtesat, etj. Prandaj studimi i Inxhinierisë së Energjisë Efiçiente është shumë emocionuese dhe interesante. Gjithashtu, trajnimi i gjeneratave të ardhshme të inxhinierëve dhe dhënia atyre një set gjithëpërfshirës të aftësive është shumë e rëndësishme për industrinë e inxhinierisë së Energjisë Efiçiente si tërësi ashtu edhe për shoqërinë.

Duke i marrë parasysh kërkesat aktuale dhe të pritura në sektorin e energjisë së rinovueshme do të ketë kërkesa të



Ines Bula, menaxhere e Fakultetit Inxhinieri e Energjisë dhe Menaxhment në UBT

konsiderueshme për inxhinierë të kualifikuar në këtë sektor. Në këtë kontekst, Programi i Inxhinierisë së Energjisë Efiçiente i UBT, ka për qëllim t'i përgjigjet nevojës për personel të kualifikuar. Studentët e diplomuar nga Programi i Inxhinierisë së Energjisë Efiçiente do të kualifikohen për të punuar në kuadër të prodhimit dhe shpërndarjes së elektricitetit dhe industritë e ndërlidhura shërbyese. Studentët do të kompletojnë programin e tyre edukativ në bashkëpunim me sektorin e energjisë. Si pjesë e programit, studentët duhet ta kenë kryer me sukses praktikën e tyre, gjithashtu në bashkëpunim me sektorin e energjetikës.

**Media Grupi: Cilat janë specifikat e fakultetit që ju drejtoni?**

**Ines Bula:** Programi bazohet në punën e bërë nga TEMPUS Projektit për Zhvillim të Plan programeve për Efiçencën e Energjisë, në të cilin UBT është pjesë e konsorciumit.

Programi i Inxhinierisë së Energjisë Efiçiente në UBT, ka për qëllim t'i përgjigjet nevojës për personel të kualifikuar. Studentët e diplomuar nga programi i Inxhinierisë së Energjisë Efiçiente do të kualifikohen për të punuar në kuadër të prodhimit dhe shpërndarjes së elektricitetit dhe industritë e ndërlidhura shërbyese.

Duke i marrë parasysh kërkesat aktuale dhe të pritura në sektorin e energjisë së rinovueshme do të ketë kërkesa të konsiderueshme për inxhinierë të kualifikuar në këtë sek-

tor. Në këtë kontekst, Programi i Inxhinierisë së Energjisë Efiçiente në UBT, ka për qëllim t'i përgjigjet nevojës për personel të kualifikuar. Studentët e diplomuar nga Programi i Inxhinierisë së Energjisë Efiçiente do të kualifikohen për të punuar në kuadër të prodhimit dhe shpërndarjes së elektricitetit dhe industritë e ndërlidhura shërbyese. Studentët do të kompletojnë programin e tyre edukativ në bashkëpunim me sektorin e energjisë. Si pjesë e programit, studentët duhet ta kenë kryer me sukses praktikën e tyre, gjithashtu në bashkëpunim me sektorin e energjetikës.

**Media Grupi: Sa është numri i i studentëve të punësuar, sa është numri i studentëve që kanë vazhduar studimet jashtë vendit?**

**Ines Bula:** Numri i studentëve të punësuar të cilët kanë vijuar studimet në Fakultetin Inxhinieria e Energjisë dhe Menaxhment, është shumë i lartë 80-98% (varësisht nga gjeneratat) duke ju falënderuar faktit që UBT posedon laboratorët të pajisura me teknologji të cilat janë trendi i fundit në botë dhe po ashtu UBT është i vetmi institucion i cili ka marrëveshje mirëkuptimi me KEK dhe KOSTT e cila ia mundëson studentëve të i përfundojnë pjesën praktike, dhe në këtë mënyre studentët janë në gjendje të ballafaqohen me sfida në vende të punës dhe në këtë mënyrë të e dëshmojnë veten me njohuri akademike dhe praktike të marra gjatë studimeve në UBT.

# Fakulteti i SHKI-së në UBT, vendi ku krijohen ekspertët e së ardhmes në këtë fushë



**Ky fakultet ofron specializimet më të sofistikuara nga fushat e Inxhinierisë së Sistemeve të Informacionit, Databazë e Sisteme Informative, Rrjetet dhe Telekomunikimi, Grafikë Kompjuterike e Multimedia, Ueb Programimi, Bioinformatikë dhe Siguria e Sigurimi i Informacionit në nivelin bachelor. Gjithashtu, ofron edhe specializime unike në nivelin master, duke përfshirë Inxhinierinë e Sistemeve Softuerike, Programim në Platforma të Uebit, Sistemet e Bazave të të Dhënave, Shkencat e të Dhënave Statistikore, Inxhinieri e Sistemeve të Komunikimit, Multimedia dhe Vizualizim dhe Informatikë Mjekësore.**

Studimet në Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, paraqesin një mundësi të pakrahasueshme studimi marrë për bazë institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare.

UBT është institucioni më inovativ në Kosovë dhe më gjerë, i cili ofron programin më të kompletuar në vend për fushën e Shkencave Kompjuterike në kuadër të Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri.

Ky fakultet ofron specializimet më të sofistikuara nga fushat e Inxhinierisë së Sistemeve të Informacionit, Databazë e Sisteme Informative, Rrjetet dhe Telekomunikimi, Grafikë Kompjuterike e Multimedia, Ueb Programimi, Bioinformatikë dhe Siguria e Sigurimi i Informacionit në nivelin bachelor. Gjithashtu, ofron edhe specializime unike në nivelin master, duke përfshirë Inxhinierinë e Sistemeve Softuerike, Programim në Platforma të Uebit, Sistemet e Bazave të të Dhënave, Shkencat e të Dhënave Statistikore, Inxhinieri e Sistemeve të Komunikimit, Multimedia dhe Vizualizim dhe Informatikë Mjekësore.

Një disiplinë më të kërkuara në vend dhe botë janë shkencat kompjuterike, të cilat, për nga dinamika e progresit apo aplikimit në jetën e përditshme, janë bërë të pazëvendësueshme në të gjitha fushat e jetës dhe punës në vazhdimësi. Studimet në Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri ofrojnë qasje më inovative në fushën e teknologjisë, kështu duke ndikuar që çdo herë të jenë në hap me trendet inovativë,

rëndësia e gjithë kësaj e bënë që studentet tanë të dëshmojnë veten në krahasim me të tjerët, të ndajnë vlerat e përbashkëta për arritjen e qëllimeve për ndryshime pozitive.

Këtë drejtim e bën akoma më atraktiv edhe stafi akademik me përvojë dhe njohuri të shkëlqyeshme nga fushat adekuate, si dhe infrastruktura më e re dhe më e sofistikuara, që mundëson realizim të mësimi proaktiv në platformën elektronike të UBT-së por edhe ambienti ekzistues për mësim i pajisur me mjete të nevojshme dhe me material adekuat për studim modern e profesional, e cila ndikon që studentët të shkëlqejnë në karrierën e tyre.

Ne i japim vlerë gjithë procesit të studimeve. Tek ne studentët tanë ndërtojnë bazat e bashkëpunimit në ekip duke studiuar dhe bashkëpunuar me kolegët e tyre. Prandaj, edhe dalin të përgatitur dhe njëkohësisht të suksesshëm në tregun e punës falë vlerave të përvetësuar në UBT.

Mësimdhënia ofrohet përmes ligjëratave interaktive, seminareve, mësimëve individuale, punës praktike etj., e cila i bën ata të jenë gjithmonë në dijeni për trendet më të reja në fushën e shkencës dhe teknologjisë, gjithashtu mësimdhënia në Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri ofrohet edhe përmes vizitave studimore në industri të ndryshme, të ndërlidhura me studimet në këtë program, elemente këto që ndikojnë që studentët tanë të përfitojnë eksperiencën, si dhe punësim gjatë dhe pas përfundimit të studimeve në institucione dhe kompani të mëdha vendore dhe ndërkombëtare.

Pos mundësive të mëdha për punësim, ky program ofron edhe mundësi për vazhdim të studimeve jashtë vendit, përmes bursave të shumta që ndahen për studentët, falë marrëveshjeve të bashkëpunimit të UBT-së me universitetet më prestigjioze në Evropë dhe SHBA, si dhe falë bashkëpunimit me programin Erasmus, që ka për qëllim të krijojë mundësi për karrierë të studentëve, të promovojë mirëkuptimin ndërkulturor përmes bashkëpunimit, si dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Me vlerën që bart UBT tek ata, ndikon që studentët tanë të bartin profesionalizmin e tyre gjatë punësimit tek bizneset më të mëdha kosovare dhe ato ndërkombëtare.

Studimet e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, kanë vlerë të shtuar sepse ato aktivizojnë potencialin ekzistues tek studentët dhe i shtyjnë ata të konkurrojnë jo vetëm në tregun vendor, por edhe në atë ndërkombëtar.

Gjithashtu, studentet tanë arrijnë suksese prestigjioze në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar.

UBT ka mijëra publikime shkencore të mbështetura nga institucionet më të besueshme kërkimore ndërkombëtare, e cila ndërton kuadrot e së ardhmes në shkenca kompjuterike. Vlen të theksohet se UBT është një institucion që vepron për shumë vite, është një tempull akademik, ku takohen gjeneratat e veteranëve dhe ekspertëve të ardhshëm të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë.

# Fakulteti Juridik i UBT-së, mundësi unike për arritje profesionale

Krahas drejtimeve që në fokus kanë teknologjinë, UBT njihet edhe për nxjerrjen e kuadrove tejet të përgatitura në shkencat sociale.

Një fakultet i tillë është ai Juridik, i cili falë stafit të përgatitur profesionalisht, po arrin të nxjerr në çdo vit studentë që me lehtësi po e gjejnë vetën në tregun e punës.

Dekanja e Fakultetit Juridik në UBT, prof. dr. Jorida Xhafaj flet në një intervistë për "UBT News":

UBT News: Cilat janë veçoritë e Fakultetit Juridik?

Xhafaj: Fakulteti Juridik në UBT funksionon si njësi akademike e cila përfshin fusha kërkimi homogjene në drejtimin juridik. Veprimtaria e tij në drejtim të administrimit të proceseve akademike dhe kërkimore bazohet mbi strategjinë institucionale, zhvillimet bashkëkohore në shkencat juridike dhe parimin e lirisë akademike e të formimit cilësor të gjeneratave të ardhshme.

Programi LLB në Juridik ka si objektiv themelor aftësimin e studentëve për të analizuar fakte juridike, koncepte, kuadrin ligjor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar apo politika, duke u përshtatur me mirë dhe më shpejtë me pozicionet bazë të tregut të punës.

Ky program është i ndërtuar për të krijuar dije dhe për të aftësuar studentët të mendojnë dhe interpretojnë në mënyrë analitike, për të forcuar besimin profesional të tyre dhe për t'i ndërgjegjësuar mbi mundësitë e kontributit në zhvillimin e vendit.

Elementet që spikasin në aktivitetin e Fakultetit Juridik dhe që e diferencojnë atë janë:

- Vëmendja e posaçme në dimensionin evropian dhe krahasues të studimit të ligjit;

- Ndërthurja e mësimdhënies teorike dhe atyre praktike në mënyrë të ekuilibruar, duke garantuar përshkallëzimin e dijeve ndër vite;

- Angazhimi i stafit mësimdhënës të larmishëm, duke përfshirë studiues me emër në vend, ekspertë në fusha të veçanta apo profesorë vizitorë të huaj;

- Mundësia e studimit dhe përfutimit të njohurive nëpërmjet mësimin në grupe të vogla, me përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies;

- Zhvillimi i eksperiencave nga praktika mësimore në institucione publike dhe private;

- Mundësi shumë të mira punësimi pas diplomimit, mbështetur në besueshmërinë e UBT-së në shoqëri dhe në

qarqet institucionale;

- Komunikimi dhe atmosfera informale në diskutimet midis mësimdhënësve dhe studentëve, me qëllim nxitjen e mendimit të lirë kritik;

- Fokusi i qartë drejt lidhjes së kërkimit shkencor dhe mësimdhënies.

UBT News: Pse të rinjtë duhen të studiojnë në Fakultetin Juridik të UBT-së?

Xhafaj: Studimi në këtë degë realizohet në dy nivele: nivelin bazë dhe atë të specialitetit, të strukturuar sipas parimeve dhe standardeve evropiane të arsimit të lartë. Kështu, programi i studimit ofron arsimin bazë të karakterit të përgjithshëm dhe më pas formimin special.

Programet e ofruara nga Fakulteti Juridik garantojnë mundësinë e ndjekjes së niveleve të njëpasnjëshme të studimeve duke ofruar një shumëllojshmëri të ndrejtimeve në këtë fushë.

Së bashku me konsolidimin e eksperiencës së tij, Fakulteti Juridik ka formuar modelin dhe filozofinë e tij të realizimit të programit, mbështetur në traditën kombëtare të studimit në juridik, ashtu edhe të modeleve më të mira të universiteteve perëndimore, studime shkencore të realizuara, praktikave dhe përvojat ligjore të demokracive të zhvilluara.

UBT News: Sa është numri i studentëve të punësuar dhe i atyre që kanë vazhduar studimet jashtë vendit?

Xhafaj: Ambienti akademik i ofruar për studentët dhe stafin mësimdhënës ofron mundësi, të cilat i shtojnë ata të synojnë nivelin më të lartë të njohurive dhe eksperiencave profesionale.

Studentët që diplomohen në Fakultetin Juridik, në UBT, janë juristë në shoqëri tregtare, juristë të administratës publike, juristë në sistemin bankar, agjentë të sigurimeve, nëpunës të policisë së shtetit, juristë në qendra biznesi dhe organizata të ndryshme joqeveritare.

Njohuritë e fituara prej studentëve mbi sistemin e drejtësisë, si edhe cilësitë njerëzore të kultivuara në auditorë janë jo vetëm një garant i punësimit dhe zhvillimit të profesional të studentëve, por edhe i formimit të gjeneratave të sigurta profesionalistësh, të cilët do të kontribuojnë në zhvillimin shoqëror të Kosovës.

Elementët, të cilat identifikojnë dhe dallojnë Fakultetin Juridik janë njëherazi edhe arsyeja që do të shtynte çdo student të zgjedh UBT-në.



Dekanja e Fakultetit Juridik në UBT, prof. dr. Jorida Xhafaj

Veprimtaria në fakultet realizohet me besimin e plotë së dijet e ofruara janë në përputhje me kërkesat për arsimin cilësor, në meritokraci dhe perspektivë profesionale.

Duke iu referuar të dhënave të nxjerra nga raporti i përvitshëm vlerësues i kryer nga Qendra për Orientim në Karrierë dhe Internship e UBT-së, përmes një pyetësi të realizuar me rrjetin e ish-studentë të institucionit, konfirmohet niveli i lartë i punësimit të tyre, deri në 90%, sidomos në rastet e ndërthurjes së arritjeve akademike me pozitën e tyre të punës.

Programi Juridik dhe diploma e realizuar në përfundim të studimeve, ka mundësuar që studentët të vijojnë studimet master edhe në universitete të huaja, duke dëshmuar ndërkombëtarizimin e diplomës së UBT-së dhe reputacionin pozitiv të ngritur vit pas viti edhe prej rezultateve të studentëve tanë.

Vlen të theksohet se mbështetja e institucionit është reale duke i motivuar edhe studentët aktualë që të studiojnë dhe të besojnë në shpërblimin e përpjekjeve në vite.

## UBT nënshkruan memorandum bashkëpunimi me Universitetin Politeknik të Tiranës



Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi dhe Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, në Universitetin Politeknik (FIN), në Tiranë, prof. Gëzim Hasko, në cilësinë e udhëheqësve, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, me qëllim të zgjerimit të bashkëpunimit mes dyja institucioneve në fushën përkatëse.

Të pranishëm gjatë nënshkrimit të marrëveshjes ishin edhe dekani i Fakultetit Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturë, në UBT, Muhamet Ahmeti, zv.dekani në FIN, prof. Neritan Shkodrani dhe udhëheqësi i departamentit të inxhinierisë për mjedis, prof. Oltion Marko.

Kjo marrëveshje parasheh realizimin e vizitave studimore, kryerjen e hulumtimeve të përbashkëta nga stafi akademik dhe studentët e këtyre institucioneve, ofrimin e ekspertizave profesionale nga të dy institucionet, etj.

Në fund, delegacioni i UBT-së, i prirë nga rektori Hajrizi, kanë vizituar objektin e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, në Tiranë, ku veç tjerash, kanë parë nga afër laboratorët e punës praktike.

## Studentët e UBT-së zhvilluan aksion humanitar në Shtëpinë e të Moshuarve

Studentët e UBT-së kanë vizituar Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare, në Prishtinë, me ç'rast ata kanë zhvilluar një aksion humanitar duke dhuruar batanije dhe gjëra ushqimore për rreth 70 banorë të këtij institucioni.

Ata përveç dhuratave që u dërguan, bashkëbiseduan dhe shprehën solidaritet me këtë kategori shoqërore shumë të ndjeshme. Teksa, studentët e Fakultetit të Infermierisë u kanë bërë edhe kontrolle shëndetësore banorëve.

Studentët treguan se aksione të tilla humanitare do të organizohen edhe në të ardhmen, në mënyrë që të kontribuojnë për vendin dhe qytetarët.





Flet prof. dr. Arian Starova, dekan i Fakultetit të Shkencave Politike në UBT

# Fakulteti i Shkencave Politike, vendi ku përgatiten liderët politikë të së ardhmes

“Cilësia e lartë e mësimdhënies e cila sigurohet nëpërmjet bashkërendimit të përbërjes së trupës së pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm. Një pjesë e mirë e pedagogëve kanë njëherësh edhe përvojë akademike edhe përvojë të punës në institucionet politikëbërëse, çka shërben si burim i rëndësishëm i njohurive për studentët gjatë procesit mësimor”, thekson dr. Starova duke folur për veçantitë e Fakultetit të Shkencave Politike në UBT



Prof. dr. Arian Starova, dekan i Fakultetit të Shkencave Politike në UBT

**UBT News: Çka e bën të veçantë nga fakultetet e ngjashme të universiteteve tjera Fakultetin e Shkencave Politike që ju e drejtoni?**

**Starova:** Programet mësimore të Fakultetit të Shkencave Politike, në UBT, janë mbështetur mbi përvojat më të mira të fakulteteve të huaja të mirënjohura në shkencë politike.

Brenda kësaj ngjashmërie, fakulteti ynë ka veçantitë e tij në disa drejtime:

- Cilësia e lartë e mësimdhënies e cila sigurohet nëpërmjet bashkërendimit të përbërjes së trupës së pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm. Një pjesë e mirë e pedagogëve kanë njëherësh edhe përvojë akademike edhe përvojë të punës në institucionet politikëbërëse, çka shërben si burim i rëndësishëm i njohurive për studentët gjatë procesit mësimor.

- Cilësia e studentëve që kanë përfunduar studimet e këtij fakulteti është e spikatur, jo vetëm për shkak të vlerësimeve të lartë me anën e notave, por edhe të interesit të lartë studimor të shfaqur përgjatë viteve të studimeve. Një pjesë e mirë e këtyre studentëve janë punësuar në institucione të shtetit, ose për ta është treguar interes nga këto institucione që në vitet e studimeve.

- Organizimi i shpeshtë dhe i rregullt i veprimtarive të ndryshme, duke ftuar zyrtarë të ndryshëm të institucioneve politike dhe diplomatike, vendas dhe të huaj. Këto veprimtari u japin studentëve edhe shumë njohuri praktike nga fusha e politikës dhe e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Pikërisht për këtë synim është krijuar dhe vepron Forumi i Shkencave Politike i cili organizon thauja për çdo javë veprimtari të tilla me folës të ndryshëm, në të cilat ata ndajnë me studentët përvojën e tyre të punës nëpërmjet ligjërimeve mbi tema të veçanta dhe diskutimeve të shoqëruara me py-

etje dhe përgjigje.

Në mënyrë të veçantë, këto veprimtari shërbejnë për zhvillimin e arsytimit kritik të studentëve.

Ky forum mundëson edhe krijimin e lidhjeve ndërmjet studentëve dhe të ftuarve të veprimtarive, nëpërmjet të cilave studentët informohen, shfaqin interesat e tyre për probleme të ndryshme, apo për punësimin e tyre të ardhshëm.

- Vizitat studimore në disa prej institucioneve më të rëndësishme të vendit, si: Kuvendi i Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Ministria e Punëve të Jashtme, etj. Po ashtu, atyre u mundësohet të bëjnë vizita studimore edhe në vendet e regjionit, si Shqipëria dhe Maqedonia, ku vizitojnë disa nga institucionet kyçe të shtetit.

- Fakulteti ynë shquhet për një marrëdhënie bashkëpunuese të veçantë pedagog-student, e cila shprehet në veprimtari shkencore të përbashkëta, në studime të veçanta që ata ndërmarrin, në punimet shkencore të vetë studentëve, etj.

- Studentët tanë të Shkencave Politike kanë mundësi, të mbështetur në marrëveshjet përkatëse të UBT-së, që të kryejnë pjesë të veçanta të procesit mësimor në universitete të tjerë jashtë vendit, si p.sh: në Varshavë, Vjenë, Salzburg, Ljubljana, etj.

- Veprimtaritë e mirëfillta shkencore që mishërohen në dy veprimtari të rëndësishme madhore, që janë Konferenca Shkencore Ndërkombëtare Vjetore dhe Akademia Verore Studentore.

Këto dy veprimtari janë themelore për Fakultetin e Shkencave Politike dhe UBT-në, si mbështetëse të cilësisë së procesit mësimdhënës, ndërlidhëse me veprimtarinë akademike ndërkombëtare dhe shërbim ndaj nevojave shtetndërtuese të Kosovës.

**UBT News: Cilat janë specializimet që i ka Fakulteti i**

**Shkencave Politike i UBT-së?**

**Starova:** Fakulteti ynë ka tri degë të veçanta të nivelit bachelor dhe studentët mund të përzgjedhin njëren prej tyre në vitin e tretë të studimeve.

Këta specializime janë:

- Administrimi Publik
- Marrëdhëniet Ndërkombëtare
- Integrimet Evropiane

Përveç nivelit bachelor, ofrohen edhe studime të nivelit master, tani për tani, vetëm për degën e Administrimit Publik. Synimi i fakultetit tonë është që ta shtrijë nivelin master edhe në dy degët e tjera.

Këshilli Akademik i fakultetit është duke menduar dhe duke punuar për këtë dhe, ndoshta, mund të arrijnë në vendim-marrjen për hapjen e dhe të një ose dy degëve të reja në vitet e ardhshme.

**UBT News: Përse studentët duhet të vijnë për të ndjekur studimet në Fakultetin e Shkencave Politike të UBT-së, sipas mendimit tuaj?**

**Starova:** Programi që ofron Fakulteti i Shkencave Politike i UBT-së është hartuar duke mbajtur në mënyrë të posaçme nevojat e tregut të punës për të pasur sa më shumë ekspertë të politikës, të cilët dinë t'u përgjigjen prirjeve në rritje të zhvillimit të Kosovës, forcimit të institucioneve të saj demokratike dhe proceseve të integritimeve madhore euroatlantike.

Për këto arsye, programet mësimore dhe veprimtaritë akademike-shkencore u kushtojnë vëmendje të veçantë politikave të veçanta të Kosovës, rolit të veçantë të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë dhe zhvillimit të marrëdhënieve ndërkombëtare të Kosovës, si një shtet i ri.

Fitim Alidema, drejtor i Fakulteteve Mjekësore

# Fakulteti i Infermierisë, vatra e përgatitjes profesionale të infermierëve të ardhshëm

Programi i Infermierisë, në UBT, aktualisht është i orientuar të ofrojë shërbime profesionale, me qëllim që studentët e këtij drejtimi të përgatiten për tregun e punës, gjithmonë duke iu ofruar leksione, punë praktike e trajnime të shumta.

Drejtori i Fakulteteve Mjekësore, Fitim Alidema ka bërë të ditur se, ndonëse në vitin e dytë të ekzistimit, studentët e këtij fakulteti po tregohen jashtëzakonisht të suksesshëm dhe solidarë.

UBT News: Çka e bën të veçantë nga fakultetet e ngjashme të universiteteve tjera Fakultetin e Infermierisë që ju e drejtoni?

Alidema: Fakulteti Infermierisë i UBT-së është një ndër fakultetet më të mëdha në vend, ndonëse është gjenerata e dytë i fillimit dhe studentët janë prioritet i stafit të profesorëve dhe menaxhmentit të këtij fakulteti.

Në Fakultetin e Infermierisë leksionet i ndjekin mbi 1200 studentë të ndarë në grupe me afro 45 studentë. Grupet e vogla u mundësojnë studentëve tanë cilësi në mësimnxënie dhe disiplinë. Studentët e Fakultetit të Infermierisë, pjesën teorike i ndjekin në salla mësimore moderne me hapësira standarde, të pajisura me projektorë dhe TV ekrane, ku mësimxënia është më e lehtë. Ndërkaq, pjesën praktike, studentët e vijnë në laboratorë dhe salla simuluese moderne, ku secili student është i pajisur me hapësirën e nevojshme për ushtrimore.

Numri i pjesëmarrësve në pjesën praktike përbëhet nga 12 studentë.

Profesorët të cilët ligjërojnë në Fakultetin e Infermierisë janë të gjithë me përgatitje të lartë shkencore e profesionale



dhe me përvojë të gjatë në mësimdhënie.

UBT News: Çka e bën të veçantë nga fakultetet e ngjashme të universiteteve tjera Fakultetin e Infermierisë që ju e drejtoni?

Alidema: Specifikat e fakultetit janë:

- Studenti formohet teorikisht dhe praktikisht, ku pjesa praktike profesionale bëhet në Qendra të Mjekësisë Familjare në Prishtinë, Pejë, Gjilan, Ferizaj, Lipjan, Prizren etj., kurse për studentet e vitit dytë dhe të tretë, praktika klinike

bëhet në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë dhe në Spitalet Rajonale, me të cilat kemi marrëveshje bashkëpunimi, si: Prizreni, Gjilani, Peja dhe Ferizaj.

- Studentet duhet të zgjedhin UBT-në për arsye se afrohet dije, përkushtim, mësimdhënie dhe profesionalizëm.

- Në Fakultetin e Infermierisë numri i studentëve të cilët janë transferuar nga institucionet tjera është një tregues real se punohet dhe çmohen studentët. Studentët e Fakultetit të Infermierisë janë të kërkuar për punësim në institucione spitalore publike e private.

Disa studentë tanimë janë të punësuar në Qendrën rehabilituese për terapi fizikale "Banja e Kllokotit", "Qendrën rehabilituese për terapi Fizikale "Nëna Naile", në Spitalin Rajonal të Ferizajt, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe në QMF.

UBT News: Çfarë po e tërheq fluksin e madh të të rinjve, për të studiuar në UBT?

Alidema: UBT posedon kabinetet e infermierisë, që janë të pajisura edhe me aparatura moderne, salla adekuate për mësimdhënie, si dhe profesorë vendorë e ndërkombëtarë.

UBT ka bashkëpunim dhe në partneritet me më shumë se 250 universitete botërore, andaj ai konsideroi se programi i Infermierisë është i harmonizuar me rregullat e Bashkimit Evropian si dhe ofron mundësi transferimi dhe njohje në Evropë



## Studentët e UBT-së shënojnë Ditën Ndërkombëtare të Infermierisë



Me rastin e shënimit të 12 majit, Ditës Ndërkombëtare të Infermierisë, studentët e Fakultetit të Infermierisë në UBT, në bashkëpunim me Grupin për Edukim dhe Promovim Shëndetësor në UBT, si dhe Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë dhe Ferizaj, kanë zhvilluar disa aktivitete simbolike.

Aktivitetet janë mbajtur në parkun e Gërmisë, në Prishtinë, si dhe në sheshin kryesor të komunës së Ferizajt.

Kjo ditë u shënuar me shpërndarjen e fletëpalosjeve me përmbajtje sensibilizimi dhe informimi, teksa qytetarët e rastit kanë pasur mundësinë të bëjnë matjen e shtypjes dhe sheqerit në gjak. Aktivitetet janë zhvilluar nën mbikëqyrjen e ligjëruesve në UBT, Fitim Alidema, Besnik Elshani dhe përfaqësueses së Grupit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor në UBT, Vlora Sveqlla.

# Fakulteti i MBE-së, mundësi e pakrahasueshme studimi

**“Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi (MBE) është fakulteti me traditën më të gjatë në UBT. Marrë parasysh eksperiencën e gjatë në akademi dhe besimin e vazhdueshëm të studentëve ndaj fakultetit tonë, MBE çdo vit shënon rritje të numrit të studentëve, si në nivelin Bachelor, ashtu edhe në atë Master”**



**“Me anë të partneriteteve që UBT ka krijuar ndër vite me universitete prestigjioze ndërkombëtare, shumë nga studentët e diplomuar në MBE kanë shfrytëzuar mundësinë e vazhdimin të studimeve jashtë vendit dhe tashmë kontributin e tyre nga ana akademike, e dhënë në fakultetin MBE, si ligjërues të rregullt apo të angazhuar”, thotë Naim Preniqi**

Fakulteti Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, në nivelet bachelor dhe master, ofron mundësi të dyfishta, përfshirë punësimin dhe vazhdimin e studimeve jashtë vendit në universitetet ku UBT ka marrëveshje bashkëpunimi.

Fakulteti Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi i UBT-së, falë programeve specifike që i ofron nga fushat e Menaxhmentit, të Biznesit dhe të Ekonomisë është shndërruar në zgjedhje ideale për studentët aktualë dhe ata të ardhshëm të këtij drejtimi.

Në këtë fakultet ligjërojnë stafi akademik me përvojë shumëvjeçare në fushat përkatëse, derisa veç ligjëratarëve, fakulteti organizon vizita studimore, punëtori të shumta etj. Në një bisedë për Media Grupin e UBT, menaxheri i këtij fakulteti, Naim Preniqi, ka treguar për programin dhe veçantitë e njërës prej fakulteteve më të kërkuara në vend.

**Media Grupi:** Çka e bën të veçantë Fakultetin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT?

**Naim Preniqi:** Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi (MBE) është fakulteti me traditën më të gjatë në UBT. Marrë parasysh eksperiencën e gjatë në akademi dhe besimin e vazhdueshëm të studentëve ndaj fakultetit tonë, MBE çdo vit shënon rritje të numrit të studentëve, si në

nivelin Bachelor, ashtu edhe në atë Master. Specializimet e ofruara nga fakulteti MBE janë të larmishme dhe unike në tregun tonë dhe në rajon. Fakulteti ynë vepron me 5 specializime paralelisht në nivelin Bachelor, si dhe 4 specializime në Master.

Marrë parasysh se në shumicën e institucioneve të arsimit të lartë, fushat e Financave dhe Kontabilitetit mësohen në të njëjtin specializim, fakulteti MBE ka bërë ndarjen e këtyre fushave në dy specializime të veçanta (Kontabilitet, Auditim dhe Tatime si dhe Financa, Banka dhe Sigurime), ku fushat përkatëse mësohen në mënyrë më të detajuar. Specializimet e tjera që janë mjaft të kërkuara nga publiku në përgjithësi janë edhe Marketing dhe Shitje; Menaxhment, Ndërmarrësi dhe Inovacion si dhe Biznes Ndërkombëtar.

Fushat e Biznesit Ndërkombëtar në Bachelor si dhe specializimi Logjistikë dhe Menaxhim i Prokurimit në Master, janë dy fusha inovative dhe shumë pak të mbuluara nga institucionet tjera në Kosovë.

**Media Grupi:** Cilat janë specifikat e Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi?

**Naim Preniqi:** Stafi akademik i fakultetit MBE përbëhet nga profesorë me eksperiencë, që kanë përvojë të gjatë në arsim si dhe në industri. Shumica e stafit përbëhet nga profesorë doktorantë, apo në proces të përfundimit të studimeve të doktoratës (PhD candidates), me njohuri të gjera në fushën e ekonomisë. Në mënyrë që studentët të marrin pak edhe nga fryma perëndimore, disa nga profesorët e lëndëve të disa specializimeve, si në nivelin Bachelor ashtu edhe në atë Master, vijnë nga shtetet perëndimore, nga universitete me të cilat ne jemi partnerë në fushën e Akademisë. Profesorët nga Gjermania, Austria, Hungaria e SHBA-të vijnë si profesorë vizitues gjatë semestrave të rregullt si dhe gjatë akademisë verore, që organizohet nga të gjitha fakultetet e UBT përkatësisht. Përveç profesorëve ndërkombëtar, në MBE ligjërojnë profesorë vendorë që vijnë nga industria, të cilët më së miri lidhin të mësuarit teorik me praktikën. Për shkak të raporteve të tyre të mira me njerëz nga industria, shpeshherë kemi ligjërata edhe nga folës mysafirë (menaxherë, ndërmarrës apo financiarë të suksesshëm) që ju japin këshilla dhe dije nga përvoja e tyre edhe studentëve të MBE-së.

Studentët e MBE-së kanë mundësi që gjatë studimeve të tyre të fitojnë edhe njohuri shtesë si dhe trajnime që ofro-

hen nga UBT. Falë partneritetit që UBT ka me Shoqatën e Kontabilistëve të certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SCAAK), niveli i parë (njëvjeçar) i këtij trajnimi ofrohet pa pagesë për studentët e MBE-së. Trajnimi ofrohet për të gjithë studentët e MBE-së, mirëpo është specifikisht i destinuar për studentët e fushës së Financave dhe Kontabilitetit. Krahas SCAAK-ut, studentët mund të certifikohen edhe duke ndjekur trajnimet për IPMA, që lidhen kryesisht me studentët e interesuar për fushën e menaxhimit të projekteve.

Studentët të cilët tregojnë përkushtim dhe angazhim gjatë studimeve, nuk mbesin pa u vërejtur nga stafi akademik i fakultetit tonë. Fillimisht me anë të praktikave dhe pastaj me anë të angazhimit të tyre të plotë, shumë studentë të dalluar kanë arritur të punësohen në UBT, ku aktualisht studentët e diplomuar në fakultetin MBE paraqesin përqindje mjaft të madhe të të punësuarve në UBT. Përveç mundësisë së punësimit në institucion, studentët janë gjatë gjithë kohës të informuar nga fakulteti dhe qendra e karrierës për mundësitë e ndryshme për praktikë/punësim në industri, andaj shumë nga studentët tanë duke shfrytëzuar këto mundësi, tashmë janë të punësuar.

**Media Grupi:** Pse studentët, sipas jush, duhet të transferohen në UBT, saktësisht në fakultetin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi?

**Naim Preniqi:** Me anë të partneriteteve që UBT ka krijuar ndër vite me universitete prestigjioze ndërkombëtare, shumë nga studentët e diplomuar në MBE kanë shfrytëzuar mundësinë e vazhdimin të studimeve jashtë vendit dhe tashmë kontributin e tyre nga ana akademike, e dhënë në fakultetin MBE, si ligjërues të rregullt apo të angazhuar.

Marrë parasysh kërkesën e vazhdueshme për ekspertë nga nënfusha të ndryshme të fushës së Ekonomisë, Fakulteti MBE vazhdon të jetë njëri nga destinacionet më të dëshiruara nga studentët në UBT. Krahas ndihmës akademike nga ana e stafit të angazhuar në mësimdhënie, studentët mund të shfrytëzojnë edhe të gjitha mundësitë që ofron fakulteti ynë, këshillimin dhe ndihmën e vazhdueshme nga stafi i fakultetit MBE, si tutorime, ushtrime si dhe udhëzime për karrierë. Misioni ynë është ruajtja e cilësisë, andaj me angazhimin tonë të vazhdueshme, synojmë që t'i nxisim studentët seriozë të ecin përpara dhe të avancohen në karrierë.

Intervistë me dekanen e Fakultetit të Stomatologjisë, prof. dr Merita Barani

## Fakulteti i Stomatologjisë në UBT, vendi që synon të krijojë kuadro të përgatitura në bazë të standardeve ndërkombëtare



**“Fakulteti i Stomatologjisë në UBT do të shërbejë si një qendër referuese për studime akademike ndërkombëtare në rajon dhe kështu do të shndërrohet në zgjedhjen më të mirë të studentëve të ardhshëm”, thotë Merita Barani**

**Media Grupi:** Çka e bën të veçantë fakultetin që ju e drejtoni?

**Merita Barani:** Fakulteti i Stomatologjisë pranë UBT-së vazhdon të mbetet një vend inovativ i arsimit të lartë në Kosovë dhe në rajon, i cili kombinon përparësitë e fakulteteve të mirënjohura ndërkombëtare. Ky fakultet ofron arsim bashkëkohor, studim sipas standardeve cilësore ndërkombëtare, akademike dhe ekspertë eminentë që ligjërojnë për studentët tanë, partneritet me universitete dhe institucione të mirënjohura, mundësi për përvoja të jashtme (studime profesionale e praktika), infrastrukturë moderne, organizim dhe menaxhim modern, në pajtim me standardin ISO 9001. Krahas kësaj, fakulteti ynë mundëson edhe lidhje direkte me ekonominë, projekte hulumtuese akademike dhe ndërkombëtare, transferim të njohurive të teknologjisë së lartë, për të përgatitur në fund studentë e staf tejet të motivuar.

**Media Grupi:** Cilat janë specifikat e Fakultetit të Stomatologjisë?

**Merita Barani:** Si Fakulteti i Stomatologjisë jemi të përkushtuar në zhvillimin e programeve akademike, të cilat janë kombinuar me hulumtime shkencore të kualitetit të lartë

dhe në harmoni me standarde ndërkombëtare.

Fakulteti i Stomatologjisë synon që të ndërtojë një institucion akademik privat, si një alternativë e rëndësishme për arsimin e lartë në Kosovë dhe rreth saj, si dhe të sjellë standarde ndërkombëtare adekuate për zhvillimin e programeve të studimit. Po ashtu, ky fakultet synon të zhvillojë dhe të promovojë kapacitetet vendore profesionale dhe akademike në përputhje me standardet më të larta në botë.

**Media Grupi:** Cili është synimi kryesor i fakultetit tuaj, në raport me suksesin e studentëve?

**Merita Barani:** Ne synojmë të kontribuojmë në ngritjen e cilësisë së studimeve akademike, si dhe në krijimin e një ambienti akademik dhe kulturor në shoqërinë kosovare.

UBT planifikon të krijojë një institucion për studime universitare të hapur për të gjithë, pa pasur dallime dhe në bazë të meritave, dhe të ndërtojë një mekanizëm profesional të domosdoshëm për bashkëpunim të suksesshëm me të gjitha institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare, duke përfshirë komunitetin e biznesit vendor dhe ndërkombëtar. Fakulteti do të shërbejë si një qendër referuese për studime akademike ndërkombëtare në rajon dhe kështu do të shndërrohet në zgjedhjen më të mirë të studentëve të ardhshëm.

Vështrim

# Siguria Online dhe rreziku nga sulmet kibernetike



## Atthe Buja, menaxher i UBT-CERT divizionit

Me zhvillimin historik të rrjetave së bashku me të edhe Internetit siguria është bërë një çështje për tu shqetësuar. Me avancimin e komunikimeve elektronike në forma, teknika dhe teknologji shfaqeshin sulme si thyerje të sistemeve industriale, rrjedhje të informacioneve e më vonë edhe infektimin me virus, softuer të dëmshëm ang. Malwares u bë çështje dhe nevojë për trajtimin e Cyber Security të infrastrukturave kritike të informacionit. Kjo ka një impakt direkt në jetën e qytetarëve sepse duke sulmuar infrastrukturën kritike të informacionit psh. Sektorët e shëndetësisë, financave, TIK etj largon nga funksioni shërbimet online dhe rrezikon të dhënat e të gjithëve. Muajt e fundit është vënë re një rritje globale e incidenteve të sigurisë kibernetike, dua të kujtoj vetëm disa nga ato me impaktin më të gjerë në shoqëri sulmet kibernetike të llojit Botnest, Dos & DdoS, Cyberbullying, Ransomware etj. Sulmet më të shpeshta kibernetike që ndodhin në web janë ato klasike të cilat i njohim si viruset, kodet e infektuara, skanimi i porteve, email të rremë, vjedhja e të dhënave dhe manipulimi i tyre etj.

Avancimet teknologjike kanë sjell njëkohësisht edhe avancimet në lloje, teknike e metoda të sulmeve kibernetike. Sigurimi i informacionit çdo ditë e më shumë po bëhet një fushë shumë shqetësuese, për organizatat dhe agjencitë qeveritare por edhe vetë individët. Tek çdo aplikacion i ri që po del në treg, bashkë me të edhe dobësi të reja po shfaqen

të cilat po paraqesin sfida për të mbrojtur asetet e Teknologjisë Informative.


Incidentet e sigurisë kibernetike nuk mund të reduktohen nga një vend apo entitet i vetëm mirëpo nga një bashkëpunim, koordinim e komunikim të rregullt ndërmjet palëve të interesit përmes një “Plani Kombëtar të Reagimit për infrastrukturën kritike të informacionit” do të kishte një rezultat shumë pozitiv në reduktim por edhe parandalim të incidenteve. Është momenti ku duhet të intensifikojmë komunikimin dhe bashkëpunimin vendor e ndërkombëtarë me shumë organizata, në shkëmbimin e eksperiencave me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë së infrastrukturave të TIK-ut në vend e rajon. Përdoruesi i fundëm, klienti mund të jetë viktimë ose sulmues në të njëjtën kohë, për këtë arsye duhet një angazhim më i madh në edukimin e tyre për përdorim të sigurtë të internetit dhe kujdes të veçantë përball rreziqeve që shfaqen.

Fushata lansuar “Këshilla për Sigurinë”

Divizioni CERT në UBT njohur në gjuhën teknike “Ekipi për Reagime Emergjente” në rastet e sigurisë kibernetike, ang. “Computer Emergency Response Team”. Ka përgatitur disa materiale dhe forma të komunikimit për fushatën e radhës emërtuar “Këshilla për Sigurinë” me target fëmijët dhe gjeneratën e shkollave të mesme. Në gazetën e UBT News të këtij numri të fundit do të mund ta gjeni të bash-

kangjitur fletushkën me “Udhëzime për mbrojtjen e fëmijëve në përdorim të Internetit” këtu jepen qartë udhëzimet teknike hap pas hapi për tu mbrojtur nga sulmet kibernetike ose mashtrimeve të ndryshme gjatë përdorimit të internetit, përgatitur për pajisjes mobile të llojit Android dhe iOS për shkak të përdorimit të madh të pajisjeve mobile edhe është zgjedhur të jepen udhëzime për këto pajisje. Me fokus të veçantë konfigurimi i kontrolleve prindërore. CERT divizioni tashmë anëtarë i FIRST organizatës më të madhe në botë për siguri. Mbetet i përkushtuar që përmes angazhimit direkt në çështjet e sigurisë, programeve të edukimit e studimit, trajnimeve, internshipeve dhe aktiviteteve tjera të jap kontributin në dhënien dhe transferin e njohurisë, ngritjen e sigurisë së infrastrukturave kritike të informacionit në vend dhe rajon. Kjo është faza e parë e fushatës lansuar “Këshilla për Sigurinë”, javët vazhdim do ta fillojmë edhe me takime dhe workshope të organizuara në disa komuna të vendit ku nga e kaluara kanë qenë target gjeneratat e reja nga sulmet kibernetike. Do të zhvillohen dhe ofrohen për publikun e gjerë mekanizmat mbrojtës të sigurisë kibernetike për të gjitha kategoritë e shoqërisë në vend dhe rajon. Jemi në fazën e fundit të ngritjes së platformës digjitale për regjistrimin, analizën dhe dhënien e zgjidhjes për softuerët e dëmshëm ang. Malwares për të gjithë sektorin privat dhe publik por edhe vetë qytetarët.

## Studentet e Sistemeve të Informacionit vizituan kompaninë “Katrori ITS”



Në vazhden e vizitave studimore, studentët e Fakultetit Sistemet e Informacionit në UBT, kanë vizituar kompaninë “Katrori ITS”, me ç’rast janë njoftuar me shërbimet që ofron institucioni.

Gjatë kësaj vizite, studentët kanë parë nga afër zhvillimin e sistemeve ERP, ku janë njohur me funksionimin praktik të këtyre sistemeve dhe metodat e zhvillimit të tyre.

Studentët janë pritur nga Fatos Fondaj, një nga themeluesit e kompanisë, i cili ka treguar mënyrën e realizimit të projekteve, duke filluar nga kontakti me klientë, zhvillimin e ideve, prezantimin e modeleve, zhvillimin e sistemeve dhe aplikimin në praktikë.

Vizita është realizuar në kuadër të lëndës Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit dhe Rrjetat Kompjuterike, që ligjërohet nga profesori Blerton Abazi. Ai ka thënë se vizitat e tilla shërbejnë si modele për të parë funksionimin e sistemeve të informacionit në praktike, si dhe krijimin e kontakteve mes akademisë dhe industrisë.

## Aktivitete të Fakultetit për Media dhe Komunikim

## Në UBT u mbajt konferenca “Roli i klubit zviceran të shtypit dhe mediave në Gjenevë dhe diplomacia publike e parlamentare”

UBT dhe Shoqata Franko-Shqiptare, me seli në Zvicër, u bënë bashkë për të trajtuar aspekte dhe çështje të ndryshme mediale e politike, në kuadër të konferencës “Roli i klubit zviceran të shtypit dhe mediave në Gjenevë dhe diplomacia publike e parlamentare”, që u mbajt në kampusin e UBT-së, në Prishtinë.

Në hapje të kësaj konference, dekani i Fakultetit Media dhe Komunikim, prof. dr Ferid Selimi, tha se konferencat e tilla janë një mundësi unike për studentët që të mësojnë nga përvojat e vendeve tjera në fushën e medias dhe politikës.

Duke folur për ndikimin e mediave dhe politikës në jetën e përditshme të secilit qytetar, dekani i Fakultetit të Shkencave Politike, prof. dr Arian Starova, e konsideroi një përvojë të vlefshme ndarjen e përvojave me studentët, teksa i inkurajoi këta të fundit që të tregohen të zëshëm në profesionet që kanë zgjedhur dhe të ndikojnë pozitivisht në ndryshimet shoqërore.

Në anën tjetër, sipas kryetarit të Shoqatës së Franko-Shqiptare, Tahir Shabani, është qenësore që gjeneratat e reja të marrin përvojat nga ata që kanë kaluar nëpër procese të ngjashme dhe që të njëjtat të shfrytëzohen në përmirësimin e nivelit akademik dhe jetësor.

Në këtë konferencë nuk munguan as përfaqësues institucionesh, me ç’rast e pranishme ishte zv.ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Burbuqe Bakija-Deva, e cila i

inkurajoi studentët që të bëhen forca e ndryshimit që i shtynë institucionet drejt marrjes së vendimeve të duhura.

Fokusi i kësaj konference ishte tek ligjëratat tematike me titull: “Roli i klubit zviceran të shtypit dhe mediave në Gjenevë dhe diplomacia publike e parlamentare”, e trajtuar nga ish-gazetari dhe deputeti në parlamentin e Gjenevës, Guy Mettan.

Ai tha se mediat janë faktor tejet i rëndësishëm në ndërtimin dhe ruajtjen e demokracisë së një shteti, dhe për më tepër, sipas tij, kanë ndikim të drejtpërdrejtë edhe në zhvillimin ekonomik dhe në rrjedhën politike të ngjarjeve. “Mediat kanë rol kyç në krijimin e të gjitha llojeve të politikave dhe të njëjtat mund të sjellin ndryshime që ndikojnë në mënyrën e jetesës së secilit qytetar”.

Mettan shpërfaqoi edhe problemet me të cilat ai konsideron që po përballen mediat botërore aktualisht.

“Krizat mediatike po vërehet në çdo vend. Numri i gazetave të shtypura po bie në mënyrë drastike, konkurrenca me rrjetet sociale po ndikon në zbehjen e rolit të mediave dhe shtimi i lajmeve të rreme, janë disa nga faktorët që po ndikojnë në zvogëlimin e hapësirës mediale”, sqaroi ai.

Për studentët, Mettan tregoi edhe organizimin e sistemit politik në Zvicër, teksa trajtoi edhe formën se si zgjidhen problemet dhe se si merren vendimet madhore që e pre-



kin jetën e qytetarëve.

Tema ngjalli interesim të madh ndër studentë, të cilët parashtruan pyetje që kishin të bënin me ndikimin e njerëzve me prejardhje shqiptare në mediat franceze, pastaj pyetën edhe për çështjen e ndikimit të ndërsjellë ndërmjet mediave dhe politikës dhe ndërhyrjen në agjendat e njëra-tjetrës, si dhe për profesionalizmin dhe pavarësinë e mediave të mëdha zvicerane dhe atyre botërore.



## UBT pjesë e partneritetit në kuadër të projektit MDTV

UBT është duke marrë pjesë në takimin e parë zyrtar në kuadër të projektit MDTV (Multimedia dhe TV Digjital), që po mbahet në Durrës dhe ku po marrin pjesë të gjithë partnerët e përfshirë në këtë projekt, të financuar e mbështetur nga programi Erasmus+.

Qëllimi i këtij projekti është që të zhvillojë programe dhe module të reja në fushën e multimediave dhe televizionit digjital, për të adresuar nevojat e ngritjes së kapaciteteve të reja në nivel të ekspertëve të kësaj fushe.

Partnerë në realizimin e këtij projekti të përbashkët janë: Kosova, që po përfaqësohet nga UBT dhe UP, Shqipëria, e përfaqësuar nga Universiteti Aleksandër Mosiu, RTSH dhe Universiteti Epoka, si dhe universitete të tjera nga zona e Bashkimit Evropian, përfshirë Universiteti i Lubjanës nga Sllovenia, Universiteti i Ostravës nga Çekia dhe Universiteti Tartu nga Estonia.

Në këtë takim UBT po përfaqësohet nga anëtarët e Zyrës së Projekteve të UBT-së, Naim Preniqi dhe Hazer Dana.

### Juridiku në UBT, një drejtim tërheqës për të rinjtë

## UBT – zgjedhja e parë për studentët që duan të transferohen

Qindra studentë nga Kosova dhe shtetet fqinje të cilët aspirojnë të kenë studime dhe karrierë të suksesshme, pikë orientuese dhe zgjedhje të parë e kanë UBT-në, si institucioni më i madh arsimor në vend që ofron studime cilësore.

Në mesin e studentëve që këtë mundësi i besuan UBT-së është edhe Fjolla Berisha, e cila vitin e kaluar është transferuar nga Universiteti i Prishtinës, në Fakultetin Juridik në UBT.

Duke treguar arsyet që e kanë shtyrë për tu transferuar në UBT, Fjolla ka thënë se e veçanta e institucionit është se numëron shumë programe me specializime unike dhe se ka infrastrukturë moderne. Sipas saj, UBT i mundëson studentëve të vet vijim të studimeve me standarde evropiane.

“Në UBT e ndjej veten vërtet studente. Më mundësohet komunikimi me profesorë dhe si rezultat i komunikimit dhe përkrahjes së tyre ne po ecim shumë përpara profesionalisht”, ka treguar ajo.

Tutje, ajo tha se specifikat që e bëjnë UBT-në të dallohet nga institucionet tjera janë të shumta, përfshirë diplomën e institucionit që njihet ndërkombëtarisht dhe studentët qasen lehtësisht në tregun vendor e ndërkombëtar të punës.

Studentët të cilët synojnë të behen pjesë e UBT-së, përmes transferimit, hapi i parë që duhet ta bëjë çdo stu-



dent, është plotësimi i formularit për aplikim, me kushtin që studentët të kenë të përfunduar së paku një provim në njërin prej institucioneve shtetërore apo private të arsimit të lartë në Kosovë.

Derisa, afati i fundit për pranimin e dokumentacionit për transferim të studimeve në UBT është 28 shkurti.

## UBT anëtarësohet në Asociacionin Evropian të Fakulteteve të Drejtësisë (ELFA)

Pas një pune intensive në fushën e juridikut, Fakulteti Juridik i UBT-së është bërë anëtar me të drejta të plota në Asociacionin Evropian të Fakulteteve të Drejtësisë (ELFA).

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, tha se anëtarësimi i UBT-së në këtë organizatë është një hap dhe arritje e madhe jo vetëm për institucionin, por edhe për Kosovën, pasi në këtë mënyrë do të jetë i mundur angazhimi dhe ndikimi në zhvillimet në fushën e drejtësisë. “UBT veçse është pjesë e shumë organizatave ndërkomb-

bëtare për fusha të ndryshme, por ky anëtarësim ka një vlerë të madhe pasi drejtësia është një fushë që vazhdimisht ka nevojë për zhvillim dhe përkrahje, andaj tash e tutje, kjo do të ofrohet përmes Fakultetit Juridik në UBT, në aspektin e përgatitjes së juristëve të denjë të së ardhmes”, potencoi Hajrizi.

ELFA u themelua në vitin 1995 në Leuven të Belgjikës, nga më shumë se 80 fakultete të drejtësisë të universiteteve të ndryshme anembanë Evropës.

Organizata momentalisht ka më shumë se 200 anëtarë

nga vende brenda dhe jashtë BE-së dhe vepron si një forum ndërkombëtar për diskutimin e shumë temave ligjore lidhur me arsimin ligjor.

Qëllimi i aktiviteteve të ELFA-s është koordinimi i procesit të reformimit të arsimit ligjor në Evropë, prezantimi i temave të reja, promovimi i bashkëpunimit midis universiteteve në Evropë. Aktualisht, fokusi më i rëndësishëm i aktiviteteve të ELFA-s është reformimi i arsimit ligjor në Evropë.

Fakulteti i Inxh inierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës

## Ligji i ri për kundërvajtje në trafikun rrugor, shpresë për zvogëlimin e numrit të aksidenteve

Rritja e numrit të aksidenteve me fatalitet dhe me lëndime trupore përgjatë vitit të kaluar, ka rezultuar me sjelljen në fuqi të ligjit të ri për kundërvajtje në trafikun rrugor, i cili tashmë vetëm se ka filluar t'i japë frytet e para të përmirësimit të gjendjes.

Kështu thanë ekspertët në forumin: “Rregullat e Reja të Sigurisë në Komunikacionin Rrugor në Kosovë”, që u organizua nga Fakulteti i Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës në UBT.

Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës, prof. dr. Muhamet Ahmeti, tha se qëllimi i organizimit të këtij forumi është që të kontribuojë në ndërgjegjësimin dhe informimin lidhur me ligjin e ri dhe rregullat e reja në komunikacionin rrugor.

Duke i analizuar rrethanat e gjendjes së krijuar gjatë viteve të kaluara, drejtori i Departamentit të Trafikut në Policinë e Kosovës, Jeton Rexhepi, tha se fajtori kryesor për shkaktimin e aksidenteve është faktori njeri.

“Në Kosovë, në vitin e kaluar kanë vdekur në aksidente të komunikacionit mbi 137 persona. Faktori njeri, mbi 85% të rasteve, është faktor në shkaktimin e aksidenteve, pa anashkaluar edhe faktorin rrugë dhe automjet. Shkaktimin më të



Dr. Muhamet Ahmeti, dekan i Fakultetit të Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës

madh të aksidenteve e bën shoferi duke mos e përshtatur shpejtësinë me kushtet e rrugës”, tha ndër tjerash Rexhepi. Në këtë forum morën pjesë dhe dhanë kontribut të çmuar për trajtimin e kësaj çështjeje edhe njohës të tjerë të fushës së komunikacionit, përfshirë Biljana Rexhiqi, gjyqtare në

Gjykatën e Apelit të Kosovës, Haxhi Krasniqi, kryesues i Komisionit për Vendosije në Policinë e Kosovës dhe Milaim Ahmetaj, udhëheqës i Divizionit për hartimin dhe harmonizimin e legjislacionit.

## Në UBT u diskutua për cilësinë e ajrit, energjia ndotësi më i madh



Është mbajtur forumi i parë profesional akademik me temë: “Çështjet urbane mjedisore, ndotja e ajrit në Prishtinë dhe më gjerë”, organizuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Ndërtimore e Infrastrukturës dhe Fakulteti i Energjisë Eficiente, ku panelistë të këtij forumi ishin përfaqësues të shoqërisë civile, si dhe ekspertë të fushës përkatëse.

Në këtë forum është diskutuar për cilësinë e ajrit dhe çështjet ambientale në Kosovë, me ç'rast rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi ka thënë këto probleme datojnë qysh vite më parë.

Tutje, ai ka thënë se në Kosovë mungojnë elementet e pajisjet matëse, teksa tha se si proces nuk implementohet sipas standarde evropiane.

“Në UBT punojnë mbi 200 doktorë shkencë të cilët mund të ndihmojnë dhe japin konkluzione për planifikimin urban dhe hartimin e strategjive edukate”, ka thënë Hajrizi, duke treguar se ka kuadro që gjenerojnë dije por mungojnë trupat e certifikimit, që bëjnë certifikimin e personave për energji, ambient etj.

Duke folur për faktorët që ndikojnë në cilësinë e ajrit, ligjëruesja në UBT, Pranvera Dobruna – Kryeziu theksoi se energjia është ndotësi kryesor i ajrit në Kosovë.

Ajo tha se duhet të aplikohen politika pro aktive, në mënyrë që të ketë përmirësim në cilësi të ajrit.

“Kosova e Re është politikë që në masë të madhe do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Të gjitha

aktivitetet që zhvillohen gjithnjë shkojnë për përmirësimin e gjendjes, përfshirë edhe aktivitetet e UBT-së, ku si institucion do të jetë aktive me konferenca dhe forume ku marrin pjesë ekspertë të fushave përkatëse”, tha ajo.

Po ashtu, Urim Xharavina, nga organizata për mbrojtjen e mjedisit “Let's do it Peja”, tha se një nga ndotësit kryesor janë mbetjet industriale. Ai tha se pothuajse e gjithë Kosova përballet me cilësi të ulët të ajrit.

“Dispozitat ligjore nuk po zbatohen pothuajse fare, por edhe pjesët tjera të Kosovës po përballen me problematika të njëjta. Kemi rastin e Obiliqit dhe të Fushë Kosovës. Megjithatë, vlen të theksohet se edhe mbetjet industriale konsiderohet se ndotin ajrin”, ka thënë ai.

Të pranishmit në këtë forum, e që ishin ekspertë të fushës njëherësh ligjërues në UBT, njëzëri vlerësuan se vendi duhet të ketë matje konstante të cilësisë ajrit dhe në mënyrë specifike të identifikohen ndotësit më të mëdhenj, teksa u tha se këto procese të implementohen me praktika botërore. Po ashtu, ekspertët e fushës kërkuan që politik bërësit të kenë bashkëpunim me palët e interesit në mënyrë që të rishqyrtohen strategjitë aktuale.

Sipas matjeve të ditëve të fundit të Ambasadës amerikane, Prishtina ka ajër të pashëndetshëm, ku kuota e ndotjes së ajrit kishte arritur në 199.

Masat e ndërmarrja nga Komuna e Prishtinës, fillimisht ishte ndalja e lëvizjes së veturave në unazën e qendrës së Prishtinës.

## Në UBT diskutohet për miratimin e Projektligjit për Energji Eficiente

Në UBT është mbajtur konferenca në të cilën është diskutuar rreth projektligjit për energjinë efiçente, proces i cili është edhe kriter për integrimin e Kosovës në BE.

Si rezultat i kësaj, rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi ka thënë se energjia është temë e rëndësishme për vendin, andaj sipas tij, duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë dhe se duhet të përcjellën trendet e shteteve në zhvillim për implementim të suksesshëm të ligjeve që hartohen.

“UBT ka edhe Fakultetin për Energji Eficiente, në të cilën trajtohen tematika të ndryshme rreth kësaj fushe. Forumi është një koment ku ne reflektojmë nga përvojën tona, nga studimet tona. Kemi strategji të shumta, kemi zhvillime dhe projekte interesante, por kemi edhe shumë për të bërë përfundim. Ligji është në zhvillim, këtë ligj do ta trajtojmë si çështje”, ka thënë rektori Hajrizi, duke shtuar se si temë ka lidhje me tematikat e integritimit evropiane.

Në këtë konferencë i pranishëm ishte edhe këshilltari në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Halit Hoxhaj, ku tha se

si projektligj ka qenë në plan të kalojë qysh në tetorin e vitit të kaluar, por se nga raportet është konstatuar se ka mungesë të resurseve humane.

“Të gjitha komunat duhet të kenë zyre komunale për efiçencë dhe se duhet të ketë auditor të certifikuar, e mbi të gjitha sektori provat duhet të ketë konsulent të prezantojnë projekte e të përfitojnë fonde që ofrohen nga sektori”, ka thënë Hoxhaj, duke treguar se Korniza ligjore e menaxhimit të financave është konsultative. Të gjithë donatorët kanë kërkuar një institucion që është jashtë kornizave.

Ligjëruesja në UBT, Pranvera Dobruna ka theksuar se projektligji në fjalë është i kompletuar dhe se veç tjerash, ofron edhe shumë vende të reja të punës.

“Shumë studentë ose kuadro do të përgatiten profesionalisht sepse ky proces do të ofrojë shumë vende të reja të punës. Është një ligj mjaft komplet dhe mjaft mirë i ka adresuar të gjitha çështjet”, tha ajo.

Ligji për Efiçencë të Energjisë, rregullon dhe përgatit



aprovimin e planeve për efiçencë dhe masat e energjisë, njëherësh edhe obligimet e sektorit publik, si dhe themelimin e institucioneve përkatëse për implementimin e masave e efiçencës së energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit, nëpërmjet stimulimit të reduktimit të konsumit të energjisë.

Për personalitete që kanë dhënë kontribut të çmuar në nivel akademik.

## Në UBT u mbajt ceremonia për shpërblimin e personaliteteve nga Presidenti Trump

Në një ceremoni madhështore të mbajtur në UBT dhe në praninë e dhjetëra akademikëve e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore, është bërë ndarja e çmimeve dhe mirënjohjeve për personalitete të shumta, në mesin e të cilëve edhe për disa profesorë të UBT-së, të cilët kanë dhënë kontribut në forma e fusha të ndryshme, për përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës dhe për zgjidhjen e problemeve me të cilët ata po përballen.

Në këtë ceremoni, nga Complutense University i Madridit dhe nga Akademia Ndërkombëtare e Shkencave Sociale, nga Palm Beach University në Florida, janë ndarë mirënjohje dhe çmime për personalitete që kanë dhënë kontribut të çmuar në nivel akademik.

Titulli "Akademik Nderi" është dhënë nga Akademia e Shkencave Sociale, ndërkaq ai "Profesor Nderi" është dhënë nga Complutense University i Madridit.

Këto çmime prestigjioze u janë ndarë rekorit të UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizit dhe akademikëve, Ilir Deda, Besnik Tahiri e Arben Sylejmani.

Për kontributin e saj të madh në sferën e mbrojtjes së të

drejtave dhe lirive të njeriut dhe për vetëdijësimin e qytetarëve dhe institucioneve për probleme të shumta sociale, nga presidenti i SHBA-ve, Donald Trump, është shpërblyer me mirënjohje gazetarja shumëvjeçare, Ramize Murtezi – Shala.

Mirënjohjen për të, në emër të SHBA-ve, e ndau anëtari i Akademisë Ndërkombëtare, prof. dr Otto Fleingenblatt, i cili e vlerësoi kontributin e secilit personalitet që në forma të ndryshme ka ndihmuar në ngritjen e njohurive dhe të vetëdijës së qytetarëve për çështje jo shumë të trajtuara.


"Nuk ka asgjë më të mirë dhe më të kënaqshme sesa të nderosh ata të cilët punojnë me pasion për temat të cilat njerëzit nuk do të donin as t'i diskutonin", u shpreh



Fleingenblatt, duke shtuar se pikërisht këta njerëz janë zëri dhe shpëtimi i Kosovës.

Kjo është hera e dytë që ndahen tituj nderi nga universitetet e njohura ndërkombëtare dhe nga Akademia Ndërkombëtare e Shkencave, ndërkaq hera e parë që UBT është nikoqire e një ngjarjeje të tillë kaq të rëndësishme.

## UBT Cisco Networking Academy nderohet nga Cisco Networking Academy për 5 vite kontribut



Kontributi i UBT-së në zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë, tash e shumë vite po njihet edhe në rrafshin ndërkombëtar dhe i njëjti po vlerësohet lart edhe nga institucione e organizata ndërkombëtare.

Këtë vit, UBT Cisco Networking Academy i ka bërë pesë vite pjesëmarrje aktive dhe shërbim në programin e, program ndërkombëtar për ndërtimin e aftësive në IT dhe në ndërtim të karrierës.

Për kontributin e madh të dhënë përgjatë këtyre viteve, nga ky program, UBT Cisco Networking Academy ka pranuar një certifikatë që njihet si Certifikata e Njohjes së Shërbimit të Akademisë Cisco, për të cilën, sipas udhëheqësve,

janë përkushtuar studentët, instruktorët dhe pjesëmarrësit e tjerë, për ta shndërruar këtë në program primar të arsimit për zhvillimin dhe ofrimin e zgjidhjeve të problemeve globale. Nga shkollat e mesme, universitetet e deri tek organizatat e komunitetit, janë mbledhur më shumë se 9000 institucione nga 170 vende të botës, që e ofrojnë programin e Networking Academy dhe së bashku po ndërtohet fuqia punëtore e së ardhmes.

Që nga viti 1997, më shumë se 5.5 milionë njerëz nga e gjithë bota i janë bashkuar kësaj akademie, për t'u bërë pjesë e forcës për ndryshimin e ekonomisë globale.

## UBT dhe Dukagjini i ndajnë mirënjohje Ramiz Kelmendit

Në kuadër të shumë aktiviteteve që po shënohen për nder të 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, Kolegji Dukagjini, i cili muaj më parë i është bashkuar UBT-së, i ka ndarë mirënjohje themeluesit të kompanisë "Elkos Group – ETC", Ramiz Kelmendit.

Kelmendi është nderuar për kontributin dhe mbështetjen e dhënë për studentët, përmes dhurimit të bursave për ta.

Gjatë kësaj ceremonie, biznesmeni kosovar, Ramiz Kelmendi, ka falënderuar institucionin për vlerësimin, teksa mbajti edhe një fjalim motivues për studentët.


Ai tha se gjeneratat e reja duhet të përkrahen në çdo aspekt, me qëllim të realizimit të qëllimeve të tyre.

"Studentët duhet të jenë të motivuar për studime, punë, përkushtim dhe realizim të të gjitha ambicieve sepse kështu kontribuojnë për shtetin e Kosovës, përkatësisht vendin e tyre", vlerësoi Kelmendi.

Zgjerimi i UBT-së në rrafshin vendor e ndërkombëtar, së fundmi, të rinjtë e Pejës dhe në përgjithësi, të rajonit të Dukagjinit, do të kenë mundësi të vijnë studimet në kolegjin Dukagjini, i cili tashmë është bashkuar me UBT-në.



## UBT, i vetmi institucion privat i arsimit të lartë në Kosovë, anëtar me të drejta të plota në CEEPUS



Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, mori pjesë në mbledhjen e fundit të bordit të CEEPUS, që u mbajt në Vjenë të Austrisë.

Nga ky takim u krijuan mundësi të reja për bursa dhe për organizim të konferencave të përbashkëta ndërkombëtare, me pjesëmarrje të madhe të stafit akademik, që mbi të gjitha, në fokus do të ketë promovimin e Kosovës.

Me rastin e pjesëmarrjes në këtë mbledhje, Hajrizi tha se çështja e ndërkombëtarizimit të Kosovës, sidomos në fushën e arsimit, është jetik në një moment të tillë, marrë për bazë sfidat nëpër të cilat momentalisht po kalon arsimit i lartë në vend.

"Ndërkombëtarizimi është një rrugë e gjatë, megjithatë ne po arrijmë që përmes UBT-së ta mbajmë Kosovën më afër këtyre rrjedhave, e tërë kjo falë marrëveshjeve dhe anëtarësimeve të institucionit tonë nëpër organizata të rëndësishme botërore", vlerësoi Hajrizi.

UBT është i vetmi institucion privat i arsimit të lartë në Kosovë, që është anëtar me të drejta të plota në programin CEEPUS.

Fotoreportazh

# UBT, zgjedhja e parë e maturantëve kosovarë



Qindra maturantë po ia mësojnë kampuseve të UBT-së gjatë ditëve të fundit, për të parë nivelin e studimeve, mundësitë për studim e punësim dhe infrastrukturën të cilën e posedon institucioni.

Sikurse edhe në vitet paraprake, UBT po vazhdon të mbetet zgjedhja e parë që të rinjtë po e bëjnë, me qëllim të zhvillimit akademik e profesional. E ky interesim qysh moti i ka kaluar kufijtë shtetërorë dhe shkollimin e zhvillimin e tyre po ia besojnë UBT-së edhe qindra të rinj nga mbarë trojet shqiptare, të cilët në mënyrë të organizuar po vijnë për të vizituar objektet dhe për t'u njohur me stafin akademik të UBT-së, nga të cilët pas pak muajsh synojnë të marrin mësimet teorike e praktike.

Edhe përkundër infrastrukturës moderne e të sofistikuar dhe atmosferës studentore që e ofron, maturantët e shumtë po zgjedhin UBT-në për shkak të suksesit të studentëve të mëherëshëm e këtyre aktualë, të cilët po shërbejnë si frymëzim që ata të zgjedhin një profesion, që nesër, me ndihmën e UBT-së, edhe ata të qasen me shumë lehtësi në tregun e punës dhe të bëhen më të mirët në profesionin e tyre të zgjedhur.

Vendimet e tyre edhe më shumë po i lehtëson Qendra e Karrierës e UBT-së, e cila në mënyrë të vazhdueshme po ofron këshillim dhe po u ndihmon të rinjve në bërjen e zgjedhjes së duhur përgjatë gjetjes së profesionit të tyre.

UBT ofron drejtimet dhe specializimet që po zhvillohen në të njëjtin hap me atë se çka po kërkohet e zhvillohet më së

tepërmi globalisht, çka edhe po i shtynë të rinjtë drejt fillimit të studimeve në UBT.

Programet e akredituara dhe në të cilat maturantët mund të studiojnë janë:

Shkenca kompjuterike dhe Inxhinieri, Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Mekatronikë dhe Menaxhment, Sistemit e Informacionit dhe Menaxhment, Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, Inxhinieri Ndërtimore dhe Infrastrukturë, Shkenca Politike, Juridik, Media dhe Komunikim, Politika Publike dhe Menaxhment, Inxhinieri e Energjisë, Inxhinieri e Energjisë Efiçiente, Infermieri, Farmaci, Stomatologji, Dizajn i Integruar dhe Shkenca të Ushqimit e Bioteknologji.







Për personalitete që kanë dhënë kontribut të çmuar në nivel akademik.

## Rektori Hajrizi mori pjesë në tryezën

### “Integrimi i pjesshëm apo i tërësishëm i Ballkanit Perëndimor në BE”

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, mori pjesë në tryezën më temë: “Integrimi i pjesshëm apo i tërësishëm i Ballkanit Perëndimor në BE”, organizuar nga Fakulteti Filozofik i Universitetit të Prishtinës, për rastin e 9 Majit, Ditës së Evropës.

Hajrizi tha se është përgjegjësi e secilit institucion arsimor që të jap kontribut në procesin e integritit të vendit në BE.

E prej themelimit e deri më sot, siç potencoi Hajrizi, UBT ka dhënë shumë përmes anëtarësimit në organizata të mëdha ndërkombëtare.

“E ardhmja jonë në Evropë dhe e ardhmja e Bashkimit

Evropian, ndërtohet nga arsimit.

Për Kosovën investimi në arsim krijon vende pune, ndihmon në promovimin e drejtësisë shoqërore dhe në adresimin e sfidave ndaj demokracisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Të gjitha këto do ta sjellin vendin më afër BE-së dhe do të bëjnë që anëtarësimi ynë të shihet si një mundësi dhe jo si barrë”, konstatoi ai.

Në këtë organizim morën pjesë edhe një varg personalitetesh të tjera të Kosovës, të cilët diskutuan për sfidat e së ardhmes drejt integritit, kushtet që duhen plotësuar dhe për ndikimin e arsimit dhe rinisë në këtë proces me rëndësi jetike për vendin.



## Projekti i studentëve kosovarë do të prezantohet në Shangai të Kinës



Studentët e UBT-së, Taulant Mehmeti, Muhamed Retkoceri dhe Hakan Shehu, nën mentorimin e ligjëruesit në UBT, Artan Salihu, janë përzgjedhur në mesin e dhjetë finalistëve në garën “Watson Analytics Global Competition”.

Kjo garë kishte për qëllim krijimin e zgjidhjeve inovative dhe analitike, duke përdorur teknikat më të reja dhe platformat inteligjente. Projekti me temë: “Roli i kultivimit të blegtorisë në ndryshimet klimatike globale”, i studentëve të UBT-së, do të prezantohet në konferencën Big Data dhe Analytics – “6th

Annual Big Data and Analytics EdCon”, që këtë vit do të mbahet në Shangai të Kinës.

Në këtë konferencë ata do të prezantojnë të gjeturat dhe përpunimin e të dhënave nga burime të ndryshme. Studentët e UBT-së kanë përdorur teknikat më të fundit nga Data Science dhe AI, për të studiuar trendët dhe ndikimin e kultivimit të bagëtisë në emetimin e gazrave ndotës për ambientin. Në projekt kanë bërë krahasimin e ndikimit të këtij sektori me sektorët tjerë, si: energjia dhe transporti.

Për arritjen e këtij projekti në finale të kësaj gare, përkrahje dhe kontribut të madh kanë dhënë edhe rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi dhe dr. Murthy Rallapalli.

## UBT krijon kushte për punë praktike për studentët e Fakultetit të Shkencave të Ushqimit

Në Kampusin Inovativ të UBT-së, në Lipjan, janë duke u përfunduar punimet për realizimin e projektit: “Ngritja e fushës eksperimentale kërkimore-shkencore me kultura bujqësore si produkte ushqimore me bazë bimore”, në kuadër të së cilës janë krijuar fusha eksperimentale me kultura bujqësore.

Falë realizimit të këtij projekti, studentët e Fakultetit Shkencat e Ushqimit në UBT, krahas pjesës teorike, ata do të kenë mundësinë që të vijnë edhe punën praktike.

Ky projekt është ideuar me qëllim të krijimit të kushteve për punë praktike për studentët e Fakultetit Shkencat e Ushqimit në UBT.

Koordinatori i projektit, prof. dr Nexhat Balaj, ka bërë të ditur se këto parcela tashmë janë mbjellë fusha eksperimentale me grurë, misër dhe disa variete të pemëve, si: molla, dardha etj.

“Fushat eksperimentale do të mbjellën me produkte bujqësore, produkte të cilat më pas do të përdoren në laborator për eksperimente studimore. Në këto parcela studentët do të kenë mundësinë që të shohin si rriten dhe zhvillohen shumë produkte bujqësore”, ka thënë Balaj.

Sipas tij, në proces është edhe ndërtimi serrave eksperimentale që njihen si laboratorë të gjelbër, ku do mundësojnë realizimin e hulumtimeve shkencore.



## Përfaqësuesit e “Sigal Uniqa Group Austria” bashkëbisedojnë me studentët e UBT-së për tregun e sigurimeve



Përfaqësuesit e kompanisë së sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria”, konkretisht themeluesi i saj, Avni Ponari dhe drejtori ekzekutiv, Mal Berisha, kanë bashkëbiseduar me stafin dhe studentët e UBT-së, gjatë tryezës së diskutimit të titulluar: “Historiku dhe potenciali i sigurimeve”.

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, tha se shtimi i njohurive mbi industrinë e sigurimeve është tejet e rëndësishme, pasi në këtë formë njerëzit arrijnë të vetëdijesohen për tregun dhe vlerën e sigurimeve, ndërkaq studentët mësojnë se sa e gjerë është kjo industri dhe se sa ka kapacitet për

të krijuar vende të reja pune.

“Mesazhin e kemi dhënë që ka vende pune dhe ne e kemi marrë përgjegjësinë që të përgatim kuadro që do të bëhen pjesë e kompanive të sigurimeve dhe kompanive të tjera”, theksoi Hajrizi.

Fjalimi i themeluesit të Sigal Uniqa Group Austria, Avni Ponari, u fokusua tek niveli i zhvillimit të kësaj industrie në Kosovë, tek rëndësia e të siguruarit të jetës dhe mjeteve, si dhe tek historiku i lindjes së sigurimeve financiare.

Ponari tha se pesha e sigurimeve financiare është një proces që nuk duhet të evitohet, pasi bota dhe njerëzit përballen në baza ditore me fatkeqësi të shumta, për rikuperimin e të cilave nevojiten të shumta të konsiderueshme parash.

“Nuk ekziston asgjë në botë që është jashtë sigurimeve sepse bota është e ndërtuar në mënyrë të tillë dhe ata që kanë krijuar mjete materiale janë të interesuar t’i mbrojnë. Gjithçka që është krijuar nga njeriu është e siguruar dhe duhet të jetë e siguruar”, konstatoi ai, teksa tregoi se e njëjta

nuk mund të vlejë edhe për Kosovën.

“Në Kosovë çështja e sigurimeve është shumë pak e realizuar. Shumica dërrmuese e kosovarëve nuk e kanë të siguruar as jetën e as shtëpitë. Kosovarët sigurojnë vetëm makinat, pasi janë të obliguar me ligj”.

Tregu aktual i sigurimeve në Kosovë arrin shifrën 81 milionë euro, teksa densiteti i sigurimeve është 44 euro për frymë, e kjo shifër e ulët në krahasim me numrin e banorëve, sipas Ponarit, rrjedh nga disa faktorë.

“Mungesa e kulturës, varfëria, papunësia dhe mungesa e ekspertëve të sigurimeve, janë vetëm disa nga shkaqet që ndikojnë në numrin e ulët të njerëzve që kanë sigurime”, potencoi ai.

Drejtori ekzekutiv i “Sigal Uniqa Group Austria”, Mal Berisha, i motivoi studentët, duke i shtyrë ata të aplikojnë për punë në kompaninë që ai e udhëheq, por që, sipas tij, paraprakisht duhet të mësojnë dhe të guxojnë të provojnë gjëra të reja.

Kompania “Sigal Uniqa Group Austria” është themeluar në vitin 1999, ndërkaq në Kosovë që prej vitit 2002 udhëheq tregun me 30%.

Para gati 20 vitesh, kjo kompani kishte nisur punën me 5 punëtorë, kurse sot numëron 1195 punonjës dhe agentë.

Konferenca “Liria e Shprehjes së Mediave në Kosovë”

## Në Ditën Botërore të Lirisë së Shtypit, gazetarët kosovarë nuk janë plotësisht të lirë



**Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, tha se Kosova ka shumë punë për të bërë që gazetarët të fillojnë të frymojnë lirshëm gjatë ushtrimit të profesionit të tyre dhe në këtë ndikim kanë edhe qarqet akademike, pasi, sipas tij, vetëm në këtë formë arrihet edukimi i masave dhe rritja e nivelit të demokracisë në vend**

Mediat në Kosovë konsiderohet se kanë liri të pjesshme dhe gazetarët jo rrallë herë kërcënohen për shprehjen e tyre të lirë, gjë që e pamundëson ushtrimin pa presione të profesionit.

Kjo u tha në konferencën “Liria e Shprehjes së Mediave në Kosovë”, të organizuar nga Instituti i Mediave i Kosovës dhe UBT, për nder të Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit.

Kosovën më mirë nuk e paraqesin as raportet ndërkombëtare mbi lirinë e shprehjes, të nxjerra nga organizata “Freedom House” dhe “Reporterët pa kufij”, sipas të cilave, shteti ynë renditet në mesin e vendeve me liri të pjesshme të shprehjes, përkatësisht zë vendin e 78-të.

Për këtë renditje, analistët, gazetarët dhe profesorët që morën pjesë në konferencë, gjetën dhe numëruan disa arsye. Sipas tyre, mediat vuajnë nga ndikimet direkte dhe indirekte politike, presioni financiar, varësia nga pronarët dhe kërcënimet e sulmet ndaj gazetarëve kritikues e hulmues ndaj pushteteve dhe njerëzve e rrjetëve të fuqishme.

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, tha se Kosova ka shumë punë për të bërë që gazetarët të fillojnë të frymojnë lirshëm gjatë ushtrimit të profesionit të tyre dhe në këtë ndikim kanë edhe qarqet akademike, pasi, sipas tij, vetëm në këtë formë arrihet edukimi i masave dhe rritja e nivelit të demokracisë në vend.

“Bota po ndryshon me ritme të shpejta dhe sot është zvogëluar hapësira për gjetjen e një vendi të punës, por mbi të gjitha po hasen vështirësi në përshtatje me revolucionin e konvergencës që po ndodh sot në botë dhe që po bën që secili prej nesh të jemi gazetarë”, tha Hajrizi.

Ai tregoi se UBT tash e pesë vite, përmes Fakultetit Media dhe Komunikim, po krijon gjenerata që po i përshtaten këtij trendi kohor, që sjellin vlera dhe informacione të reja teknologjike, duke shndërruar kështu në profesionistë që shumë lehtë po e gjejnë veten në tregun e punës.

Kryetari i Bordit të Institutit të Medias të Kosovës, Fazli

Veliu, bëri një përmbledhje të raporteve vendore e ndërkombëtare të organizatave të ndryshme, mbi gjendjen e të bërit gazetar në Kosovë, nga të cilat del se gazetarët dhe gazetaria gjenden në pozitë të favorshme.

“Nuk ka ambient të favorshëm për ushtrimin e gazetarisë, nuk ka siguri për gazetarë hulmues e kredibilë. Vetëm gjatë vitit të kaluar janë sulmuar 27 gazetarë për bindjet dhe shprehjen e tyre të lirë, e kjo gjendje duhet ta shqetësojë secilin prej nesh”, vlerësoi ai.

Veliu si shqetësim e paraqiti edhe nivelin e ulët të besueshmërisë dhe shpërndarjen e lajmeve të rrejshme nga mediat kosovare, sidomos nga portalet, ndonëse qytetarët lajmin e parë mbi një ngjarje e marrin prej tyre.

Vend për përmirësim në këtë fushë sheh edhe zëdhënësjja e Qeverisë së Kosovës, Donjeta Gashi, sipas të cilës, qeveria aktuale po mundohet të jetë më transparente dhe më bashkëpunuese me gazetarë dhe media.

“Gjatë këtij viti, konsideroj se ne kemi arritur që të përgjigjemi në telefonatat dhe mesazhet e gazetarëve në mbi 95% të rasteve, gjë që tregon se ne po mundohemi të krijojmë një qasje më ndryshe me mediat”, sqaroi ajo.

Sipas saj, Qeveria nuk është kursyer as në krijimin e qasjes në dokumente zyrtare, me ç’rast, sipas saj, nga 27 kërkesa, 26 prej tyre kanë marrë konfirmim të plotë.

Anëtari i Bordit në Institutin e Medias të Kosovës, Nexhmedin Spahiu, potencoi se nuk mund të ketë shoqëri dhe shtet demokratik, pa pasur liri të shprehjes paraprakisht.

“Nuk mund të krijohet një shoqëri e lirë pa media të lira, por megjithatë, jo gjithmonë mediat janë në funksion të demokracisë sepse pushteti shpesh arrin që përmes parave t’i ndalojë dhe kështu mediat e mira e humbin funksionin për të cilin janë krijuar”, konstatoi Spahiu.

Ish-kryetari i KPM-së, njëherësh ligjërues në UBT, Adnan Merovci, tha se liria e shprehjes ka ekzistuar dhe do të ekzistojë gjithmonë, por paralel me të do të ekzistojë edhe

tendenca për ta shuar atë.

“Tendenca për t’i bërë gazetarët ka qenë gjithmonë, por legjislacionet dhe mbi të gjitha instancat më të larta për mbrojtjen e fjalës së lirë, siç është Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, e mbrojnë shprehjen e lirë të tyre”, sqaroi Merovci, sipas të cilit, mediat nuk duhet t’i harrojnë edhe dy obligimet për të cilat themelohen, e që janë mirëinformimi dhe krijimi i hapësirës për t’u shprehur.

Politologu dhe ligjëruesi në UBT, Belul Beqaj, vuri në fokus rolin e mediave në degradimin e analizave politike, si reflektuese dhe shoqëruese të ideve të shoqërisë.

“Për të mos kaluar në banalizim dhe degradim të mëtutjeshëm të analizave në Kosovë, ato duhet të jenë të ndërtuara nga informatat të cilat merren nga burimi i drejtpërdrejtë, informatat duhet të jenë objektive për zgjidhjen e problemit dhe ato janë më të besueshme kur vijnë nga burime të paangazhuara politikisht, informata e ekspertëve është më e vlefshme, gjithmonë përderisa nuk është e varur nga politika dhe politikanët”, vlerësoi Beqaj.

Dekani i Fakultetit Media dhe Komunikim, në UBT, prof. dr Ferid Selimi, pjesën më të madhe të fjalimit të tij ia dedikoi gazetarëve të ardhshëm, të cilët i këshilloi që të mësojnë në mënyrën e duhur zanatin për të cilin po shkollohen.

“Lexoni gjithçka që ka të bëjë me mediat dhe shoqërinë, përcillni raportet e punës së institucioneve lokale, rajonale, kombëtare e ndërkombëtare, mësojeni zanatin e të ndjekurit të ngjarjeve, mësojeni zanatin e të pyeturit, mësojeni zanatin e të shkruarit. E kur të zotëroni këto tre zanate, jeni rrugës së mirë për t’u bërë gazetarë të mirë”, tha ai.

Diskutimin mbi lirinë e shprehjes, besueshmërinë e mediave dhe mënyrat e rrugët që çojnë në përmirësimin e kësaj gjendjeje, e pasuruan edhe më shumë gazetarët e analistët shumëvjeçarë të Kosovës dhe studentët e Medias e Komunikimit në UBT, të cilët morën pjesë në këto konferencë.

## Studentët e Medias dhe Komunikimit vizituan Bashkinë e Tiranës dhe televizionin “Ora News”



Studentët e vitit të parë dhe të dytë të Fakultetit Media dhe Komunikim, gjatë një vizite në Shqipëri, vizituan Bashkinë e Tiranës dhe televizionin Ora News.

Gjatë vizitës në Bashki, studentët janë pritur nga kryetari i saj, Erion Veliaj. i cili i motivoi studentët, duke u thënë se ata kanë zgjedhur profesionin e duhur.

Përveç kësaj, studentët patën rastin edhe t’i parashtronin pyetje dhe të bashkëbisedonin rreth raportit media-politikë dhe rreth zhvillimeve të fundit në Bashkinë e Tiranës.

Vizita e dytë u zhvillua në televizionin Ora News, ku u pritën nga administratorja e përgjithshme e këtij mediumi.

Gjatë kësaj vizite studentët u njoftuan me organizimin e këtij televizioni, me funksionimin, skenat e emisioneve, si dhe me ambientet dhe pajisjet moderne të punës.

Në kuadër të vizitave studentore, UBT po vazhdon të organizojë vizita nëpër institucione të ndryshme, me qëllim të vetëdijesimit të studentëve me mënyrën e punës dhe për rëndësinë e profesionit të tyre.

## Hulumtim

# Të rinjtë dhe shikueshmëria e besueshmëria e televizioneve në Kosovë

Ferid Selimi



Televizionet kombëtare dhe ato private në Kosovë i japin rëndësi të veçantë programit informativ për një qëllim, që të rrisin shikueshmërinë dhe besueshmërinë e programeve transmetuese. Ky punim mat shikueshmërinë dhe besueshmërinë e programit informativ të disa televizioneve në Kosovë. Për të bërë këtë hulumtim është përdorur metoda e anketës, ku në 25 pyetje janë përgjigjur të rinjtë kosovarë me përkatësi kombëtare shqiptare të moshës 19 deri 28 vjeçare.

Nga kjo anketë u pa që ka një larushi të përcjelljes së Televizioneve kombëtare dhe atyre private e komerciale. Nga përgjigjet është gjetur që një përqindje e madhe e të rinjve përcjellin programin informativ në televizione të ndryshme, e emisionet që më së shumti i përcjellin janë lajmet, reportazhet, intervistat e dokumentarët.

Informimi nga mediat elektronike, e sidomos nga ato pamore është i një rëndësie të veçantë, meqë është informim që pos fjalëve jep zë dhe pamje. Kur bashkohen fjalët, zëri dhe pamja, informimi është më i kapshëm për audiencën. Por, për të parë se sa përcillen programet informative të televizioneve në Kosovë nga të rinjtë e moshës nga 19-28 vjet, është bërë një anketë me 208 respondentë të këtyre moshave të të dy gjinive të përkatësisë shqiptare nga gjashtë rajonet në Kosovë.

Televizioni që pretendohej të jetë një nga mediumet prej nga merren informacione më të freskëta dhe prej nga publiku kosovar informohet më shpejt e më drejt, duket ta ketë humbur primatin që kishte. Mediat e tjera online kanë nis ngadalë të zënë vendin e tij. Kjo shihet në këtë punim, që ka dalë si rezultat i një ankete të zhvilluar me 208 respondentë nga gjashtë qendrat e Republikës së Kosovës: Prishtinë, Gjilan, Prizren, Ferizaj, Pejë, e Mitrovicë.

Këta respondentë për kah profesioni janë heterogjen. Ka prej tyre që janë studentë dhe ka prej tyre që nuk janë studentë. Prandaj edhe interesimi dhe pikëpamjet e tyre për programet informative të televizioneve që transmetojnë program në Kosovë dallojnë nga njëri-tjetri.

Në këtë punim është trajtuar përcjellja e programeve informative nga të rinjtë e moshës 19-28 për një arsye të thjeshtë: Për të parë se sa prej tyre informohen dhe sa prej tyre përcjellin këto programe televizive. Gjithnjë duke pasur parasysh që teknologjia ka përparuar, dhe kur thuaja secili i ri ka një celular të mençur në xhep dhe ka mundësinë e informimit nëpërmjet rrjeteve sociale e të

shënimeve të tjera që i nxjerrin nga interneti, duke shfrytëzuar celularin.

Nga ky studim dalin të dhëna të reja e të larmishme, sepse nëpërmjet anketave me respondentë të këtyre moshave, në pyetjet se a kanë televizorë, sa televizorë kanë në shtëpi a banesë a janë televizorët e lidhur nëpërmjet kabllorit, IPTV-së, me antenë satelitore apo me mundësi të përcjelljes nëpërmjet tokësorit, a janë analogë apo digjitalë, sa kohë kalojnë duke shikuar televizor, etj.. janë dhënë përgjigje interesante dhe të larmishme. Në pyetësor, respondentët kanë pasur mundësi të përgjigjen në 25 pyetje...

Pjesa tjetër e anketës ka të bëjë me përzgjedhjen dhe përcjelljen e programeve informative nga ta. Nga 208 respondentë, 64% të tyre ishin meshkuj; 36% femra; 19% ishin të moshës 19 vjeçare; 14.9% 20 vjet; 11% 22 vjeçare, 10% 21 vjeçare; 8.4% 23; dhe 7% 24 vjet; përqindja tjetër i takon moshës nga 25-28. Kjo nënkupton jo vetëm një diversitet të gjinisë, por edhe të moshës, që më pas përgjigjet dalin edhe më të ndryshme. Kjo është pritur, sepse si gjinia, ashtu edhe moshë dhe vendi prej nga vijnë të rinjtë tregojnë një ndryshueshmëri të mendimeve dhe të gjykimeve rreth programit informativ të televizionit. Kur merret parasysh origjina e të rinjve, e që sipas anketës 46% ishin nga rajoni i Prishtinës; 13.7% nga Gjilani, po aq nga Ferizaj, dhe 26% nga rajonet e tjera, përgjigjet janë shumë interesante. Vlen për t'u përmendur që 61.5% e respondentëve kanë nga një televizor në shtëpi, ndërsa 29.8% dy televizorë; e 8.7% kishin më tepër televizorë. Kjo lë të kuptohet, që një pjesë e tyre prej rreth 37% kanë mundësinë e përzgjedhjes së kanalit televiziv, kundrejt 61% që janë të detyruar të shikojnë çfarë shikojnë edhe anëtarët e tjerë të familjes. Pjesa dërrmuese e tyre (85.3%) kanë mundësinë e përcjelljes së programeve televizive nëpërmjet rrjetit digjital. 75.1% ishin të lidhur me TV kabllor ndërsa me televizorë analog ishin 11.3%; digjital, kundrejt 15.6% të lidhur nëpërmjet IPTV satelitor e 9.3% me lidhje të rrjetit tokësor.

## Të rinjtë dhe programi informativ

Bazuar në anketën e bërë për shikueshmërinë e programit informativ të televizioneve në Kosovë dhe mbi bazën e të dhënave të gjetura për përcjelljen e këtij programi, të rinjtë e moshës nga 19-28 vjeçare, nga përgjigjet e dhëna del të rinjtë e kësaj moshe nuk janë edhe aq të interesuar për përcjelljen e programeve informative të televizioneve. Nga 208 respondentë nga gjashtë qendrat kryesore të Republikës së Kosovës, pjesa dërrmuese e tyre kalojnë më pak se një orë kohë para ekraneve televizive. Kjo tregon interesimin e tyre jo aq të madh për ndjekjen e programit informativ në televizione.

Të rinjtë e moshës 19-28, sipas të dhënave të kësaj ankete shumë pak kalojnë kohë para ekraneve televizive. Madje, edhe pse 99.5% kanë deklaruar që kanë aparate televizive në shtëpi, jo të gjithë të rinjtë e të gjitha këtyre qendrave kalojnë kohë të njëjtë në shikueshmëri të programeve televizive, dhe jo të gjithë i shikojnë të gjitha programet informative. Edhe pse pjesa dërrmuese e respondentëve ishin studentë, që në përqindje janë


73.4%, të dhënat nga anketa dëshmojnë që, ata as kanë shijen e njëjtë të programeve, as ngjasojnë në kohën e kaluar para televizionit, as në përzgjedhjen e programit që e shikojnë, e as në besueshmërinë e lajmeve që dëgjojnë nga televizioni. Kjo nënkupton që në Kosovë, edhe në këtë aspekt ka diversitet shijesh dhe gjykimesh.

Të dhënat, sipas kësaj ankete pasqyrojnë kohën e kaluar para ekraneve televizive të të rinjve kosovarë. Nga 208 respondentë sa iu kanë përgjigjur kësaj ankete, 31.6% shikojnë më pak se një orë televizion; 18.9% e respondentëve kalojnë një orë para ekranit televiziv, pjesa tjetër e respondentëve kalojnë dy deri në tri orë. Gjysma e tyre para ekranit qëndrojnë vetëm kur kanë kohë të lirë, që nënkupton kur nuk kanë me çka të merren. Ndërsa 43% e respondentëve TV shikojnë në orët e mbrëmjes. Kjo e dhënë e fundit pasqyron gjendjen e dhe interesimin e tyre. Në të vërtetë, kjo e dhënë bën të qartë se televizorit i drejtohen kur nuk kanë ndonjë obligim tjetër ose kur ulen a shtrihen të pushojnë në mbrëmje. Pra, sipas këtyre përgjigjeve të respondentëve arsyeja e mos përcjelljes së programeve televizive nuk qëndron te fakti që nuk ka program ose nuk ka përzgjedhje të kanaleve televizive, porse angazhimi ditor nuk i lejon që të ulen e të shikojnë më tepër televizion.

## Përzgjedhja e kanaleve televizive

Për të plotësuar këtë konstatim na ndihmon e dhëna që në Kosovë program televiziv prodhojnë, përkatësisht transmetojnë një numër i madh televizionesh kombëtare, private e komerciale. Prej tyre tri janë televizione kombëtare, edhe atë: Radiotelevizioni i Kosovës, Kohavizion dhe Radiotelevizioni 21, dhe një numër i madh televizionesh të tjerë që janë private a komercial, dhe televizione që me seli janë në qendra të ndryshme të Shqipërisë a të vendeve të rajonit e Evropës, por që publiku kosovar ka mundësinë e përcjelljes së programeve të këtyre televizioneve nëpërmjet IPTV-së, e kabllorit.

Në këtë larushi televizionesh, TV Klan të Shqipërisë e shikojnë 31% e respondentëve të moshës së re; Klan Kosovën 25%, RTV21 15%; KTV-në 13%, e RTK-në e shikojnë vetëm 8% e respondentëve. Që nënkupton: publiku i moshës së re janë më të interesuar për programet e televizioneve private e komerciale se sa të atyre kombëtare. Mirëpo kur bëhet fjalë për përcjelljen e lajmeve në televizionet kombëtare, pas KTV-së, e cila është e para me 59.6%, RTK del e dyta me 44.3% (këtu respondentët kanë pasur mundësinë e përzgjedhjes së më tepër se një kanali televiziv). Duke pasur për bazë këtë përqindje të respondentëve, paraqitet një jo përputhshmëri e përqindjes së përcjellësve të RTK-së, sepse përderisa RTK-në e shikojnë vetëm 8.3%, lajmet e këtij televizioni i përcjellin 44.3% e tyre. E fundit për nga përcjellja e lajmeve mbetet RTV21 me një përqindje prej 24.6%. nga këto të dhëna mund të konstatohet që pavarësisht që dy televizionet e tjera kombëtare (KTV e RTV21) përqipen që shikuesit t'i informojnë sa më saktë, sa më drejt, e sa më objektiv, RTK është burimi kryesor prej nga shikuesit e moshës së re duan të sigurojnë informacionet ditore.



## Përcjellja e emisioneve informative

Në programin informativ të televizioneve kombëtare dhe atyre private e komerciale që shikohen në Republikën e Kosovës bëjnë pjesë: Lajmet, Debatet, Intervistat, Dokumentarët, Kronikat, Reportazhet, Emisionet zbavitëse, Filmat, dhe Sporti. Secili prej këtyre emisioneve kanë kohën e caktuar dhe shikuesit e tyre. Në përgjithësi, ndër më të shikuarat nga këto emisione janë filmat me 52.4%, të pasuara nga lajmet me 37%, që pasohen nga debatet me 35%. Ndërsa, emisionet zbavitëse përcillen nga 29.6% e respondentëve. Intervistat përcillen nga 21.8%; e respondentëve. Dokumentarët nuk janë shumë keq me shikueshmëri kur krahasohen me intervistat, ato kanë fare pak dallim në mes veti, sepse këto emisione përcillen nga 21.4% respondentë. Sportin përcillet nga 17%; Reportazhet me 7.3%; e Kronikat me 6.8%; në opsionin sa përcillen emisionet tjera, del që 14.6% e respondentëve të jenë përcaktuar për emisione të tjera. Debatet politike përcillen nga më shumë respondentë se sa ato ekonomike e kulturore.

Intervistat me politikanë përcillen më tepër se intervistat me artistë, këngëtarë, e sportistë. Reportazhet rregullisht i përcjellin vetëm 13.7%, ndërsa 19.1% prej tyre nuk i përcjellin fare. 52% e respondentëve përcjellin reportazhe nga vendi e rajoni e Bota, ndërsa vetëm vendore janë përcaktuar 28.9%. Kjo nënkupton që pjesa dërrmuese e respondentëve (sipas shifrave 52%) përcjellin të gjitha llojet e reportazheve ngado që vijnë ato. Sa i përket programit sportiv, sipas të dhënave të grumbulluara nga anketa del që KTV të jetë televizioni kombëtar që i lë hapësirë më të madhe sportit, edhe atë, sipas 193 respondentëve ose 49.7% e tyre thonë që KTV prin për nga hapësira e dhënë sportit. E dyta radhitet RTK me 35.2%, ndërsa RTV21 22.3%. a është e mjaftueshme kjo hapësirë që i jepet programit sportiv, 52.8% e respondentëve mendojnë që kjo hapësirë është e mjaftueshme, kundrejt 47.2% që mendojnë se kjo hapësirë nuk mjafton.

## Cilësia e objektiviteti

Publiku kërkon cilësi para shumësisë së lajmeve. Sipas kësaj, konstatohet që kriteri mbi të cilin mbështeten respondentët për përzgjedhjen e përcjelljes së lajmeve në një televizion të caktuar është kriteri i cilësisë. Të dhënat e mësipërme qartësuan që RTK printe nga televizionet e tjera prej nga të rinjtë e moshës së re duan të merrnin informacionet ditore. Prandaj, cilësia e lajmeve është ajo që prin me 46.8% si arsye e nd-

jekjes së atyre lajmeve në atë televizion. Më pas ndiqet nga kurioziteti i të dëgjuarit të lajmeve të reja, e që arrin shifrën prej 40.9%. Sipas kësaj të dhëne kuptohet që një numër jo i vogël i ndjekësve të lajmeve për objektiv të vetin nuk e kanë cilësinë as objektivitetin e lajmeve, por kuriozitetin. Ata janë kurioz të shohin dhe të dëgjojnë se çfarë në të vërtetë televizioni i caktuar paraqet në edicionin e lajmeve. Objektiviteti është i treti me 21%, edhe pse për nga rëndësia do të ishte ngjitas me cilësinë, dhe e fundit shumësia e lajmeve me 15.1%. nga këto të dhëna paraqitet një jo përputhshmëri e shijeve në mes të cilësisë, objektiviteti dhe kuriozitetit. Përderisa cilësia radhitet si e para, objektiviteti radhitet i treti. Që nënkupton se edhe pse cilësia e lajmeve sipas tyre është në nivel, megjithatë

para objektivitetit të lajmeve, shikuesit parapëlqejnë kuriozitetin. Kur lajmet janë cilësore, atëherë ka objektivitet, sepse cilësia e lajmeve nuk vlerësohet vetëm nga qartësia e pamjeve televizive dhe nga të lexuarit e rrjedhshëm të informatave nga moderatori, por nga objektiviteti i tyre. Porse, nuk duhet anashkaluar edhe kurioziteti si diçka që shikuesi e ndien të nevojshme për ta përcjellë. Megjithatë, këto janë përgjigjet e këtyre respondentëve dhe mbi bazën e këtyre përgjigjeve kanë dalë edhe rezultatet. Përgjigjet e respondentëve tregojnë po ashtu që lajmet e mbrëmjes janë lajmet më të ndjekura dhe prijnë me 72.7%, të pasuara nga Lajmet qendrore me 32.1%. Ndërsa lajmet e mëngjesit mbeten me 7%; të pasuara nga Lajmet e mesditës si më së paku të përcjella me 5.9%.

nga kjo e dhënë kuptohet që në mbrëmje publiku është më i relaksuar dhe ka kohë më tepër për të përcjellë televizion. Prandaj zgjedhin këtë kohë për të dëgjuar përmbledhjen e informacioneve të ditës.

#### Besueshmëria

Pavarësisht që publiku i moshës së re përcjellin lajmet në televizionet kombëtare, prej nga rezultojnë që më së shumti i përcjellin lajmet në RTK, besueshmëria variron. 51.7% e respondentëve vetëm pjesërisht u besojnë lajmeve që dëgjojnë në TV, kundrejt 37.3% e të tjerëve që u besojnë plotësisht lajmeve. Pjesa e përqindjes që mbetet u besojnë pak ose aspak. Kur bëhet fjalë për objektivitetin e lajmeve, 65.1% e respondentëve thonë

që lajmet e mbrëmjes janë më objektive, se të gjitha edicionet e tjera ditore. Ndërsa për 35.4% lajmet qendrore janë më të besueshme. Respondentët pretendojnë që gjatë përcjelljes së lajmeve marrin informacione që nuk i kanë pasur, marrin njohuri të reja, dhe ka nga ta që përcjellja e lajmeve është një kohë e humbur. Kështu, 60.7% thonë që përfitojnë informacione që s'i kanë pasur. 25.4 përfitojnë njohuri të reja, dhe 13.9% e shohin si kohë të humbur përcjelljen e lajmeve.

**Shënim:** Pjesë nga punimi më i gjatë i paraqitur në Konferencën Ndërkombëtare për Gazetari, media dhe Komunikim, Durrës, 27-29 tetor 2017

## Modeli ideal i gazetarisë online, i pandjekur në Kosovë e në rajon

### Safet Zejnullahu

Problemi kryesor i internetit është se njerëzit nuk kanë përqendrim/fokus. Është e dëshmuar edhe shkencërisht: peshku i artë ka më shumë fokus dhe përqendrim se njeriu. Lexuesi mesatar në internet mbetet i koncentruar tetë sekonda, ndërsa peshku i artë nëntë sekonda.

Në këtë situatë, ka disa rregulla të shkrimit, të cilat respektohen në mënyrë që ta mbajmë vëmendjen e lexuesit sa më shumë dhe që ata ta lexojnë porosinë/tekstin tonë. Këtyre rregullave u përmbahen mediat më të mëdha botërore, CNN, BBC, Guardian e të tjera, por edhe njerëzit që shkruajnë porosi të marketingut.

### Rregulli themelor i shkrimit për ueb

Rregullat për shkrimin për ueb u krijuan duke hulumtuar mënyrën se si njerëzit i lexojnë mediat digjitale. Këtë e tregoi një pajisje me emrin “sy-ndjekësi”. Kjo pajisje u vendoset njerëzve në kokë dhe në çdo kohë tregon cilën pjesë të ekranit po e shikon lexuesi. Rezultatet e hulumtimeve shërbyen për caktimin e rregullave të shkrimit për ueb:

Njerëzit nuk i lexojnë tekstet e juaja. I skenojnë ato: Çka do të thotë “skenimi”? Do të thotë se njerëzit e hapin tekstin, e shikojnë titullin, e lexojnë fillimin e tekstit, kalojnë në paragrafin e dytë, shikojnë poshtë te mestitulli i parë, shikojnë majtas dhe djathtas dhe kthehen në fillim. Thënë shkurt, një lexim stihik, sytë shëtisin në të gjitha anët. Pothuaj askush nuk e lexon tekstin me kujdes, rresht për rresht. Kjo ndodh shumë rrallë.

Shiheni si ndodh kjo gjatë një seance me “sy-ndjekësin”: Është e frikshme.

Çka u sillet në kokë njerëzve? Fakti se lexuesit klikojnë mbi tekst, nuk do të thotë se do ta lexojnë krejt atë që e kemi shkruar. Pikë së pari, ata duan të shohin ia vlen ta lexojnë atë tekst, sa kohë ju duhet për ta lexuar dhe a do të jetë ai tekst interesant për ta.

Si e bëjnë këtë? Ashtu që së pari “fluturojnë nëpër gjithë tekstin”. Gjatë këtij “fluturimi” nëpër tekst marrin vendimin nëse do të fillojnë ta lexojnë dhe, më vonë, nëse ne nuk iu kemi përmbajtur rregullave të shkrimit, ata do të ecin tutje. Prandaj, mos filozofoni dhe mos përdorni fjalë këto. Veproni kështu:

E para, gjerësia e tekstit duhet të jetë rreth 80 karaktere. Mundet 70 apo 90, por jo më pak e jo më shumë. Kjo varet nga ueb faqja.

Margjinat majtas dhe djathtas nga teksti duhet të jenë sa paku sa hapësira që zënë dy shkronja të mëdha, ndoshta edhe më shumë. Por, jo më pak se kaq. Nëse teksti kufizohet strikt me vijat anash, njerëzit ndjehen sikur t'i keni futur në një skutë, sikur po i ngufatni, sikur kanë mbetur të bllokuar në ashensor ose në ndonjë shpellë të errët.

Gjatësia e paragrafit është shumë e rëndësishme. Mundohuni që paragrafi juaj të mos jetë më i gjatë se 3-4 rreshta. Herë pas here mund të shkruani ndonjë paragraf më të gjatë, 6-7 rreshta. Me të futni dinamikë në tekst.

Krejt kjo mund të ndikojë që te lexuesit të krijohet përshtypja se “ky tekst është interesant”, kur e skenon me sy dhe njëkohësisht e mban edhe më shumë të lidhur...

Gjithmonë kini parasysh se lexuesit tuaj kanë të hapura edhe

disa faqe të tjera, vazhdimisht u vijnë njoftime të reja në Facebook. Le të jetë përmbajtja e tekstit tuaj ajo që i mban deri në fund të lidhur, pa ikur në faqet e tjera...

Shkruani gjithnjë sipas sistemit të Piramidës së përmbysur (por kjo nuk është sikur te gazetaria klasike).

Piramida e përmbysur është elementi më i rëndësishëm i shkrimit për ueb. Por, kjo nuk është e njëjtë me gazetarinë klasike. Në gazetarinë klasike kemi mësuar se piramida e përmbysur ndërlidhet me përmbajtjen e të gjithë tekstit. Në fillim të tekstit jepen elementet më kryesore dhe, me rrjedhën e tekstit në vazhdim, ka gjithnjë e më shumë gjëra të parëndësishme, përshkrime dhe fakte me më pak interes e vlerë.

E njëjta ndodh edhe te mediat digjitale, por pak më ndryshe. Ky model ka të bëjë me secilin paragraf të tekstit, madje edhe me një fjali të vetme, jo me gjithë tekstin si tërësi. Pse? Të kthehem te eksperimenti i fillimit me “sy-ndjekësin”.

Testet kanë treguar se lexuesit, gjatë skenimit të tekstit, lexojnë fillimin e secilit paragraf. Në bazë të këtij skenimi vendosin a do ta vazhdojnë leximin. Njëjtë i skenojnë edhe mestitujt, fotografitë dhe elementet e tjera dalluese në tekst. Nëse faktet e rëndësishme dhe fjalët kyçe janë diku midis paragrafëve, njerëzit nuk i shohin me rastin e “skenimit” të tekstit. Do të thotë, sa më shumë paragrafë të fillojnë me gjërat kryesore, elemente tërheqëse ose provokime, vëmendja e lexuesit do të jetë shumë më e madhe.

Gjithnjë, gjithnjë, gjithnjë përdorni metodën e “Piramidës së përmbysur” në postimet e juaja në Facebook.

### Sa respektohet ky rregull në mediat online në Kosovë dhe në vendet e rajonit?

Për të parë sa vërtet zbatohet në praktikë ky eksperiment, por edhe elemente të tjera, kemi analizuar një numër portalesh të lajmeve në Kosovë dhe në rajon.

Janë marrë si shembuj 5 portale në Kosovë, nga 2 në Shqipëri e në Maqedoni dhe nga një Kroaci, Bosnje, Mal të Zi e në Serbi.

Për analizë në portalin “koha.net” është marrë teksti: “Bizneset thonë se në Kosovë “nuk ka papunësi” por ka “papunëtorë”, i datës 28 korrik 2017.

Gjerësia e tekstit në këtë portal është gjithmonë më e vogël nga sa preferohet sipas eksperimentit të shpjeguar më herët. Shumica e rreshtave kanë një gjerësi që sillet nga 55-65 karaktere.

#### Shembull:

*Në Kosovë pothuajse për çdo vit, kompanitë private, konkretisht = 63*

*ato në sektorin e bujqësisë, ndërtimtarisë dhe lokalet shërbyese, = 65*

*përballen me problemin e punësimit sezonal të punëtorëve. = 57*

Për margjinat, ky portal është karakteristik, për faktin se në anën e majtë margjina është e përafërt me eksperimentin, rreth dy shkronja të mëdha, porse margjina në anën e djathtë është shumë e madhe, rreth 20 shkronja të vogla.

Portali te të gjitha lajmet pak më të gjata nxjerr një nëntitull

teksti, i cili nuk dallon për nga madhësia e shkronjave, por vetëm është i theksuar me bold. Gjithashtu, nëntitulli nuk mëton të jetë “një përmbledhje e shkurtër teksti”, siç është në median e printuar, por vetëm “fillimi i tekstit i shënuar me bold”.

Gjatësia e paragrafit është përgjithësisht e pranueshme. Teksti i marrë për shqyrtim ka 21 paragrafë, më i vogli 2 rreshta e më i gjeri 7 rreshta.

Teksti është i ilustruar vetëm me një fotografi arkivi në fillim, ndërsa brenda tekstit nuk ka asnjë fotografi tjetër.

Ndonëse teksti është i natyrës së tekstit të gjatë për një media online, në të nuk ka asnjë mestitull.

Në tekst, përveç paragrafit të parë nuk ka asnjë fjali apo fjali të theksuar me bold, ndërkohë që shkronjat janë të madhësisë normale për lexim. Portali nuk e ofron mundësinë teknike për rritjen e shkronjave të tekstit për lexim më të lehtë për ata që kanë vështirësi leximi.

Në gazetarinë klasike kemi mësuar se piramida e përmbysur ndërlidhet me përmbajtjen e të gjithë tekstit. Ky rregull vlen edhe në shkrimet në median online. Por, nuk është i mjaftueshëm për ta tërhequr dhe për ta mbajtur lexuesin deri në fund të tekstit.

Piramidë e përmbysur po, por edhe secili paragraf duhet të ketë brenda vetes elemente të mjaftueshme për të ngjarë në një minipiramidë. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme që secili paragraf të fillojë me gjërat kryesore.

Të shohim si funksion kjo te teksti që kemi në shqyrtim: Teksti në anën teknike, me mungesë mestitujsh dhe ilustrimesh shtesë brenda tij, nuk ofron ndonjë atraksion për lexim. Nga ana profesionale, teksti ka burime të mjaftueshme dhe tekstshkruesi ka bërë një zgjedhje solide të fjalëve me të cilat ka filluar paragrafët e rinj, duke filluar madje disa paragrafë me citate, që mund të thuhet se janë tërheqëse për lexim.

Te portali “gazetaexpress.com”, gjendja është më ndryshe. Gjatësia e rreshtave përgjithësisht i përgjigjet hulumtimit që kemi marrë për bazë për krahasim, me një gjatësi që sillet rreth 80 shenja, më pak ose më shumë, por nuk mbetet nën limitim e poshtëm prej 70 shenjash as nuk e kalon kufirin e përcaktuar si ideal prej 90 shenjash.

#### Shembull:

*Ministria në detyrë e Integritetit në një intervistë për Ekonomia Online thotë se nuk = 84*

*ka parametra vlerësues ose matës se deri në cilin stad është luftuar korrupsioni. = 81*

*Madje ajo thotë se asnjëherë nuk mund të thuhet se korrupsioni është luftuar = 76*

Ky portal ka margjinat standarde në të dy anët e tekstit, që nuk krijon as boshllëk por as ngufatje të tekstit.

Tre rreshtat e parë të tekstit janë shkronja më të mëdha, por ato nuk janë mestitull klasik, por fillim i zakonshëm i tekstit. Teksti gjithashtu nuk ka mestitujt. Si ilustrim është dhënë një fotografi i personazhes së tekstit, në fillim, ndërsa brenda tekstit nuk ka ilustrime të tjera.

Në tekst gjithashtu nuk ka asnjë fjali ose fjali të theksuar me bold ose italik.

Teksti është i ndarë në 15 paragrafë, të cilët përgjithësisht janë të një gjatësie mbi mesataren e preferuar nga eksperienti

menti.

Sa i përket përmbajtjes, teksti lë shumë për të dëshiruar në ndërlidhjen e titullit me përmbajtjen. Në fakt, titulli ka të bëjë me “demarkacionin”, porse fillimi i tekstit nuk ka të bëjë me këtë temë – fokusohet te lufta kundër “korrupsionit”, si një nga kriteret për liberalizimin e vizave. Te portali tjetër i lajmeve “indeksonline.net”, në të shumtën e rasteve, rreshtat standardë janë brenda parametrave të nxjerra nga hulumtimi, rreth 80 shenja në rresht.

#### Shembull:

*Dy emrat më të përfolur për të kandiduar për Kryetar të Kuvendit, Kadri Veseli e = 80*

*Xhavit Haliti, nuk janë emrat e vetëm që mund të përfaqësojnë Kuvendin me së = 76*

miri.

Por, ndërsa margjina në anën e djathtë është sipas standardeve, në anën e majtë të tekstit ka një hapësirë tepër të madhe, e cila, kur bashkohet me hapësirën e ekranit jashtë dizajnit të portalit, krijon boshllëk të dukshëm.

Teksti nuk ka nëntitull e as theksim shkronjash në rreshtat e parë, nuk ka mestituj, ndërsa ka vetëm një fotografi ilustruese në krye të faqes.

Teksti ka gjithsej 21 paragrafë, prej tyre paragrafi më i gjatë ka 7 rreshta, ndërsa më i shkurti 1 rresht.

Teksti ka një shumësi burimesh të cituara, ndërsa edhe çështjet e shtruar në fillim të secilit paragraf janë të ndryshme dhe tërheqëse.

Portali tjetër, “telegafi.com”, është në kufirin e poshtëm të shenjave të preferuara për një rresht, rreth ose, të shumtën e rasteve, nën 70 shenja për një rresht.

#### Shembull:

*Ahmeti tashmë si kryetar i Prishtinës, Arban Abrashi ish-ministër i Punës =74*

*dhe Mirëqenies Sociale, Lirak Çelaj ka qenë zëvendësministër në =63*

*Ministrinë e Drejtësisë, kurse Arbër Vllahu ishte këshilltar i ish- = 68*

Teksti nuk ka një nëntitull standard, por si të shumica e portaleve, paragrafi i parë është me shkronja më të mëdha dhe i shenjuar me bold.

Ka një fotografi të vetme në fillim, ndërsa përgjatë tekstit, në vend të ilustrimeve të tjera, ka dy reklama, njëren pas paragrafit të parë e tjetren pas paragrafit të shtatë.

Nuk ka mestituj e as fjalë ose fjali të shenjuar me bold.

Teksti ka gjithsej 16 paragrafë, më i gjati 4 rreshta e më i shkurti 1 rresht.

Duke iu referuar parimit të minipiramidës, teksti ka paragrafë tërheqës dhe fjalë të para tërheqëse në fillim të paragrafit.

Por, nisur nga parimi se lexuesi është i prirur si fillim të skenohet tekstin me një shikim të shpejtë për të vendosur nëse do ta lexojë apo jo, reklamat që krijojnë hapësira mes paragrafëve duken si dekurajuese për të bërë për vete lexuesin.

Portali “zeri.info”, i ka rreshtat edhe më të shkurtër. Ata, përgjithësisht, kanë 60-65 shenja për një rresht, që është dukshëm më pak se modeli i preferuar sipas hulumtimit që kemi marrë për analizë.

#### Shembull:

*Njohës të rrethanave politike në vend kanë vlerësuar se bllokada = 64*

*institucionale në vend mund të zgjasë deri pas përfundimit të =61*

*zgjedhjeve lokale në vend, e të cilat do të mbahen më 22 tetor të =65*

*këtij viti, shkruan sot, gazeta Zëri.*

Për dallim prej portaleve të tjera, “zeri.info” nxjerr një nëntitull klasik, që mëton përmbledhjen e thekseve kryesore të tekstit, duke e theksuar atë edhe me bold.

Teksti gjithashtu ka tre mestituj, që e bëjnë atë më tërheqës. Ka vetëm një ilustrim standard, në fillim të tekstit, ndërsa brenda tekstit nuk ka fotografi të tjera.

Margjinat në këtë portal janë më specifike. Ndërsa deri te paragrafi i pestë margjinat janë standarde dhe nuk të krijojnë as ndjesinë e boshllëkut e as atë të trysisë, pas këtij paragrafi e ke idenë e një drejtuesi të barkës së vogël që po shëtit në oqean – secila margjina në të dy anët e tekstit është më e gjerë se teksti.

Një problem tjetër që do ta pengojë lexuesin të përqendrohet te teksti, në pjesën e parë, janë publikimet anash, të cilat janë me nga një titull dhe një fotografi të madhe, që tërheqin vëmendjen më shumë sesa teksti kryesor.

Teksti ka gjithsej 28 paragrafë, më i gjati 6 rreshta, por shumica 4-5 rreshta, që është standard i pëlqyer.

Brenda tekstit ka dy reklame, njëra që në fillim e tjetra pas paragrafit të tretë, që paraqesin elemente të mjaftueshme që lexuesi, gjatë kohës sa merr vendimin për ta lexuar tekstin, të dekurajohet nga shkëputja që krijojnë reklamat.

Teksti plotëson në masë të madhe kriterin e minipiramidës, në çka ndihmojnë bukur shumë edhe mestitujt dhe citatet tërheqëse, që janë zgjedhur për të filluar paragrafët.

Në portalin “shekulli.com” të Tiranës rreshtat standardë janë të gjithë mbi modelin ideal prej 80 shenjash, me tendencë edhe të kapërcimit të kufirit të lartë të preferuar, 90 shenja.

#### Shembull:

*Instituti i Studimeve Politike përmes projektit monitorues 2017-2020 www.deputetim.al, =87*

*mbështetur nga qeveria e mbretërisë holandeze ka ofruar të dhëna publike që lidhen me =85*

*përbërjen e parlamentit, cilësitë e përfaqësimit, prurjet, risitë dhe problematikat. Të dhënat =94*

Por, te ky portal ka një strukturë krejt tjetër të tekstit nga shumë portale të tjera, edhe në Shqipëri edhe në rajon.

Ka vetëm ilustrimin fillestar, nuk ka një nëntitull klasik, por ka box, që si model është mjaft joshës për të tërhequr për lexim të tekstit.

Mirëpo, të gjitha elementet e tekstit janë më ndryshme. Teksti është ndarë në dy blloqe, me një mestitull të shkurtër në mes dhe nuk ka paragrafë klasikë. Njëri bllok i tekstit ka 20 rreshta, tjetri 23.

Me një shikim të shpejtë shumë më shumë ka gjasa që të mos vendosim ta lexojmë.

Margjinat janë standarde.

Por, portali tjetër i Tiranës, i marrë për analizë, “top-channel.tv” ka një strukturë tjetër të faqes, me rreshta që rrallë kalojnë 60 shenja ose që, të shumtën e rasteve, janë për dhjetë shenja më të shkurtër.

#### Shembull:

*Ardhja për të jetuar në Shqipëri e pensionistëve nga vendet e =61*

*Bashkimit Evropian mund të jetë një mundësi e mirë për =54 ekonominë e vendit për të rritur të hyrat në valutë. =52*

Teksti nuk ka nëntitull të theksuar e as mestituj, sikurse as ndonjë fjalë a fjali të theksuar me bold. Ka ilustrim standard në krye të tekstit. Ka gjithsej shtatë paragrafë, me gjatësi prej dy deri në gjashtë rreshta.

Ka zgjedhje të mirë të fjalëve nismëtare të paragrafëve dhe nuk ka reklama që mund të dekurajojnë nisjen e leximit të tij.

Por, janë margjinat (foto), që lënë shumë për të dëshiruar. Ka aq shumë hapësirë boshe anash, që është dekurajuese, dhe, sipas hulumtimit të marrë për bazë, janë një element jonxitës për lexim.

Jashtë standardeve të hulumtimit të marrë për bazë është edhe portali “zhurnal.mk” i Shkupit. Ky portal, ndër më të lexuarit në gjuhën shqipe në Maqedoni ka një strukturë rreshtash që kalojnë 90 shenja, me tendencë përgjithësisht për të pasur rreshta të gjatë.

#### Shembull:

*“Dështimi i këtyre partive ka qenë që në start. Për shkak të miopisë së tyre politike dhe lakmisë =98*

*për pushtet, pranuan të hyjnë në qeveri pa ato kërkesa që dilnin nga Deklarata e përbashkët e =93*

*partive politike shqiptare, e njohur si “Platforma e Tiranës”. =62*

Teksti ka gjithsej tetë paragrafë, dy prej të cilëve prej nga 9 rreshtash, më i shkurti dy rreshta. Nuk ka nëntitull e as theksim të tekstit në fillim, sikur që nuk ka as mestituj. Ilustrimi është vetëm në krye të tekstit, ndërkohë që foton ilustruese dhe tekstin i ndan një reklamë.

Margjina në anën e djathtë është brenda standardeve, sado që ajo mund të shpërqendrojë shikimin në tekst, pasi është e mbushur me fotografi. Ndërsa, në anën e majtë, margjina është një hapësirë shumë e gjerë, pothuaj sa gjysma e tekstit. Fillimet e paragrafëve nuk janë se janë aq tërheqës për të nxitur leximin, më shumë krijohet përshtypja (në dy-tri raste) se janë krijuar paragrafë vetëm që ata të jenë me më pak rreshta.

Por, ky portal është afër modelit të marrë për bazë, nëse e krahasojmë me portalin tjetër në shqip në Maqedoni, “la-jmpress”, në të cilin rreshtat standardë kanë një gjatësi prej rreth 140 shenjash, pothuaj dyfishin e rreshtit ideal.

#### Shembull:

*Partitë kanë hyrë në fazën e fundit të përzgjedhjes së kandidatëve me të cilët do të garojnë në zgjedhjet lokale të 15 tetorit. Në disa komuna =142*

*tanimë kandidatët e disa partive janë thujtë të sigurt, ndërsa në shumë komuna partitë kanë ende problem në përzgjedhjen e kandidatëve. Edhe =141*

*në këto zgjedhje situata më e tensionuar duket në BDI. Nga kjo parti deri më tani kanë zgjedhur vetëm kandidatin për Komunën e Kërçovës ku në =139*

Teksti ilustron me logot e gjashtë partive politike, nuk nëntitull e as mestituj. Por, teksti ka gjithsej tre paragrafë, njëri 9 rreshta, njëri katër e tjetri 8 rreshta.

Fjalët fillestare të paragrafëve nuk janë të përzgjedhura për të tërhequr këshërë të lexuesit.

Margjinat janë brenda standardit të modelit të marrë për bazë për analizë.

E përafërt me portalet në gjuhën shqipe është gjendja edhe me portale në vendet e rajonit.

Me laramani përmbajtjeje janë edhe portalet në vendet e rajonit, portali kroat “jutarnji.hr”, portali serb “b92.net”, portali nga Bosnja e Hercegovina “dnevni avaz” dhe portali nga Mali i Zi, “vijesti.me”, të cilat janë hulumtuar, por nuk janë prezantuar këtu për shkak të hapësirës së kufizuar.

#### Çka tregojnë shembuj?

A do të ndalet lexuesi për lexim apo do të ikë në një faqe tjetër? A ka në shembujt e marrë mjaft elemente dalluese, të cilët do t’i zë syri i lexuesit gjatë periudhës sa ai shëtit mbi tekst për ta marrë vendimin nëse ia vlen të lexohet apo ajo?

Përgjithësisht, asnjëri nga portalet e hulumtuara nuk i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara sipas hulumtimit të marrë për bazë për krahasim.

Nëse flasim për gjatësi rreshtash, duket qartë se vetëm gjysma e shembujve ta analizuar kanë rreshta standardë, të tjerët kryesisht kanë rreshta shumë të gjatë dhe të lodhshëm për lexim, disa rreshta shumë të shkurtër.

Më mirë është gjendja të gjerësia e paragrafëve, ku përgjithësisht ka një vetëdijësim për shkrimin e paragrafëve të shkurtër, megjithëse janë dy raste kur ky rregull nuk merret fare parasysh.

Vetëm më pak se gjysma e teksteve plotëson kriterin shumë të rëndësishëm të shkrimit të formë të minipiramidës. Në të shumtën e rasteve, krijohet ideja sikur kalimi në paragrafin tjetër është bërë më shumë për të plotësuar kriterin e paragrafit të shkurtër, sesa që është gjetur një element interesant për fillimin e paragrafit të ri me një çështje a temë tërheqëse. Pothuaj të gjitha portalet kihet përshtypja se kanë dilema me strukturën e tekstit, mes tekstit tradicional për media të printuara dhe tekstit për portal të lajmeve. Ato kanë një nëntitull të improvizuar (të shejnuar me bold, por jo me përmbajtje nëntitulli) dhe fare rrallë kanë mestituj.

Shumica e portaleve mjaftohen me një fotografi në krye të tekstit, edhe pse shumica e teksteve janë të gjata dhe më shumë fotografi do t’i bënin më atraktive.

E sa i përket margjinave, pothuaj asnjë nga portalet nuk është kujdesur për të gjetur një zgjedhje të mirë teknike në këtë plan. Margjinat janë ose hapësira shumë të gjera ose të fotografi mbushura me fotografi, të shumtën e herëve shumë më tërheqëse sesa teksti, me të cilin kemi synim ta bëjmë lexuesin për vete.

Kur krejt kësaj ia shtojmë edhe reklamat në fillim të tekstit dhe pas çdo dy-tre paragrafësh, atëherë lirisht mund të konstatojmë se portalet e lajmeve në Kosovë dhe në vendet e rajonit nuk kanë kërkuar edhe aq shumë elemente profesionale për ta bërë lexuesin për vete.

Ato kanë kërkuar elemente të tjera për të provuar për ta bërë lexuesin për vete. Titujt mashtrues dhe të pambuluar me përmbajtje, fotografi të falsifikuara, fakte atraktive por të paverifikuara, personazhe triviale, mashtrime me fshehjen e vendit ku ka ndodhur një ngjarje e rëndësishme e elemente të tjera dominojnë fushën në të cilën portalet do të duhej të konkurronin me cilësi të lajmit dhe zgjedhje adekuate të dizajnit, dy elemente që një media e bëjnë tërheqëse, jo vetëm në gazetarinë e internetit por në çdo kohë.

**Shënim: Pjesë nga punimi më i gjatë i paraqitur në Konferencën Ndërkombëtare për Gazetari, media dhe Komunikim, Durrës, 27-29 tetor 2017**



# INTERNATIONAL KNOW HOW TRANSFER AND TECHNOLOGY IN MY COUNTRY

## International Memberships:

- EOQ - European Organization for Quality
- IPMA - International Project Management Association
- IFAC - International Federation for Automatic Control
- ITA - Information Technology for Automotive Industry
- Tempus Projects
- Erasmus Mundus Project
- SEECCEL - South East European Countries Entrepreneurship Learning
- PLAN - Procurement Law Academic Network
- AESOP - Association of European Schools of Planning
- EUROSIM - Federation of European Simulation Societies

## Education

Higher education for Bachelor and Master level in several disciplines  
Traning and Professional Education  
Non-formal Education

## Certifications

Systems Certification  
Certification of Persons  
Offering price (for Excellence, Entrepreneur, E - Technology, Leadership, Management, etc.)

## Certifications

Professional Consulting  
Professional supervision  
Products and systems Development (Design)  
Project Management

## Research

Applied Research  
Opinions Research  
Scientific Research

## Publications

Newspaper: UBT News  
Journal of graduates: Alumni  
Science Journal: International Journal for Business and Technology,  
University and Professional Books  
Books Papers presented at conferences in UBT  
Masters and Doctorate threads  
Publications of a Professional and scientific field



### ITALY

- Polytechnic University of Milan
- University of Cassino and Southern Lazio
- Polytechnic University of Milan
- Accordi di cooperazione accademica, Torino
- University of Milan
- Parthenope University of Naples



### CZECH

- Republic University of Pardubice
- Masaryk University
- University of Economics, Prague
- Technology agency - Czech invent, Prague



### FRANCE

- CIFE - Centre international de formation européenne, Nice
- European Institute of High International Studies, Nice
- Université de Nice Institut du droit de la paix et du développement
- University of Nice Sophia Antipolis
- University of Limoges
- Ecole nationale d'administration (ENA), Strasbourg
- Institut des Hautes Etudes Internationales - Université Paris
- University of Montpellier



### ROMANIA

- University of Bucharest, Bucharest
- Technical University of Cluj-Napoca
- University "Gheorghe Cristea" - Bucuresti



### POLAND

- University of Warsaw
- University of Wrocław
- Pawel Wlodkowic University College of Plock



### BULGARIA

- Bulgarian Diplomatic Institute - Ministry of foreign affairs
- Bulgarian Academy of Science - CLMI-BAS, Sofia



### SPAIN

- Madrid School of Marketing, Madrid



### GREAT BRITAIN

- City, University of London
- Institute for Manufacturing - IFM, University
- University of Cambridge
- The University of Edinburgh
- Staffordshire University



### AUSTRIA

- Vienna University of Technology
- Institute for Handling Device and Robotics - IHRT - TU Wien
- University of Salzburg
- Diplomatic Academy of Vienna
- Donau-Universität Krems
- University of Innsbruck
- University of Applied Sciences
- Vienna University of Economics and Business
- WUS Austria
- Institute for Business Promotion - WIFI
- ARGESIM
- Institute for Danube Region and Central Europe - IDM
- Quality Austria
- One point Software GmbH
- BOC Information Systems GmbH
- TUEV Austria
- Institute for Analysis and Scientific Computing
- Department für Raumentwicklung, Infrastruktur und Umweltplanung,
- Fachbereich Regionalplanung und Regionalentwicklung - TU Wien\*



### USA

- Oakland University Michigan
- The California State University San Bernardino
- University of Rochester
- Embry-Riddle Aeronautical University, Prescott Arizona
- Tiffin University, tiffin, Ohio
- Iowa University
- General Motors
- General Electrics
- University of Kentucky
- DELMIA



### PORTUGAL

- University of Minho, Civil Engineering Department, Braga
- Universidade Nova de Lisboa



### SLLOVAKIA

- University of Technology in Bratislava,
- Spectra Centre of Excellence of the EU Bratislava



### KOSOVÉ

- Universiteti i Mitrovicës " Isa Boletini"
- Kolegji Bisnesi
- Kolegji Fama
- Kolegji
- Kolegji Riinvest



### IRELAND

- Waterford Institute of Technology WIT, Ireland
- Universitu of Limerick, Limerick
- University College Cork-UCC



### CANADA

- University of Manitoba



### SWEDEN

- Linnaeus University



### FINLAND

- Lappeenranta University of Technology



### NORWAY

- Gjøvik University College



### NETHERLANDS

- University of Twente
- Van Hall Larenstein University of Applied Science, Stichting Van Hall Larenstein, Velp



### SOUTH KOREA

- Korean Advanced Institute for Science and Technology, Seoul



### JAPAN

- Bankyo University-Japan



### TURKEY

- Kadir Has University: Istanbul
- Mimar Sinan University of fine Arts - Findikli Istanbul: Istanbul
- Polytechnic University of Izmir
- Turkish Standard Institute, Ankara
- Fatih University, Istanbul



### CROATIA

- University of Rijeka
- University of Split, Split
- Hungary
- Pázmány Péter Catholic University, Budapest
- Corvinus University of Budapest
- Szent István University, Budapest
- University of Pécs, Pécs
- Budapest University of Technology and Economics



### HUNGARY

- Pázmány Péter Catholic University, Budapest
- Corvinus University of Budapest
- Szent István University, Budapest
- University of Pécs, Pécs
- Budapest University of Technology and Economics



### GERMANY

- Freie Universität Berlin
- Dortmund Universitz of Technologz, Dortmund
- Munich Universitz of Technology
- Deutsche Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit, Berlin
- SIEMENS, Munich
- FESTO, Germany
- University of Freiberg
- Anhalt University of Applied Science, Architecture - Faculty Management, Kothen
- Rwth Aachen University
- Hochschule Offenburg
- Institut für Keramik, Glas- und Baustofftechnik
- Arbeitsgemeinschaft Simulation (ASIM)



### ALBANIA

- University of Tirana
- University of Vlora "Osmail Qemajii, Vlorë
- University of Shkoder
- Politechnic University of Tirana
- Academy of Science in Albania
- University "Marlin Barleti, Tirana
- Aleksander Moisiu university, Faculty of Professional Studies, Durrës
- Polis University, Tirana
- European University of Tirana



### SLOVENIA

- Primorski Tehnološki Park-Nova Gorica
- Štajerski Tehnološki Park-Maribor
- Technology park Ljubljana
- International School for Social and Business Studies, Celje



### BOSNA AND HERCOGEVONA

- University of Sarajevo
- University of Tuzla



### MACEDONIA

- State University of Tetova
- South East Europeana University, Tetovo
- University "St. Kliment Ohridski" Bitola



### INDONESIA

- ITS - Institute of Technology Sepuluh



### MONTENEGRO

- University of Montenegro, Faculty of Architecture, Podgorica



- 17 vite Lider i Arsimit të Lartë - I vetmi i çertifikuar për ekselencë (EFQM)
- I çertifikuar sipas standardit ISO 9001:2008 për cilësi
- Përfutjes për r herë të katërt nga Kosova i Programit Evropian ERASMUS MUNDUS
- Përfutjes i Programit për bursa AEP, Albach
- Përfaqëson Kosovën në Organizata Evropiane dhe Botërore
- Kampion Evropian në Robotikë
- Kampusi i parë për Shkencë dhe Inovacion

## ZGJEDH MË TË MIRIN ... ... QË TË BËHESH MË I MIRI!

Come to UBT and Go International...

### PROGRAMET E AKREDITUARA

#### SHKENCA KOMPUTERIKE DHE INXHINIERI

- Inxhinieri e Sistemeve Softuerike
- Baza e të Dhënave dhe Sistemet e Informacionit
- Grafika Kompjuterike dhe Multimedia
- Web Programim
- Rrjeta dhe Telekomunikacion
- Robotikë dhe Sistemet Inteligjente
- Informatikë Biomjekësore
- Siguria dhe Sigurimi i Informacionit
- Multimedia dhe Vizualizim
- Inxhinieri e Komunikimit
- Shkenca e të Dhënave Statistikore
- Informatikë Mjekësore

#### MENAXHMENT, BIZNES DHE EKONOMI

- Financa, Banka dhe Sigurime
- Kontabilitet, Auditim dhe Tatime
- Marketing dhe Shitje
- Menaxhment, Ndërmarrësi dhe Inovacion
- Biznes Ndërkombëtar
- Logjistikë dhe Menaxhim i Prokurimit

#### MEKATRONIKË DHE MENAXHMENT

- Menaxhim i Mekatronikës
- Automatizim Industrial dhe Kontrolli i Procesit
- Robotikë dhe Sisteme Inteligjente
- Inxhinieri Biomjekësore
- Inxhinieri e Telekomunikacionit
- Inxhinieri Mekanike
- Inxhinieri e Aeronautikës
- Dizajn i Produkteve Industriale
- Inxhinieri e Proceve të Prodhimit

#### SISTEMET E INFORMACIONIT DHE MENAXHMENT

- Sistemet e Informacionit të Biznesit
- Sistemet e Informacionit - GIS (Geo Information Systems)
- Sistemet e Informacionit të Bibliotekave dhe të Arkivave
- Statistika, Procesimi dhe Simulimi i të Dhënave
- Siguria e Informacionit dhe Privatësia
- Komercit Elektronik (E-Komerc)

#### ARKITEKTURË DHE PLANIFIKIM

##### HAPËSINOR

- Arkitekturë e Qëndrueshme
- Menaxhim Urban
- Restaurim Arkitekturor
- Dizajn i Interierit

#### INXHINIERI NDËRTIMOR (NDËRTIMTARI) DHE INFRASTRUKTURË

- Inxhinieri Strukturore - Konstruktiv
- Menaxhim i Ndërtimtarisë dhe Teknologjisë
- Infrastruktura Rrugore
- Inxhinieri e Ujrave - Hidro
- Inxhinieri e Gjeoteknikës
- Inxhinieri e Materialeve

#### SHKENCA POLITIKE

- Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci
- Integritime Evropiane
- Administratë Publike

#### JURIDIK

- Civile
- Penale
- Ndërkombëtare

#### EDREJTA BIZNESORE NDËRKOMBËTARE DHE EVROPIANE

#### MEDIA DHE KOMUNIKIM

- Gazetari
- Komunikim
- Menaxhimi i Medias
- Marrëdhënie me Publikun
- Regjia Televizive
- Gazetaria On-Line
- Kamera dhe Fotografia

#### POLITIKA PUBLIKE DHE MENAXHIM

- Politika Publike
- Menaxhimi Publik

#### INXHINIERI E ENERGJISË

- Bazat e Burimeve të Energjisë
- Ruajtja e Energjisë
- Energjia Efiçiente
- Teknologjia e Informacionit
- Menaxhimi i Energjisë
- Elektrikë Elektronikë
- Sistemet e Qëndrueshme
- Izolimi i Ndërtesave
- Sistemet e Ngrohjes dhe Ftohjes

#### INXHINIERI E ENERGJISË

##### EFIÇIENÇA

- Burimet e Energjisë
- Konzervimi i Energjisë
- Efiçienca e Energjisë
- Menaxhimi i Energjisë
- Inxhinieri Elektrike
- Konzervimi i Energjisë në Ndërtesa
- Sistemet e Ngrohjes dhe Ftohjes
- Energjia Gjeotermike

#### INFERMIERI

##### FARMACI

##### STOMATOLOGJI

#### DIZAJN I INTEGRUAR

- Dizajn Grafik dhe i Komunikimit
- Dizajn Mode dhe Tekstil
- Dizajn i Produkteve
- Dekorim i Ndërtesave dhe Mobilimi

#### SHKENCAT E USHQIMIT DHE BIOTEKNOLOGJI

- Teknologji e Ushqimit
- Nutricion (Të Ushqyerit)
- Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë e Ushqimit

### REGJISTRIMI

#### Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

Diploma, dëftesat e notave, certifikata e pikëve të maturës, certifikata e lindjes dhe kopja e letërnjoftimit.

#### Gjuha e studimeve:

Gjuha Shqipe dhe Gjuha Angleze si dhe mundësia e studimit në gjuhë të tjera.

#### Mënyra e studimit:

UBT organizon ligjërata të rregullta dhe me korrespondencë, si dhe ofron mundësinë e studimit në distancë. Për të punësuarit ofrohen ligjërata pas orarit të punës dhe gjatë fundjavës.

#### Që suksesit juaj të jetë i garantuar, UBT ofron për secilin studentë:

- Orientim profesional, kurse përgatitore, praktika profesionale, vizita studimore dhe çertifikime ndërkombëtare
- Sistem online dhe qasje në kompjuterë
- Licensa falas për softuer
- 100% Internship në kompanitë dhe institucionet më prestigjioze vendore dhe ndërkombëtare
- Libraria me numrin më të madh të titujve dhe qasja online në libraritë më të mëdha elektronike
- Praktika dhe Eksperimente në Laboratorë bashkëkohorë.
- Trajtime: CISCO, Microsoft, AutoCad, ECDL, IPMA etj.
- Çertifikime për kontabilitet në bashkëpunim me SCAAK

#### Financat dhe pagesat:

- Çmimi i studimeve për një vit akademik Bachelor është 1200 €, për nivelin Master është 1500 € me mundësi pagese deri në 12 kështe.
- Për të gjithë nxënësit e dalluar UBT ofron bursa studimi.

#### UBT ofron zbritje deri në 50% edhe për këto kategori:

- Të punësuarit në Doganat e Kosovës
- Pjesëtarët e FSK-së dhe Policisë së Kosovës
- Të punësuarit në Institucionet Publike të Kosovës
- Familjarët e dëshmorëve dhe veteranëve të luftës
- Studentët që vijnë nga e njëjta familje dhe si grup
- Studentët që paguajnë në fillim të vitit akademik
- Studentët e punësuar në Policinë e Kosovës
- Studentët me sukses të shkëlqyeshëm
- Studentët të cilët kanë arritur 100% në testin kombëtar dhe kanë të gjitha 5 në shkollimin paraprak
- Studentët e Luginës së Preshevs, Malit të Zi
- Studentët që marrin pjesë në programin përgatitor të maturës